

ANALIZA E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

Pjesa e parë

Shkup, qershor 2025

Autorë:

1. Darko Avramovski
2. Lençe Ristoska

Materialet në këtë edicion janë vetëm për referencë. Megjithëse OSBE-ja përkushtoi vëmendje maksimale në përpilimin e tij, ajo nuk merr asnjë përgjegjësi lidhur me saktësinë dhe aspektin komplementar të të gjitha informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të prezantuara ose sa i përket ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij edicioni, pikëpamjet, opinionet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e prezantuara në të njëjtin nuk e pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të OSBE-së. Për këto arsye, nuk mund të ngrihen kurrfarë pretendimesh kundër OSBE-së në lidhje me pasojat e mundshme nga autenticiteti i informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë edicion.

Kjo analizë u hartua për nevojat dhe në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Përmbajtjet e edicionit janë në përgjegjësi të autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyrojnë pikëpamjet e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Përmbajtja

I. Lista e akronimeve.....	Error! Bookmark not defined.
II. Hyrje.....	Error! Bookmark not defined.
1. Analiza e dispozitave të Ligjit për Gjykatat dhe të një Pjese të Akteve Nënligjore dhe të Përgjithshme që Rezultojnë nga Ligji për Gjykatat.....	6
2. Analiza e dispozitave të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Repulikës së Maqedonisë së Veriut dhe të një Pjese të Akteve Nënligjore dhe të Përgjithshme që Rezultojnë nga i Njëjti	18
3. Analiza e dispozitave të Ligjit për Prokurorinë Publike dhe të një Pjese të Akteve Nënligjore dhe të Përgjithshme që Rezultojnë nga Ligji për Prokurorinë Publike	27
4. Analiza e dispozitave të Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të një Pjese të Akteve Nënligjore dhe të Përgjithshme që Rezultojnë nga Ligji për Këshillin e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	Error! Bookmark not defined.
5. Analiza e dispozitave të Ligjit për Pagat e Prokurorëve Publikë dhe të një Pjese të Akteve Nënligjore dhe të Përgjithshme që Rezultojnë nga Ligji për Pagat e Prokurorëve Publikë..	Error! Bookmark not defined.
6. Analiza e dispozitave të Ligjit për Pagat e Gjyqtarëve dhe të një Pjese të Akteve Nënligjore dhe të Përgjithshme që Rezultojnë nga Ligji për Pagat e Gjyqtarëve	Error! Bookmark not defined.
7. Analiza e dispozitave të Ligjit për Buxhetin Gjyqësor dhe të një Pjese të Akteve Nënligjore dhe të Përgjithshme që Rezultojnë nga Ligji për Buxhetin Gjyqësor	Error! Bookmark not defined.
8. Analiza e dispozitave të Ligjit për Administrimin e Lëvizjes së Lëndëve në Gjykata dhe të një Pjese të Akteve Nënligjore dhe të Përgjithshme që Rezultojnë nga i njëjti	Error! Bookmark not defined.

I. Lista e akronimeve

AGJPP-AKADEMIA PËR GJYQTARË DHE PROKURORË PUBLIK

KAL – Kontrolli Antikorrupcion i Legjislacionit

BPV- Bruto Prodhimi Vendor

KSHPK-Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit

KEDNJ – Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

GJEDNJ - Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

BE-Bashkimi Evropian

LPKKI-Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave

LProkPub.-Ligji për Prokurorinë Publike

LPP-Ligji për Procedurë Penale

KP-Kodi Penal

LAGJPP- Ligji për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë

LB – Ligji për Buxhetet

LGJ – Ligji për Gjykatat

LBGJ – Ligji për Buxhetin Gjyqësor

LKGJ– Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut

LKPP– Ligji për Këshillin e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut

LPMD-Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi

LPGJ – Ligji për Pagat e Gjyqtarëve

MD-Ministria e Drejtësisë

MF-Ministria e Financave

RM-Republika e Maqedonisë

KGJB-Këshilli Gjyqësor Buxhetor

II. Hyrje

Sistemi i drejtësisë është shtylla themelore e çdo shteti ligjor. Roli i tij konsiston jo vetëm në zbatimin e ligjeve, por edhe në sigurimin e drejtësisë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe vendosjen e rendit dhe stabilitetit në shoqëri. Një nga aspektet më të rëndësishme të sistemit të drejtësisë është siguri i sundimit të ligjit. Kjo do të thotë se ligjet zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga pozita e tyre shoqërore dhe statusi politik, social dhe ekonomik. Vetëm përmes zbatimit të barabartë, të drejtë dhe transparent të ligjeve mund të sigurohet një shoqëri e drejtë. Nëse sistemi i drejtësisë është i korruptuar, i njëanshëm ose i nënshtrohet ndikimit, ndërsa ligjet nuk zbatohen në mënyrë të barabartë, absolutisht krijohet (pa)drejtësia selektive, duke çuar në anarki dhe rritje të mosbesimit midis qytetarëve.

Një sistem i pavarur, i paanshëm dhe efikas i drejtësisë është çelësi për luftën kundër korrupsionit si një nga kërcënimet më të mëdha për shtetin ligjor. Korrupsioni e rrënon transparencën dhe sundimin e ligjit, shkatërron institucionet dhe diskriminon ata që nuk kanë qasje në rrjetet e ndikimit. Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatave dhe prokurorive publike, trajtimi i drejtë i tyre në bazë të ligjeve dhe provave, pa asnjë ndikim politik apo ekonomik, është mënyra e vetme përmes së cilës mund të parandalohet manipulimi politik i institucioneve të drejtësisë dhe të sanksionohen praktikat korruptive. Sistemi i drejtësisë ka rol parandalues në një vend. Nëse ligjet zbatohen në mënyrë konsekuente dhe të drejtë, atëherë nuk mund të ketë prag të tolerancës për veprimet e paligjshme, gjë që në fakt kontribuon në krijimin e një shoqërie në të cilën respektimi i ligjit dhe sanksionimi i mosrespektimit të tij bëhet normë.

Duke e marrë parasysh se si një nga sektorët /fushat që do të përfshihen në procesin e hartimit të Strategjisë së re pesëvjeçare Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave 2026-2030, edhe sistemi i drejtësisë do të përfshihet në kuadër të bashkëpunimit midis Misionit të OSBE-së në Shkup dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me qëllim të identifikimit të të ashtuquajturave rreziqe rregullatore të korrupsionit, u sigurua ekspertizë për të analizuar një pjesë të ligjeve, akteve nënligjore dhe akteve të përgjithshme të drejtësisë. Për nevojat e analizës nga Misioni i OSBE-së në Shkup, u angazhua znj. Lençe Ristoska dhe z. Darko Avramovski, ekspertë në fushën e së drejtës. Qasja në implementimin e kësaj analize ishte në kuadër të Metodologjisë për rishikimin antikorruption të legjislacionit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe Analizës Krahësuese dhe Metodologjisë së Këshillit Rajonal për Bashkëpunimin në Evropën Juglindore dhe Nismës Rajonale Antikorruption.

Analiza e përfshiu Ligjin për Gjykatat, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligjin për Buxhetin Gjyqësor, Ligjin për Administrimin e Lëvizjes së Lëndëve në Gjykata, Ligjin për Pagat e Gjyqtarëve, Ligjin për Prokurorinë Publike, Ligjin për Këshillin e Prokurorëve Publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Ligjin për Pagat e Prokurorëve Publikë, si dhe aktet nënligjore dhe të përgjithshme që rezultojnë prej tyre. Gjatë zbatimit të kontrollit antikorruption të ligjeve të sipërpërmendura, akteve nënligjore dhe akteve të tjera të përgjithshme, në mënyrë plotësuese u konsultuan edhe ligjet procedurale, të specifikuara në mënyrë përkatëse në këtë analizë.

1. Analiza e dispozitave të Ligjit për Gjykatat dhe një pjesë e akteve nënligjore dhe të përgjithshme që rezultojnë nga Ligji për Gjykatat

Titulli: Ligji për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)

Shqyrtimi i kërkesës: LGJ është një akt kryesor ligjor që e vendos bazën e sistemit gjyqësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky ligj e rregullon strukturën, organizimin dhe funksionimin e gjykatave, si dhe të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore. Nëpërmjet dispozitave të tij garantohet pavarësia e pushtetit gjyqësor dhe sigurohet zbatimi efektiv dhe i barabartë i drejtësisë. Ky ligj është themeli i shtetit ligjor dhe një instrument kyç për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave ligjore të garantuara me kushtetutë.

Materialet e shqyrtuara/ konsultuara:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
2. LPKKI ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr.12/2019)
3. LGJ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/06, 62/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19)
4. Rregullorja e Punës së Gjykatës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 66/13 dhe 114/14)
5. Rregullorja e Punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 14/22)
6. Rregullorja për Lartësinë e Kompensimit për Kujdestaritë në Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/10)
7. Rregullorja për Mënyrën e Funksionimit të Sistemit të Informacionit në Gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 13/24)
8. Rregullorja për Përbërjen dhe Mënyrën e Punës së Këshillit për Koordinimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Autoritetet e Sistemit të Drejtësisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 265/23)
9. Udhëzuesi për Mënyrën e Zbatimit të Shqyrtimit të Parashtresave dhe Ankesave të Qytetarëve të paraqitura në Ministrinë e Drejtësisë për punën e gjykatave në lidhje me shtyrjen e procedurave gjyqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/11)
10. Rregullorja për Formën dhe Përmbajtjen e Formularit dhe Mënyrën e Lëshimit dhe Heqjes së Legjitimacionit Zyrtar të Nëpunësve Gjyqësorë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 130/07)
11. Rregullorja për Formën dhe Përmbajtjen e Formularit dhe Procedurën e Lëshimit dhe Heqjes së Legjitimacionit Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 15/07)
12. Ligji për Shoqatat dhe Fondacionet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/10, 135/11 dhe 55/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 239/22)
13. Statuti i Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut
14. Ligji për Trajtimin e Parashtresave dhe Propozimeve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/08, 13/13, 156/15 dhe 193/15 dhe "Gazeta zyrtare" nr. 208/24)

Sigurimi i një gjyqësori pa korrupsion është parësore për respektimin e parimeve e drejtësisë, barazisë dhe sundimit të ligjit. Ky ligj shërben si një kornizë kryesore legjislativë që e rregullon organizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e gjyqësorit. Duke pasur parasysh rëndësinë e tij, çdo dobësi ose boshllëk ligjor në ligj mund ta çrregullojë integritetin gjyqësor dhe të krijojë terren pjellor për korrupsion, duke rrezikuar besimin e publikut ndaj sistemit të drejtësisë.

Kjo analizë fokusohet në LGJ, me qëllim vlerësimin nëse dispozitat e tij promovojnë në mënyrë efektive transparencën, llogaridhënien dhe pavarësinë e gjyqësorit. Duke i konstatuar rreziqet e mundshme, procesi i KAL ofron një vlerësim nëse ligji është harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe inkurajon një gjyqësor të aftë për të shërbyer si mburojë kundër abuzimit të pushtetit.

Përkushtimi i shtetit në reformat gjyqësore dhe harmonizimi me standardet e BE-së e thekson rëndësinë e rishikimit të LGJ përmes KAL. Kjo është veçanërisht kritike në një periudhë kur perceptimi tregon se publiku është i shqetësuar për paanshmërinë gjyqësore ndërkaj për tejkalimin e gjendjes së këtillë janë të nevojshme reforma sistematike për fuqizimin e institucioneve demokratike. Analiza i shqyrton fushat kryesore të tilla si emërimet e gjyqtarëve, procedurat disiplinore, mekanizmat për të siguruar paanshmëri dhe masat mbrojtëse kundër ndikimit jo përkatës të jashtëm.

Analiza jo vetëm që i identifikoi rreziqet në LGJ, por ofron edhe rekomandime për tejkalimin e tyre. Duke forcuar kornizën ligjore kundër korrupsionit, shteti mund të ndërmarrë një hap vendimtar drejt ndërtimit të një gjyqësori që do të rrisë besimin e publikut dhe do të mbështesë objektivat më të gjera të qeverisjes, llogaridhënies dhe drejtësisë.

KONKLuzion

Pas analizës së LGJ, akteve nënligjore dhe akteve të përgjithshme që rezultojnë prej tij, u identifikuan mangësi që mund të prodhojnë rreziqe për korrupsion. Mangësitë e detektuara në Ligjin mund të kategorizohen në kategoritë si vijon:

- 1.1. Rreziqe për shkak të dispozitave të paqarta, të dykuptimta dhe të paspecifikuara
- 1.2. Rreziqe për shkak të afateve të papërcaktuara
- 1.3. Rreziqe për shkak të autorizimeve të gjera diskrecionale
- 1.4. Rreziqe për shkak të mungesës së garancive procedurale dhe mekanizmave mbrojtës

1.1. Rreziqe për shkak të dispozitave të paqarta, të dykuptimta dhe të paspecifikuara

Në tekstin e Ligjit dhe akteve nënligjore, përdoren shprehje të tilla si “menjëherë” (neni 39 paragrafi 10, neni 73 paragrafi 3, neni 75 paragrafi 3, neni 76 paragrafi 3 të LGJ) ose “pa prolongime” (neni 20 paragrafi 1 i LGJ), të cilat në mungesë të një afati objektiv, mund të çojnë në interpretime subjektive dhe zvarritjen e procedurave. Për sa i përket rreziqeve rregullatore të korrupsionit, afatet e tilla të papërcaktuara, përkatësisht përcaktimi i situatave të përgjithshme për të cilat nuk ka kritere, se kur ato fillojnë të rrjedhin, sa zgjasin, lejojnë interpretim dhe trajtim diskrecional në varësi të situatave konkrete dhe janë potencialisht të rrezikshme për zbatimin e pabarabartë të ligjit në të gjitha situatat dhe për të gjithë personat.

Një vërejtje e përgjithshme është se Ligji nuk përmban një dispozitë të qartë për momentin kur një gjyqtar ose gjyqtar porotë konsiderohet i zgjedhur, përkatësisht nuk ka sqarim të saktë nëse deklarata solemne e dhënë nga gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë është e natyrës konstituive dhe konsiderohet se detyrën e marrin me dhënien e deklaratës ose me pranimin e vendimit nga Këshilli Gjyqësor. Në korrelacion me LPKKI, kjo çështje është thelbësore pasi që nga momenti i përzgjedhjes llogariten afatet

për paraqitjen e deklaratave për gjendjen pronësore dhe interesat, kështu që për të shmangur një interpretim subjektiv të dispozitave, nevojitet të precizohet se kur vlerësohet se një gjyqtar ose gjyqtar porotë është zgjedhur dhe merr funksionin (nenet 41 dhe 42 të LGJ).

Në dispozitat që e rregullojnë shkarkimin e gjyqtarëve dhe shkeljet disiplinore, vihet re përdorimi i disa termave që janë të përgjithshëm dhe të papërcaktuar dhe për të cilët nuk parashikohen kritere shtesë. Së këtejmi, gjatë përcaktimit të kushteve për shkarkim ose vendosjen e masave disiplinore, ligjvënësi përdor formulimin: “shkelja është kryer me dashje ose neglizhencë të dukshme me fajin e gjyqtarit pa arsye të justifikuara dhe shkelja ka shkaktuar pasoja të rënda.” Në nenet 74, 76, 77 të LGJ vërehet dykuptimësi e dispozitës lidhur me faktin nëse është i nevojshëm kumulimi i të dy kushteve apo mjafton plotësimi i një kushti me qëllim shkarkimin e gjyqtarit apo të përcaktohet masë disiplinore. Për më tepër, në dispozitën e lartpërmendura përdoret termi “me dashje”, i cili haset në teorinë e së drejtës penale dhe bëhet fjalë për një koncept teorik dhe jo për koncept ligjor që mund të lërë hapësirë për interpretime subjektive, sepse nuk përcaktohet se çfarë nënkupton ligjvënësi me “dashje” në këtë rast. Ligjvënësi e dallon veprimin e qëllimshëm, si të drejtpërdrejtë ashtu edhe eventual, por me dashje si marrëdhënie subjektive e kryerësit është një koncept më shumë teorik dhe nuk ka përkufizim konkret.

Termi i dytë i përdorur nga ligjvënësi është “neglizhencë e dukshme”. Edhe ky term nuk është i qartë sepse nga pikëpamja e neglizhencës, teoria juridike njih dy lloje: neglizhencë e vetëdijshme dhe e pavetëdijshme. Termi “neglizhencë e dukshme” lë hapësirë për interpretim subjektiv dhe nuk përmban parametra kur konsiderohet se shkelja është kryer nga neglizhenca e dukshme dhe nëse kjo ka të bëjë edhe me neglizhencën e vetëdijshme edhe me atë të pavetëdijshme ose forma të caktuara të veprimit neglizhent do të përjashtohen.

Nga pikëpamja e pavarësisë gjyqësore dhe vlerësimit të lirë të provave, është veçanërisht e rëndësishme që gjatë sanksionimit të veprimit neglizhent të ketë kritere të qarta që do të garantojnë se rreziqet e abuzimit janë minimizuar gjatë interpretimit të “neglizhencës së dukshme” dhe në një mënyrë të tillë të ndikohet mbi pavarësinë e gjyqtarëve gjatë veprimit/ trajtimit. Në këtë kontekst, duhet vlerësuar edhe rrethana se nuk është përcaktuar në cilat raste do të konsiderohet se kanë ndodhur “pasoja të rënda”, kështu që për të shmangur dykuptimësinë dhe interpretimin subjektiv, është e nevojshme të parashikohen kritere me të cilat do të vlerësohet se kanë ndodhur “pasoja të rënda” (për shembull: vepra penale është parashkruar, debitori është bërë insolvent, ndërsa procedura e shqiptimit të masës së përkohshme ka zgjatur tepër gjatë dhe ngjashëm).

Njëkohësisht, përdoren edhe termat “forma më serioze të sjelljes së pahijshme”, “forma më të lehta të sjelljes së pahijshme”, “ndikim i vrazhdë”, “gabim i madh profesional”, “shkelje e rëndë e rendit dhe qetësisë publike”, “shkelje e lehtë e rendit dhe qetësisë publike” dhe “jo në rregull”. Të gjitha këto terma janë të papërkufizuar dhe është e paqartë se cilat situata do të konsiderohen si forma më serioze, dhe cilat si forma më pak serioze të sjelljes së pahijshme, si dhe në cilat situata do të ketë shkelje më të rënda, dhe në cilat shkelje më të vogla të rendit dhe qetësisë publike. Në fakt, edhe ajo se çka do të konsiderohet si sjellje e pahijshme nuk përcaktohet, kështu që ekziston një hapësirë e gjerë për interpretim subjektiv që mund të çojë në zbatim të pabarabartë të Ligjit. Prandaj, është e nevojshme të përcaktohen elementet dhe parametrat konkret që do të rrisnin objektivitetin, do të zvogëlonin mundësinë e abuzimit dhe do të mundësonin që gradimi të bëhej në bazë të kritereve objektive. Termat “ndikim i vrazhdë” dhe “gabim i madh profesional” gjithashtu nuk janë përkufizuar sa duhet, kështu që në një situatë ku çdo ndikim është problematik, parashtrohet pyetja se pse ligjvënësi është kufizuar në ndikimin e vrazhdë.

Në rastin e gjyqtarëve porotë, si bazë për pushimin e funksionit është përcaktuar ushtrimi “i parregullt” i funksionit, ku po ashtu ky nocion nuk është përcaktuar dhe lë hapësirë për interpretim subjektiv, zbatim të ndryshëm dhe trajtim të pabarabartë (neni 80 i LGJ).

Në përputhje me dispozitat e nenit 16, “ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm zbatohet në mënyrën më të shpejtë dhe më efektive të mundshme, dhe kjo nuk do të pengohet me vendim të asnjë autoriteti tjetër shtetëror.” Në këtë nen, shprehja “në mënyrën më të shpejtë dhe më efektive të mundshme” është e përgjithshme dhe jo e përcaktuar sa duhet. Duke marrë parasysh procedurën e ekzekutimit dhe kompetencat e gjykatës në procedurën e ekzekutimit, rezulton se kjo dispozitë ka për qëllim të garantojë që konfirmimi i formës së prerë dhe ekzekutueshmërisë së aktgjykimeve të jepet në kohën e duhur dhe pa vonesa të panevojshme. Prandaj, është e nevojshme të merren parasysh në këtë kontekst dispozitat e Rregullores së Punës së Gjykatës që e rregullojnë çështjen e formës së prerë dhe ekzekutueshmërisë së vendimeve.

Në këtë kontekst, janë të rëndësishme edhe dispozitat e Rregullores së Punës së Gjykatës, përkatësisht:

- neni 131, paragrafi 8, i cili thotë: “Kryetari i Këshillit ose trupi gjykues i përbërë nga një gjyqtar e konstaton formën e prerë dhe ekzekutueshmërinë e vendimit fillestar dhe e konfirmon atë me nënshkrimin e tij.”;
- neni 201 paragrafi 4: “Nëpunësit gjyqësorë në Zyrën e Protokollit Gjyqësor janë të detyruar t'i paraqesin ç'do ditë parashtrësat, fletë dërgesat e dërgesave të realizuara në mënyrë jo të rregullt nga gjyqtari të cilit i është caktuar lënda, si dhe lëndët për të cilat janë krijuar kushtet e formës së prerë, ekzekutueshmërisë dhe arkivimit.”, si dhe
- neni 228 paragrafi 4: “Nëpunësi gjyqësor detyrimisht duhet ta shënojë datën e formës së prerë dhe ekzekutueshmërisë kur do të plotësohen kushtet në përputhje me ligjin dhe këtë Rregullore të Punës, përpara se lënda të dërgohet me një mjet të jashtëzakonshëm juridik.”

Siç mund të shihet në dispozitat e specifikuar, Rregullorja e Punës së Gjykatës nuk parashikon afate konkrete brenda të cilave nëpunësit gjyqësorë janë të detyruar të konstatojnë shfaqjen e formës së prerë dhe ekzekutueshmërisë, por përdoren fraza të tilla si “kur do të plotësohen kushtet në përputhje me ligjin dhe këtë Rregullore të Punës”, gjë që mbart rrezikun e zvarritjes së procedurave dhe trajtimit subjektiv dhe të pabarabartë. Në korrelacion me nenin 16 të LGJ, këto dispozita të Rregullores së Punës, si dhe vetë neni, nuk e rregullojnë plotësisht procedurën e konfirmimit të formës së prerë dhe ekzekutueshmërisë kështu që paraqesin rrezik rregullator për korrupsion.

Neni 19 paragrafi (2) i LGJ përcakton se: “(2) Gjykata e shkallës më të lartë mund të kërkojë nga gjykata e një shkalle më të ulët të rajonit të saj të dhëna në lidhje me zbatimin e ligjeve, problemet që lindin gjatë gjykimit, monitorimit dhe unifikimit të praktikës gjyqësore, shtyrjes së procedurës në raste të caktuara dhe të dhëna të tjera, ndërkaq mund të bëjë edhe këqyrje tjetër në punën e atyre gjykatave si dhe të zhvillojë mbledhje të përbashkëta me qëllim shqyrtimin e çështjeve të theksuara.” Kjo dispozitë ka dy aspekte të rrezikshme: aspekti i parë është terminologjia të cilën e përdor, e cila është e paqartë dhe aspekti i dytë është se ka kompetenca të paidentifikuara. Kështu që është e paqartë se për çfarë lloji të këqyrjes bëhet fjalë, përveç kërkimit të të dhënave. Kjo ngre pyetjen nëse gjykatat e apelit jashtë procedimit në shkallë të dytë mund të bëjnë këqyrje në punën e gjykatave, në cilat raste dhe në cilat kushte. Kjo veçanërisht pasi neni 37 paragrafi (1) alineja 14 e LGJ parashikon kompetencë të Gjykatës Supreme në monitorimin e punës së gjykatave. Për më tepër, nuk parashikohet procedurë brenda së cilës do të kryhej një këqyrje tjetër mbi punën e gjykatave, brenda cilave afate do të veprohej, cilat aktivitete mund të ndërmerren, cilat janë pasojat e mosveprimit sipas kësaj dispozite, dhe të ngjashme,

kështu që rezulton se për dispozitën konkrete mungojnë mekanizma parandalues që do të lejonin zbatimin e saj të barabartë dhe jo-selektiv.

Neni 36 paragrafi (4) thotë: "(4) Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë vepron sipas kërkesës që i plotëson kriteret e përcaktuara në paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni brenda gjashtë muajve nga paraqitja e saj dhe vendosë nëse gjykata më e ulët e ka shkelur të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, duke marrë parasysh rregullat dhe parimet e përcaktuara nga Konventa Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, dhe në veçanti kompleksitetin e lëndës, sjelljen e palëve në procedurë dhe sjelljen e gjykatës që ka vepruar." Mënyra në të cilën është ndërtuar fjalja në këtë paragraf lë hapësirë për dykuptimësi dhe është e nevojshme të harmonizohet me teknikën ligjore legislative gjatë përcaktimit të afatit në kuptimin që afati prej 6 muajsh ka të bëjë jo vetëm me veprimin, por edhe me vendimmarrjen lidhur me kërkesën.

Neni 36-a paragrafi (1) thotë: "(1) Pas marrjes së kërkesës nga neni 36 paragrafi (1) të këtij ligji, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë menjëherë, dhe jo më vonë se brenda 15 ditëve, i kërkon gjykatës së shkallës së parë të dërgojë kopje të shkresave nga dosja në fjalë, dhe nëse është e nevojshme një deklaratë nga gjykata më e lartë për kohëzgjatjen e procedurës para saj." Përdorimi i fjalëve "sipas nevojës" pa përcaktuar saktësisht se në cilat situata do të kërkohej një prononcim nga gjykata më e lartë lë hapësirë për trajtim diskrecional, interpretime subjektive dhe qasje të pabarabartë, dhe kështu paraqet edhe një rrezik korrupsioni. Prandaj, është e nevojshme të rishikohet kjo dispozitë në kuptimin që sa herë që gjykata më e lartë ka vepruar në një lëndë, njoftimi për kohëzgjatjen e procedurës do të kërkohej edhe nga gjykata më e lartë. Mes tjerash, është e nevojshme të përcaktohen afate brenda të cilave gjykatat duhet t'i dërgojnë të dhënat e kërkuara në Gjykatën Supreme, në mënyrë që kjo gjykatë të mund të veprojë brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Neni 42 i LGJ i rregullon kushtet për zgjedhjen e gjyqtarit porotë, si dhe detyrimin e gjyqtarëve porotë ta ndjekin trajnimin. Mënyra në të cilën përshkruhen kushtet për zgjedhjen e gjyqtarit porotë është e paqartë dhe lë hapësirë për shpërdorime. Me fjalë të tjera, gjyqtarët porotë zgjidhen për një mandat 4 vjeçar, me atë që gjyqtarit porotë i pushon funksioni në moshën 60 vjeçare. Sipas kësaj, dispozita që gjyqtari porotë mund të zgjidhet një person që nuk është më i vjetër se 60 vjeç është diskutabile, pasi ky person nuk ka kushte për të përfunduar mandatin dhe rrezikon të marrë pjesë në procedura penale për të cilat objektivisht nuk do të ketë kohë për t'i përfunduar. Nga ana tjetër, në vend të termi "gëzon reputacion" që është i përgjithshëm dhe i papërcaktuar, në drejtim të zvogëlimit të rreziqeve të korrupsionit, është e nevojshme të sigurohen kriteret më konkrete që do t'i referoheshin rrethanës që një person gëzon reputacion për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit porotë (për shembull: ai nuk është dënuar, nuk ka asnjë ndalim për ushtrimin e profesionit, etj.). Në paragrafin (3) të nenit në fjalë, termi "me përvojë pune në arsimin dhe edukimin e të rinjve" është një term i papërcaktuar sa duhet dhe lë hapësirë të gjerë për interpretim subjektiv të përmbushjes së këtij kushti.

Paragrafi (4) i nenit 42 nuk përmban mekanizma të mjaftueshëm parandalues për sa i përket pasojave të mos ndjekjes së trajnimit të specializuar. Ligjvënësi ka parashikuar se pjesëmarrja në trajnim është e detyrueshme, por nuk ka parashikuar pasoja për mosrespektimin e këtij detyrimi. Edhe në dispozitat që i rregullojnë kushtet e shkarkimit të gjyqtarëve porotë nuk është parashikuar shkarkimi për shkak të mos ndjekjes së trajnimit, kështu që në këtë rast mungon mekanizmi që do të garantonte zbatimin e kësaj dispozite.

Në paragrafin (1) të nenit 43¹ të LGJ janë specifikuar bazat e diskriminimit të parashikuara në Kushtetutë. Megjithatë, duke qenë se LPMD parashikon më shumë baza për diskriminim, ekziston konflikt i jashtëm me këtë ligj dhe është e nevojshme të harmonizohen dy zgjidhjet ligjore. Përveç kësaj, nuk janë parashikuar as mekanizma parandalues për zbatimin e plotë të dispozitës në praktikë, së këtejmi nuk është parashikuar as procedura, as pasojat që do të shfaqeshin nëse një autoritet kompetent konstaton se është bërë diskriminim gjatë zgjedhjes së gjyqtarit ose gjyqtarit porotë. Në paragrafin (2) të nenit në fjalë përdoret formulimi “të gjitha komunitetet”, i cili nuk është mjaft i qartë. Intenca e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat e qytetarëve vlen për të gjitha komunitetet etnike, prandaj është e nevojshme në këtë seksion të harmonizohet kjo zgjidhje ligjore me zgjidhjet e tjera ligjore. Paragrafi (3) i nenit 43 është në konflikt të jashtëm me Ligjin për Familjen, i cili e barazon bashkësinë jashtëmartesor dhe martesor me pjesën më të madhe të të drejtave dhe detyrimeve. Nëse e marrim parasysh qëllimin për të cilin është parashikuar ky ndalim, i cili në thelb ka për qëllim shmangien e konfliktit të interesave, është e qartë se dispozita në fjalë duhet të harmonizohet me Ligjin për Familjen. Për më tepër, ky paragraf ka një procedurë krejtësisht të papërcaktuar për sa i përket asaj nëse një gjyqtar ose gjyqtar porotë në mënyrë plotësuese lidh martesë me një gjyqtar ose gjyqtar porotë nga e njëjta gjykatë, ndërkaq mënyra në të cilën provohet kjo rrethanë nuk është përcaktuar (nëse kandidatët për gjyqtarë dhe gjyqtarë porotë duhet të paraqesin deklaratë, etj.).

Neni 45 paragrafi (1) alineja 9 e LGJ parashikon se për gjyqtar mund të zgjidhet personi që gëzon reputacion, posedon integritet për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit dhe posedon aftësi shoqërore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, për të cilat kryhen teste integriteti dhe teste psikologjike. Nuk ka një procedurë të rregulluar sa duhet për sa i përket përcaktimit të kushteve për atë që është “reputacioni e integriteti dhe aftësitë sociale për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit”, përkatësisht nuk ka sqarime se cili është pragu i pranueshëm i përmbushjes së këtyre kushteve. Ligjvënësi nuk ka përcaktuar parametra objektivë përmes të cilëve do të vlerësohen rezultatet e testeve, përkatësisht nuk ka caktuar parametra përmes të cilëve do të vlerësohet nëse rezultatet janë të kënaqshme apo jo, gjë që lë hapësirë për trajtim subjektiv dhe të pabarabartë.

Neni 52 i këtij ligji ka për qëllim rregullimin e papajtueshmërisë së mandatit të gjyqtarëve me ushtrimin e funksioneve të tjera. Kështu, paragrafi (2) i nenit në fjalë përcakton se gjyqtari nuk mund të ushtrojë asnjë funksion apo profesion tjetër publik, përveç funksionit të përcaktuar me ligj, i cili nuk bie ndesh me pavarësinë dhe autonominë e tyre në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Në paragrafin (4) të po këtij neni parashikohet se gjyqtari mund të mbajë ligjëratë në AGJPP dhe në institucionet e arsimit të lartë dhe të marrë pjesë në projekte shkencore. Nga ana tjetër, paragrafi (7) e ndalon gjyqtarin të jetë anëtar dhe të ushtrojë funksion politik në një parti politike ose të kryejë aktivitete partiake dhe politike.

Gjatë analizës së dispozitës së paragrafit (2) të nenit 52 me dispozitat e nenit 73, u identifikua ekzistenca e të ashtuquajturit konflikt i brendshëm i ligjit. Konkretisht në nenin 73 rregullohen bazat e pushimit të funksionit gjyqtar, ndërsa ushtrimi i një funksioni apo profesioni tjetër publik nuk parashikohet si bazë për pushimin e funksionit. Për të kapërcyer këtë lloj rreziku rregullator, është e nevojshme të precizohet dispozita, përkatësisht të parashikohet një mekanizëm parandalues në mënyrë që e njëjta të zbatohet në praktikë. Në paragrafin (4) të nenit 52 përdoret termi “projekte shkencore”, por nuk përcaktohet se për çfarë “projekte shkencore” bëhet fjalë, pra a bëhet fjalë për projekte që mbështeten financiarisht nga

¹ Neni 43

(1) Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë, nuk duhet të ketë diskriminim në lidhje me seksin, racën, ngjyrën e lëkurës, origjinën kombëtare dhe sociale, bindjen politike, besimin fetar, pozitën pasurore dhe shoqërore.

(2) Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë pa i shkelur kriteret e përcaktuara me ligj, do të sigurohet përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i qytetarëve që u përkasin të gjitha komuniteteve.

(3) Për gjyqtar ose gjyqtar porotë nuk mund të zgjidhet personi i cili me gjyqtarin ose gjyqtarin porotë në të njëjtën gjykatë është në lidhje farefisnore në linjë të drejtë ose në linjë anësore deri në shkallën e tretë ose është bashkëshorti/ja e tij.”

donatorët dhe brenda të cilave gjyqtarët mund të fitojnë të ardhura shtesë apo vetëm për projekte të mbështetura nga institucionet e arsimit të lartë. Në këtë kuptim, mungon edhe procedura në drejtim të përcaktimit të konfliktit të mundshëm të interesave të gjyqtarit me institucionin e arsimit të lartë ose zbatuesin e projektit shkencor dhe dispozitat në cilat situata gjyqtari nuk duhet të pranojë të marrë pjesë në projekte të tilla (kur duhet ta përjashtojë vetveten nga pjesëmarrja, si p.sh. se ai nuk duhet të jetë pjesë e projekteve që vënë në dyshim objektivitetin dhe paanësinë e tij, etj.). Gjithashtu, në dispozitat në fjalë nuk ka asnjë detyrim të përcaktuar që gjyqtarët të raportojnë dhe deklarojnë publikisht se në cilat projekte dhe me cilat institucione shkencore kanë bashkëpunuar, madje nuk ka as mekanizëm të vendosur kontrolli që do ta monitorojë pjesëmarrjen e tillë. Prandaj, është e nevojshme të parashikohet detyrimi për raportim për çdo projekt në të cilin gjyqtarët kanë marrë pjesë. Paragrafi (7) i nenit 52 përmban vokabular dy kuptimesh, përkatësisht, përdorimi i frazave dhe lidhëzave duhet të harmonizohet dhe duhet të jetë në një mënyrë që nuk do të krijojë dykuptimësi, kështu që lind pyetja nëse anëtarësimi në një parti politike vetvetiu është problematik apo është problematik vetëm kur anëtarësimi shoqërohet me një funksion politik.

Paragrafi (2) i nenit 67, e parashikon mundësinë që gjyqtari të jetë larguar nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit kur ka filluar procedura për përcaktimin e përgjegjësisë në përputhje me ligjin dhe kur ekzistojnë arsye të justifikuara për largimin nga ushtrimi i funksionit të përcaktuar me ligj. Konform paragrafit (3) të këtij neni, vendimi për largimin e gjyqtarit nga funksioni i gjyqtarit merret nga Këshilli Gjyqësor. Në funksion të këtij neni, termi “arsye të justifikuara” është një term i përgjithshëm dhe duke i pasur parasysh pasojat e parashikuara në këtë nen, është e nevojshme të përcaktohen kriteret sipas të cilave do të vlerësohet justifikimi i arsyeve të largimit nga ushtrimi i funksionit. Për më tepër, në paragrafin (3) të nenit në fjalë specifikohet se vendimi merret nga Këshilli Gjyqësor, por as Ligji për Këshillin Gjyqësor dhe as Rregullorja e Punës së Këshillit nuk përmbajnë dispozita shtesë që do të rregullonin këtë procedurë, që është një rrezik i veçantë sepse lë autorizim të gjerë diskrecional i cili nuk është rregulluar ose kufizuar me dispozita shtesë.

Duke e pasur parasysh nenin 70² paragrafët (1), (2) dhe (3) të LGJ, nevojitet që përzgjedhja e fjalëve dhe lidhëzave të ndjekë teknikën e zakonshme ligjore koherente legislative, gjë që nuk ndodh këtu. Kështu, dispozita është e dykuptimtë nga pikëpamja: nëse pjesa “në masën e përcaktuar nga gjykata në përputhje me ligjin” i referohet dëmit të paguar që gjykata tashmë e ka përcaktuar para pagesës, ose dëmit që duhet ta kompensojë gjyqtari. Nëse është rasti i dytë, duhet të kihet parasysh se kompensim të dëmit mund të kërkohej në shumën e paguar dhe jo “në lartësinë e përcaktuar nga gjykata në përputhje me ligjin” dhe sipas Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore, shumata e kërkuar duhet të përcaktohet, përkatësisht kontesti duhet të ketë vlerë. Paragrafi (3) i nenit në fjalë është gjithashtu i dykuptimtë, dhe për shkak të rrethanës që nuk përmban një procedurë të përcaktuar saktësisht, është në kundërshtim me ligje të tjera, kështu që:

1. Avokatura e Shtetit i mbron interesat pasurore të shtetit mund të përfshihet në një procedurë kompensimi të dëmit vetëm nëse shteti është i paditur nga personat që janë dëmtuar nga puna e paligjshme e gjyqtarit të shkarkuar;

² Neni 70

(1) Për dëmin që gjyqtari ose gjyqtari porotë në ushtrimin e funksionit do t'ua shkaktojë qytetarëve ose subjekteve juridike me punë të paligjshme, përgjegjëse është Republika e Maqedonisë. (2) Kur për shkak të dëmit të shkakuar nga paragrafi (1) i këtij neni, gjyqtari shkarkohet, Republika e Maqedonisë, me anë të padisë, do të kërkojë nga gjyqtari i shkarkuar ta kthejë shumën e dëmit të paguar sipas paragrafit (1) të këtij neni, në lartësinë e përcaktuar nga gjykata, në përputhje me ligjin. (3) Pas shkarkimit të gjyqtarit që u ka shkakuar dëm shtetasve ose personave juridikë me punë të paligjshme, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, brenda tetë ditëve nga forma e prerë e vendimit për shkarkim, e njofton Avokatura e Shtetit të ndërmarrë e masa konform paragrafit (2) të këtij neni, në kuadër të kompetencave të tij të përcaktuara me ligj.”

2. Avokatura e Shtetit do të mund të paraqesë padi për refundim vetëm pasi të jetë arkëtuar dëmi nga buxheti i shtetit, dhe

3. Është diskutabile që Avokatura e Shtetit, përveç mbajtjes së evidencës, mund të ndërmarrë 8 ditë pas shkarkimit të gjyqtarit, nëse nuk ka filluar procedura për kompensimin e dëmit ose nuk është kërkuar fare dëmshpërblim.

Edhe pse intenca e ligjvënësit është e qartë dhe e drejtë, dispozita është formuluar në mënyrë joadekuate dhe ekzistojnë rreziqe që në praktikë nuk do t'i arrijë efektet. Fakti që kompetencat e autoriteteve ndërthuren dhe nuk janë në korrelacion me ligjet ekzistues lë hapësirë për abuzime

1.2. Rreziqe për shkak të afateve të papërcaktuara

Duke mos u kufizuar në dispozitat e nenit 39 paragrafi (11) dhe nenit 40 paragrafi (2), për sa i përket përcaktimit të afateve, në disa dispozita të LGJ nuk është përcaktuar se kur fillojnë të llogariten afatet e parashikuara. Afatet e parashikuara ose afatet e pasakta paraqesin rrezik rregullator për korrupsion.

1.3. Rreziqe për shkak të autorizimeve të gjera diskrecionale

Në nenin 8 paragrafin (2) të LGJ parashikohet se “Gjykata nuk mund ta hedhë poshtë kërkesën për realizimin e një të drejte të caktuar me arsyetimin se ekziston një boshllëk ligjor dhe është e detyruar të vendosë për të, duke iu referuar parimeve të përgjithshme të së drejtës, përveç kur kjo ndalohej shprehimisht me ligj.” Megjithëse bëhet fjalë për parim ligjor që synon të vendosë gjykatën si autoritetin përfundimtar që nuk mund të thirret në mospasje të kompetencës kur një çështje nuk rregullohet saktësisht në kompetencën e një autoriteti, ky nen megjithatë parashikon autorizime diskrecionale për gjyqtarin që janë të përcaktuara gjerësisht, dhe për të cilat nuk parashikohen procedura dhe kriteret specifikë për mënyrën se si do të zbatohet ky autorizim nga gjyqtarët në praktikë. Përveç kësaj, ekziston një konflikt i jashtëm me ligjet procedurale (Ligjin për Procedurën Kontestimore, Ligjin për Procedurën Penale, Ligjin për Procedurën Jashtëkontestimore dhe Ligjin për Kontestet Administrative), ku nuk parashikohen dispozita procedurale që do t'u mundësonin gjyqtarëve ta realizojnë këtë autorizim që parashikohet me Ligj. Procedurat pamjaftueshëm të përcaktuara lënë hapësirë për qasje subjektive dhe interpretim subjektiv dhe së këtijmi zbatim të pabarabartë të ligjeve.

Neni 12 paragrafi (2) i LGJ parashikon se “Departamentet e specializuara gjyqësore formohen në varësi të llojit dhe vëllimit të punës në gjykatë, në fushën penale, delikuentë dhe fëmijëve, fushën civile, tregtare, kontestet e punës dhe për lloje të tjera të kontesteve nga fushëveprimi i punës së gjykatave.” Krijimi i departamenteve të specializuara mund të çojë në përqendrimin e pushtetit tek një numër i kufizuar gjyqtarësh, gjë që mund të rrisë rrezikun e ndikimit ose korrupsionit. Prandaj, është thelbësore të parashikohen mekanizma parandalues, të cilët në rastin konkret do të përfshinin përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për krijimin e departamenteve të specializuara gjyqësore, përmes të cilave do të dihet publikisht se në kompetencë të kujt është krijimi i departamenteve të specializuara gjyqësore dhe sipas cilave kriteret formohen këto departamente. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nga pikëpamja e mundësisë të qëndrueshmërisë dhe shmangies së konfliktit të brendshëm me dispozitat e tjera të këtij ligji, siç janë dispozitat për kompetencën lëndore/reale, ku rregullohet ligjërisht krijimi i departamentit të specializuar gjyqësor për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Në këtë drejtim, mbetet e paqartë pse disa departamente të specializuara janë krijuar me ligj, dhe për disa të tjerë është lënë mundësia të krijohen në mënyrë plotësuese.

Në përputhje me dispozitën e nenit 64, Ministri i Drejtësisë miraton akte normative të përafërta për kompensimet e gjyqtarëve porotë. Në një situatë kur gjyqtarët porotë i zgjedh Këshilli Gjyqësor dhe kur ata paguhën nga buxheti gjyqësor, është diskutabile pse Ministri i Drejtësisë do të përfshihej në

miratimin e akteve normative të përafërta për kompensimet e gjyqtarëve porotë. Kjo dispozitë paraqet rrezik për korrupsion, pasi pavarësia financiare e gjyqtarëve porotë varet nga vullneti i Ministrit të Drejtësisë, si përfaqësues i pushtetit ekzekutiv. Njëherësh, vihet re mospërputhja e dispozitave të këtij neni me dispozitat e tjera të LGJ, për sa i përket kompetencave të autoriteteve mbi rregullimin e çështjeve konkrete.

1.4. Rreziqe për shkak të mungesës së garancive procedurale dhe mekanizmave mbrojtës

Në nenin 18 të LGJ parashikohet mundësia që gjykata të paraqesë një nismë për ngritjen e procedurës për vlerësimin e përputhshmërisë së ligjit me Kushtetutën, kur në procedurë do të parashtrohet pyetja në lidhje me përputhshmërinë e tij me Kushtetutën. Në rast se dispozitat kushtetuese nuk mund të zbatohen drejtpërdrejt, ligjvënësi ka parashikuar ndërprerjen e procedurës përpara gjykatës deri në marrjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Duke e pasur parasysh se procedura e tillë nënkupton autorizim diskrecional të gjykatës, i cili nuk është i lidhur me afatet për veprim (rezulton se edhe në fazën e fjalëve përfundimtare, madje edhe në fazën e marrjes së vendimit, gjykata mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese), është e nevojshme procedura të rishikohet dhe të sqarohen afatet (fazat në procedurë) në të cilat gjykata mund ta ngrejë këtë çështje dhe kushtet kur gjykata e vlerëson se dispozitat kushtetuese nuk mund të zbatohen drejtpërdrejt. Ky rekomandim synon të zvogëlojë subjektivitetin në vlerësimin nëse dispozitat kushtetuese mund të zbatohen drejtpërdrejt, të inkurajohen gjyqtarët të zbatojnë drejtpërdrejt dispozitat kushtetuese dhe të unifikohet veprimi/trajtimi. Nga ana tjetër, paragrafi (3) i nenit në fjalë përcakton se procedura e ankimit është urgjente, por nuk parashikohen afate të veçanta si për paraqitjen e ankimit, ashtu edhe për miratimin e vendimit për ankimin, me ç'rast mungojnë mekanizmat parandalues për sigurimin e zbatimit të dispozitës së paragrafit (3) të këtij neni.

Neni 37 paragrafi (1) alineja 6 dhe 8 të Ligjit parashikojnë mundësinë që Gjykata Supreme të paraqesë propozim në Këshillin Gjyqësor për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit në një gjykatë tjetër, si dhe të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës. Në këto dispozita ekziston një procedurë jo plotësisht e përcaktuar në kuptimin se kur, si dhe pse Gjykata Supreme në një seancë të përgjithshme mund të propozojë transferimin e përkohshëm të gjyqtarit. Kjo mangësi duhet të merret parasysh veçanërisht nëse ndërlidhet me dispozitat e Rregullores së Punës së Gjykatës Supreme, në të cilën nuk janë përfshirë dispozita për rirregullimin e mundësisë së tillë. Në rast të mungesës së kritereve të matshme me të cilat Gjykata Supreme do të udhëhiqej gjatë propozimit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, kjo dispozitë mund të jetë objekt i shpërdorimeve dhe trajtimit subjektiv/të pabarabartë. Përveç kësaj, ajo që është veçanërisht kontestuese me këtë dispozitë është rrethana që ka një konflikt të brendshëm të saj me dispozitën e nenit 39 të Ligjit, sepse në procedurën e kundërshtimit të vendimit të Këshillit Gjyqësor për transferimin e përkohshëm vendos Gjykata Supreme në seancë të përgjithshme. Së këtijmi, rezulton se ekziston rreziku i mbivendosjes së funksioneve brenda të njëjtës procedurë: gjyqtarët që janë paraqitur si iniciatorë të procedurës, të vendosin edhe në procedurën e kundërshtimit.

Në mënyrë të ngjashme, në lidhje me kërkesën për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës, shfaqet një procedurë jo plotësisht e përcaktuar në kuptimin kur mund të paraqitet një kërkesë për fillimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës. Kjo veçanërisht në korrelacion me dispozitat e Rregullores së Punës së Gjykatës Supreme, në të cilën nuk janë përfshirë dispozita me të cilat rirregullohet mundësia e tillë. Për më tepër, ajo që është veçanërisht problematike është rrethana që ekziston një konflikt i jashtëm me dispozitën e nenit 72 të LKGJ, sepse në procedurën e ankimit kundër vendimit për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës, vendos Këshilli për vendimmarrje ndaj ankimit pranë Gjykatës Supreme, i cili përbëhet nga tre gjyqtarë të Gjykatës Supreme, kështu që parashtrohet çështja e konfliktit të interesave

të këtyre anëtarëve, duke qenë se paraprakisht në një seancë të përgjithshme është shqyrtuar çështja dhe pikërisht nga seanca e përgjithshme u iniciua procedura. Së këtejmi, rezulton se ekziston rreziku i mbivendosjes së funksioneve në kuadër të procedurës së njëjtë: gjyqtarët që janë paraqitur si iniciatorë të procedurës, të vendosin edhe në procedurën ankimore.

Dispozitat e nenit 39 të LGJ e rregullojnë zgjedhjen, përkatësisht specializimin e gjyqtarit dhe transferimin e përkohshëm të gjyqtarit. Në paragrafin (2) të të njëjtit nen, ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë jo të plotë procedurën në lidhje me rastet kur mund të ketë përjashtime nga rregulli, përkatësisht kur orari i punës mund të devijojë nga fusha për të cilën gjyqtari është zgjedhur të gjykojë, duke lënë hapësirë për interpretim subjektiv dhe zbatim të ndryshëm. Njëherësh, nuk janë parashikuar mekanizma parandalues për të siguruar përmbushjen e garancisë së tillë ligjore. Lidhur me dispozitën e paragrafit (5) të nenit 39, sipas të cilit gjatë përcaktimit të kryetarëve të departamenteve dhe seksioneve të specializuara respektohet përvoja e punës e gjyqtarit dhe rezultatet e punës,, është e nevojshme të bëhen parashikimet e duhura të mekanizmave parandalues, të cilat në këtë rast do të nënkuptonin përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për caktimin e kryetarëve të këtyre departamenteve dhe seksioneve, veçanërisht në aspektin e sigurimit të gjyqtarëve me integritet dhe rezultate të konfirmuara (të mos jenë të dënuar me masa disiplinore, të kenë përvojë pune disa vjeçare në fushën përkatëse, etj.). Në paragrafin (10) të nenit 39 gjenden procedura jo plotësisht të përcaktuara, sepse nuk parashikohet se kush mund të iniciojë procedurë për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit të gjykatës së apelit dhe gjykatës themelore, përkatësisht tek kompetencat e Gjykatës Supreme theksohet se propozim mund të bëjë Gjykata Supreme në një seancë të përgjithshme, por nuk është e qartë nëse një procedurë e tillë mund të iniciohet nga Këshilli Gjyqësor ex-fficio, me iniciativën e Kryetarit të Gjykatës, etj. Në paragrafin (11) të nenit të theksuar, sipas të cilit gjyqtari kundër vendimit për transferimin e përkohshëm mund të paraqesë kundërshtim brenda tre ditëve në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, e cila nga ana e saj është e detyruar të vendosë për kundërshtimin brenda shtatë ditëve, mund të vërehet mungesa e mekanizmit parandalues, pasi dispozita nuk ka sqarim për detyrimin e vendimit të Gjykatës Supreme dhe çfarë do të thotë kjo nga pikëpamja e krijimit të një orari të ri dhe zbatimit të orarit tashmë të miratuar. Gjithashtu është e paqartë se prej cilës ditë konsiderohet se fillon të rrjedhë afati i paraqitjes së kundërshtimit në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme.

Neni 40 paragrafi (1) i këtij ligji e rregullon trajtimin në rast të suprimimit ose riorganizimit të gjykatës, me ç'rast Këshilli Gjyqësor do ta sistematizojë gjyqtarin në një gjykatë tjetër të së njëjtës shkallë ose të një shkalle më të ulët, me ç'rast paga e gjyqtarit nuk duhet të ulet. Ekziston një procedurë e papërcaktuar sa duhet për sa i përket kriterëve me të cilat Këshilli do të udhëhiqet kur e transferon gjyqtarin në një shkallë më të ulët, gjë që e bën të paqartë nëse transferimi i tillë është përjashtim apo varet nga nevojat dhe situatat reale, kështu që nëse ka vend në një gjykatë të së njëjtës shkallë, mund ta transferojë gjyqtarin në një gjykatë me shkallë më të ulët. Ka mungesë të mekanizmave parandalues sa i përket të drejtave të gjyqtarit të transferuara, sepse përveç pagës, puna në një shkallë më të lartë ndikon edhe në mundësitë për avancimin e ardhshëm të gjyqtarit, kështu që nuk janë parashikuar mekanizma që do t'i mundësonin gjyqtarin të mos e humbasë këtë të drejtë.

Neni 45-a paragrafi (4) i Ligjit parashikon se për zbatimin e testit psikologjik dhe pjesën e parë të testit të integritetit, Këshilli Gjyqësor angazhon ekspertë nga një institucion profesional i pavarur dhe plotësisht i akredituar. Në dispozitën e theksuar, janë identifikuar disa rreze: së pari, nuk janë parashikuar mekanizma parandalues për zbatimin konsekuent të dispozitës në praktikë dhe ruajtjen e objektivitetit në trajtimin e situatave kur për shkak të ekzistencës së konfliktit të interesave me ndonjërin nga kandidatët do të ishte e detyrueshme të përjashtohet institucioni që i zbaton testet në kushtet kur një nga kandidatët. Për më tepër, dispozita ashtu siç është përcaktuar është e pazbatueshme sepse nuk ka asnjë institucion – institucione “plotësisht të akredituar/a” apo janë ose nuk janë të akredituara. Në

praktikë, kontestuese është ajo se nuk ekziston asnjë institucion që është i akredituar për të kryer testime të tilla, kështu që megjithëse dispozita ekziston në praktikë, ajo shkelet sepse në të kundërtën nuk do të jetë e mundur të zgjidhen gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë.

Në nenin 46 paragrafin (1) të LGJ në disa aline përdoret termi “përvoja e punës gjyqësore e pandërprerë”, term i cili është i paqartë dhe mund të lërë hapësirë për interpretim subjektiv në lidhje me faktin nëse përvoja e punës gjyqësore duhet të jetë në kohëzgjatje të pandërprerë deri në momentin e zgjedhjes në një gjykatë më të lartë ose në momentin e zgjedhjes personi që është kandidat nuk kërkohet të ketë cilësinë e gjyqtarit, por mjafton që në të kaluarën të ketë pasur përvojë pune gjyqësore të pandërprerë.

Gjyqtarët porotë, duke e pasur parasysh rolin që ata e luajnë në procedurat dhe mënyrën në të cilën është rregulluar zgjedhja e tyre, përfshirë edhe rrethanat se zgjidhen me mandat të kufizuar, si të këtillë përbëjnë një aspekt veçanërisht të rrezikshëm të korrupsionit. Një nga rekomandimet për rritjen e pavarësisë së gjyqtarëve është pikërisht përcaktimi i mandatit të përhershëm, kështu që është e paqartë pse nuk ruhet i njëjti parim kur bëhet fjalë për gjyqtarët porotë. Mandati i kufizuar i gjyqtarëve porotë, në përputhje me nenin 49 të këtij ligji, krijon rrezik varësie dhe servilizmi ndaj ndjekjes së mendimeve të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, me shpresën e marrjes së një mandati të ri. Kështu, ekziston rreziku i reduktimit të objektivitetit të gjyqtarëve porotë gjatë procedurës. Mandati i kufizuar lë rreziqe edhe për sa i përket kohëzgjatjes së procedurave dhe shpërdorimit të autorizimeve procedurale nga palët, kur ata e dinë se në kuadër të procedurës gjyqësore, mandati i gjyqtarit porotë i skadon, kështu që presionet janë të mundshme që mandati të mos vazhdojë, me synimin për të ndikuar në procedurë. Praktika tregon se procedimet penale të profilin të lartë kanë filluar përsëri pikërisht për shkak të përfundimit dhe mos vazhdimin të mandatit të gjyqtarit porotë ose për shkak të ndërprerjes së parakohshme të detyrës së tij me kërkesë të tij. Duke i marrë parasysh sa më sipër, është e nevojshme të shqyrtohet në detaje roli dhe pozita e gjyqtarit porotë në procedurat gjyqësore, veçanërisht në drejtim të zvogëlimit të rreziqeve të korrupsionit.

Sipas nenit 51, gjyqtarët mund të krijojnë shoqata me qëllim të realizimit të të drejtave dhe interesave të tyre, nxitjen e zhvillimit profesional dhe mbrojtjen e pavarësisë dhe autonomisë së funksionit të gjyqtarit. Nuk ka dyshim se e drejta e asociimit/shoqërimit si një nga të drejtat kushtetuese duhet tu njihet edhe gjyqtarëve. Megjithatë, duke e pasur parasysh specifikat e këtij lloji të shoqatës, e cila në vetvete bart përqendrim të madh të pushtetit në një vend, është e nevojshme të përshkruhen mekanizma shtesë parandalues që do të sigurojnë që një shoqatë e tillë nuk do të përfitojë nga disa qëllime të tjera dhe nuk do ta tejkalojë nevojën thelbësore për asociim. Në këtë drejtim, kryesisht mungojnë mekanizmat me të cilët do të rregullohej financimi dhe funksionimi financiar i shoqatave të gjyqtarëve, si një nga pikat që janë veçanërisht të rrezikshme për sa i përket korrupsionit. Ligji për Shoqata dhe Fondacione në përgjithësi ofron udhëzime për financimin, kështu që nëse e shikoni Statutin e Shoqatës së Gjyqtarëve, është e qartë se është e nevojshme të kufizohen burimet e financimit të këtyre shoqatave sepse statusi aktual lejon që fondet për financimin e Shoqatës të fitohen nga kontributet vullnetare, donacionet, dhuratat, trashëgimitë dhe burime të tjera. Këto lloje të financimit janë të rrezikshme nga pikëpamja e korrupsionit, sepse situatat nuk janë të përshkruara kur këto forma të financimit do të ishin të pranueshme, ndërsaq situatat nuk janë të përcaktuara kur format e financimit që bartin rrezikun potencial të korrupsionit domosdoshmërisht duhet të refuzohen. Për më tepër, dispozita e nenit 38 të Statutit të Shoqatës së Gjyqtarëve, e cila parashikon mundësinë e krijimit të një SHPK-je dhe SHA-je për të arritur qëllimet, interesat dhe aktivitetet e saj dhe për të financuar funksionet e saj të përcaktuara me statutin, gjithashtu mund të prodhojë rrezik të korrupsionit, pasi qëllimi i shoqatës me ligj është jofitimprurës. Prandaj, është jashtëzakonisht e rëndësishme të adresohen çështjet e financimit,

transparencës dhe kufizimet e përgjithshme që Shoqata e Gjyqtarëve do t'i kishte kundrejt çdo organizate ose shoqate tjetër jofitimprurëse.

Në nenin 58 të LGJ parashikohet ndalimi i gjyqtarit në lidhje me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të marrë dhurata ose të përdorë favore dhe lehtësime të tjera. Së këtejmi, mungojnë mekanizma parandalues që do të përcaktojnë pasojat e mosrespektimit të këtij ndalimi. Nga ana tjetër, në dispozitën e theksuar nuk ka përkufizim apo kritere se çfarë nënkuptohet me termin “favore dhe lehtësime”, të cilat, edhe pse janë të përfshira në LGJ, nuk specifikohen në Kodin Etik të Gjyqtarëve dhe Gjyqtarëve Porotë, duke lënë kështu një hapësirë të gjerë për interpretime të ndryshme që mund të çojë në zbatimin e pabarabartë të ligjit. Dhuratat, favorët dhe lehtësimet e tjera përbëjnë rrezik të korrupsionit, pasi ato shpesh mund të vënë interesin privat të personave zyrtarë përpara interesit publik.

Në nenin 60 paragrafin (2) të Ligjit përcaktohet se paga e gjyqtarëve gjatë kohëzgjatjes së funksionit të gjyqtarit nuk duhet të zvogëlohet, përveç rasteve të përcaktuara me ligj. Edhe pse kjo dispozitë ligjore ka për qëllim ruajtjen e pavarësisë dhe mëvetësisë së gjyqtarëve, megjithatë ekziston rreziku nga korrupsioni për sa i përket faktit që LPGJ miratohet me shumicë absolute, ndërsa standardi i mos uljes së pagës përcaktohet me ligj i cili miratohet me dy të tretën e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Prandaj, mundësia që pagat të rregullohen dhe me këtë edhe të zvogëlohen me ligj i cili miratohet me një shumicë më e vogël se ligji që i garanton standardet që duhet të sigurojnë pavarësinë e gjyqësorit është jokonsistente me qëllimin e këtyre dispozitave, që janë një rrezik i llojit të vet të korrupsionit dhe ndikon në pavarësinë e gjyqësorit.

Në përputhje me nenin 68 të këtij ligji, gjithsecili ka të drejtë të paraqesë një parashtrësë me shkrim deri te Kryetari i Gjykatës për shkak të sjelljes së pahijshme ose të pashembullt të gjyqtarit në marrëdhëniet zyrtare me palët dhe të marrë përgjigje për të njëjtën. Parashtrësat në lidhje me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit duhet të shqyrtohen shpejt, në mënyrë të drejtë dhe pa publicitet të procedurës nga organet pranë të cilave janë paraqitur. Lidhur me paragrafin(1) të këtij neni, nuk ka procedura mjaftueshëm të përcaktuara, veçanërisht pasi paraqitja e parashtrësave është objekt rregullimi i një ligji tjetër, kështu që është e paqartë se cilat dispozita do të zbatoheshin në një situatë të caktuar. Vetë rregullimi i dyfishtë i procedurave mbart rrezikun e korrupsionit dhe zbatimit arbitrar të dispozitave. Paragrafi (2) i nenit në fjalë parashikon një interpretim “të shpejtë dhe të drejtë”, i cili lë hapësirë për një interpretim të gjerë, veçanërisht në një situatë kur me një ligj të veçantë përcaktohen afatet konkrete për veprim. Me qëllim të zvogëlimin të rreziqeve ekzistuese rregullatore, është e nevojshme të harmonizohen dispozitat në fjalë me Ligjin për Shqyrtimin e Parashtrësave dhe Propozimeve.

Me nenin 73 ligjvënësi e rregullon pushimin e mandatit të gjyqtarit, kështu që në paragrafin (2) të këtij neni parashikohet se Këshilli Gjyqësor, brenda dhjetë ditëve nga data e vënies në dijeni për shfaqjen e rrethanës që përbën bazën për pushimin e mandatit të gjyqtarit, përcakton pushimin e funksionit të gjyqtarit, me ç'rast gjyqtarit i ndërpritet edhe e drejta e pagës. Në dispozitën e theksuar, afati fillon të rrjedhë nga dita e vënies në dijeni, që është një moment subjektiv dhe përbën rrezik të korrupsionit. Në këtë drejtim, është diskutabile nëse informacioni i ndarë në mediat mund të merret si dita e vënies në dijeni sa i përket një rrethane të caktuar. Prandaj, është e nevojshme në këtë kuptim të rishikohet dispozita. Në përputhje me dispozitat e nenit 73, në dy alinetë e parë, Këshilli Gjyqësor tashmë ka evidencë dhe të dhëna ndërsa këto aspekte nuk janë kontestuese nga dita e vënies në dijeni, por duke qenë se gjyqtari nuk do të ketë interes të raportojë një rrethanë sipas nenit 52 paragrafët (1) dhe (7), ndërsa në mungesë të një shkrese me shkrim nga pala ose të një artikulli mediatik, shtrohet çështja se si Këshilli do të vihet në dijeni për shfaqjen e këtyre rrethanave. Duke e pasur parasysh rëndësinë e autorizimit të Këshillit Gjyqësor të përcaktuar në këtë nen, në drejtim të kufizimit të hapësirës për

shpërdorime, rekomandohet që, përveç afatit subjektiv, të përcaktohet edhe një afat i caktuar objektiv brenda të cilit Këshilli Gjyqësor do të duhet ta përcaktojë pushimin e funksionit të gjyqtarit.

2. Analiza e dispozitave të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe një pjese të akteve nënligjore dhe të përgjithshme që rezultojnë nga i njëjti

Titulli: Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 102/2019 dhe 51/2023).

Shqyrtimi i kërkesës: Kuadri ligjor që e rregullon gjyqësorin luan një rol kyç në sigurimin e pavarësisë, përgjegjësisë dhe integritetit të institucioneve gjyqësore. Në rastin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, LKGJ është guri themeltar i sistemit juridik, me detyrën e ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit dhe promovimit të efikasitetit në zbatimin e drejtësisë. Megjithatë, ndjeshmëria e ligjeve ndaj veprimeve korruptive dhe abuzimit të tyre është sfida themelore, veçanërisht në një rajon që përballlet me probleme të vazhdueshme të korrupsionit në të cilin mbretëron skepticizmi i publikut ndaj integritetit institucional.

Materialet e shqyrtuara/ konsultuara:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. LPKKI ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr.12/2019;
3. LKGJ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 102/2019, 51/2023);
4. Rregullorja e Punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 274/2019, 186/2020, 5/2023, 17/2024);)
5. LGJ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/06, 62/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19)
6. Rregullore për mënyrën e rankimit të kandidatëve për zgjedhjen e gjyqtarit në një gjykatë më të lartë, numri i arkivor 01-245/1 datë 04.02.2020 dhe 02-1083/1 datë 31.05.2024;
7. Udhëzues për mënyrën e përllogaritjes së orëve efektive të punës (tekst i konsoliduar), numri arkivor 02-1257/1 datë 26.06.2024;
8. Rregullore për Mënyrën e Themelimit të Komisionit për Verifikimin e Përmbushjes së Kushteve dhe Kriteve për Zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës, si dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit, numri arkivor 01-584/1 datë 13.03.2023;
9. Metodologjia me indikatorë për përcaktimin e kompleksitetit të lëndëve, numri arkivor 02-1395/1 datë 07.09.2021, dhe 02-1448/1 datë 25.08.2022;
10. Rregullore për Themelimin dhe Punën e Komisioneve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vlerësimin e rregullt dhe të jashtëzakonshëm, numri arkivor 01-548/1 datë 30.03.2022;
11. Rregullore për Mënyrën e Krijimit të Komisioneve për Notimin e Punës së Gjyqtarëve dhe Kryetarëve të Gjykatave, numri arkivor 01-1483/1 datë 24.09.2021;
12. Metodologjia për vlerësimin kualitativ të kryetarëve të gjykatave, numri arkivor 01-1982/1 të datës 21.12.2020, dhe
13. Metodologjia e vlerësimit të punës së gjyqtarit bazuar në përmbushjen e kriteve kualitative për punën e gjyqtarit, numri arkivor 01-1981/1 datë 21.12.2020.

Kjo analizë e LKGJ e shqyrton përmbajtjen e tij, mekanizmat e zbatimit dhe kornizat ekzekutive në mënyrë që të zbulohen fragilitetet e mundshme ndaj korrupsionit. Duke aplikuar KAL, qëllimi është të vlerësohet nëse dispozitat legjislative inkurajojnë transparencën, llogaridhënien dhe paanshmërinë apo nga ana tjetër krijojnë mundësi për ndikim joadekuat, konflikt të interesave dhe mungesë mbikëqyrjeje.

Rëndësia e KAL të LKGJ rritet në rast se besimi i publikut ndaj gjyqësorit është i brishtë. Korrupsioni në sistemet gjyqësore e rrënon sundimin e ligjit, e gërryen qeverisjen demokratike dhe e pengon zhvillimin socio-ekonomik. Duke i detektuar këto rreziqe, shteti filloi reforma gjithëpërfshirëse për të forcuar gjyqësorin dhe për ta harmonizuar atë me standardet e BE-së si pjesë e procesit të anëtarësimit. Këto reforma përfshijnë një shqyrtim kritik të LKGJ për të siguruar se ai është rezistent ndaj praktikave korruptive.

Kjo analizë përqendrohet në identifikimin e fushave të prirura ndaj rrezikut nga korrupsioni në kuadrin legjislativ. Fushat kryesore të kontrollit e përfshijnë përbërjen dhe zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, procedurat e emërimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve, mekanizmat e mbikëqyrjes dhe masat mbrojtëse kundër ndërhyrjeve të jashtme. Së fundi, objektivi i KAL është i dyfishtë: ta forcojë integritetin dhe efektivitetin e Këshillit Gjyqësor dhe të kontribuojë në përpjekje më të gjera për të nxitur një sistem gjyqësor që e fiton besimin e publikut.

Me LKGJ rregullohet procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, mënyra e ushtrimit të funksioneve të tij, zgjedhja, pushimi dhe shkarkimi i gjyqtarit dhe gjyqtarit porotë, procedura e përcaktimit të përgjegjësisë së gjyqtarit/kryetarit të gjykatës, përcaktimi i ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit, monitorimi dhe vlerësimi i punës së gjyqtarëve, mënyra e punës dhe vendimmarrjes dhe çështje të tjera që lidhen me punën e Këshillit Gjyqësor.

KONKLUZION

Pas analizës së LKGJ, akteve nënligjore dhe akteve të përgjithshme që rezultojnë prej tij, u identifikuan mangësi që mund të prodhojnë rreziqe për korrupsion. Mangësitë e detektuara në Ligjin mund të kategorizohen në kategoritë si vijon:

- 2.1. Rreziqe që lidhen me mandatin e anëtarëve
- 2.2. Rreziqe për shkak të dispozitave të paqarta, të dykuptimta dhe të paspecifikuara
- 2.3. Rreziqe për shkak të afateve të papërcaktuara
- 2.4. Rreziqe për shkak të mungesës së garancive procedurale dhe mekanizmave mbrojtës

2.1. Rreziqe që lidhen me mandatin e anëtarëve

Rreziku i parë i cenimit të pavarësisë gjyqësore është i dukshëm në nenin 6 të ligjit, i cili e rregullon përbërjen e Këshillit, kështu që ky nen parashikon që sipas funksionit dy funksionarë të jenë anëtarë të Këshillit, njëri prej të cilëve Ministri i Drejtësisë. Ky rrezik vihet re edhe në opinionin e Komisionit të Venecias³, pra bëhet fjalë për një çështje që lidhet me amendamentet Kushtetuese, pasi përbërja e Këshillit parashikohet pikërisht me aktin më i lartë ligjor, gjë që i vështirëson përpjekjet për ndryshimin e legjislacionit për largimin e anëtarëve sipas funksionit.

Neni 7 i këtij ligji e rregullon mandatin e anëtarëve të Këshillit, kështu që i njëjti kufizohet në 6 vjet, me të drejtën e rizgjedhjes. Në këtë drejtim, ligji bën dallimin midis anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, të cilët e kanë të drejtën e rizgjedhjes vetëm pas kalimit të 6 viteve nga përfundimi i mandatit

³ [North Macedonia - Opinion on the Draft Law on the Judicial Council, adopted by the Venice Commission at its 118th Plenary Session \(Venice, 15-16 March 2019\) - Venice Commission of the Council of Europe](#)

të parë, si dhe anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, të cilët nuk kanë kufizime të tilla. Afati i gjatë i mandatit, siç parashikohet në këtë nen, është rrezik për korrupsion dhe konfliktin të interesave, gjë që theksohet veçanërisht në mesin e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, sepse ata mund të jenë anëtarë të Këshillit deri në 12 vjet me radhë. Afati i gjatë në kombinim me pak dispozita që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e anëtarëve të Këshillit, ndikojnë në shfaqjen e rreziqeve të korrupsionit dhe shfaqjen e konfliktit të interesave, prandaj është e nevojshme të merret parasysh zvogëlimi i kohëzgjatjes së mandatit dhe ndoshta pamundësimin e mandatit të dytë, ngjashëm si me përbërjen e KSHPK-së.

2.2. Rreziqe për shkak të dispozitave të paqarta, të dykuptimta dhe të paspecifikuara

Neni 8 i këtij ligji i referohet Kryetarit të Këshillit, zgjedhjes së tij dhe kohëzgjatjes së mandatit, ku rreziqet e identifikuar janë në lidhje me mungesën e mekanizmit për tejkalimin e situatës kur nuk mund të zgjidhet kryetari. Kjo situatë mund të jetë veçanërisht problematike nëse njëkohësisht pushojnë mandatet e kryetarit dhe zëvendëskryetarit. Në këtë drejtim, neni 5 i Rregullores së Punës të Këshillit Gjyqësor përcakton se seanca për zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit caktohet 7 ditë para përfundimit të mandatit, ndërsa zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të ri zhvillohet në ditën e përfundimit të mandatit. Siç mund të shihet nga sa më sipër, në dispozitat e theksuara nuk ka zgjidhje për mënyrën e zgjedhjes së kryetarit dhe zëvendëskryetarit në rast të ndërprerjes së parakohshme të mandatit. Prandaj, nevojitet të inkorporohet një mekanizëm për tejkalimin e situatës, si në tekstin ligjor ashtu edhe në Rregulloren e Punës. Veç tjerash nevojitet të precizohet nëse shumica e nevojshme për zgjedhjen e kryetarit është nga anëtarët e pranishëm në seancë, ose nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

Neni 11 i ligjit i parashikon kushtet për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit dhe brenda tij shfaqen disa rreziqe që lidhen me korrupsionin dhe konfliktin e interesave. Fillimisht, gjatë përcaktimit të kushteve për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit nga radhët e gjyqtarëve, ligji përcakton se një nga kushtet është që gjyqtarit të mos i është shqiptuar masa disiplinore me vendim të formës së prerë ulja e pagës në lartësinë prej 15% deri në 30% të pagës mujore e cila është në fuqi në momentin e publikimit të shpalljes. Dispozita e përcaktuar në këtë mënyrë është në kundërshtim me vetë ligjin, i cili parashikon që anëtarët e Këshillit duhet të gëzojnë reputacion dhe integritet, gjë që është në kundërshtim me gjyqtarin të cilit i është shqiptuar masa disiplinore. Pastaj, në paragrafin (2) dhe (3) të nenit të theksuar parashikohet që si kandidat për anëtar të Këshillit i zgjedhur nga Kuvendi mund të paraqitet çdo person, përkatësisht Presidenti i Republikës, të propozojë një person që, ndër të tjera, është dalluar me punën shkencore ose profesionale ose me veprimin e tij publik. Në këtë drejtim, po flasim për terma jashtëzakonisht të paqartë që mund të jenë objekt i interpretimit të gjerë, dhe të abuzimit të plotë të dispozitave në mënyrë që të bëhet zgjedhja që nuk bazohet në sistemin e profesionalizmit dhe meritës. Ky rrezik u identifikua nga KSHPK-ja në vitin 2022 dhe mbetet i rëndësishëm edhe aktualisht, prandaj është e nevojshme që dispozitat të formulohen në mënyrë më përkatëse dhe të shmanget përdorimi i termave që janë të paqartë dhe gjithëpërfshirës. Paragrafi (5) i këtij neni kontribuon në mënyrë plotësuese në këtë situatë, pasi parashikon që anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi janë nga radhët e profesorëve universitar të drejtësisë, avokatë, ish-gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarë ndërkombëtarë dhe juristë të tjerë të shquar. Pra, përsëri, edhe pse bëhen përpjekje për të sqaruar dhe kufizuar rrethin e kandidatëve të përshtatshëm, megjithatë përdorimi i termit “juristë të tjerë të shquar” e bën të kotë këtë përpjekje dhe mundëson një interpretim të gjerë dhe të ndryshëm të këtij termi, dhe me këtë edhe një praktikë të ndryshme të trajtimit madje edhe me shpërdorim të plotë. Nga ana tjetër, edhe pse ligji cakton kufizime që anëtari i Këshillit i zgjedhur nga Kuvendi nuk mund të jetë një person i cili në katër vitet e fundit ka qenë deputet, anëtar i Qeverisë ose ka ushtruar një funksion në një organ të partisë politike, është diskutabile nëse ky kufizim është një garanci e mjaftueshme. Prandaj, rekomandohet që këto dispozita të harmonizohen me

dispozitat e LPKKI që kanë të bëjnë me zgjedhjen e anëtarit të KSHPK-së ndërsa ky afat të rritet në 10 vjet.

Në mënyrë plotësuese, rreziqe rregullatore të korrupsionit janë konstatuar edhe në lidhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji, ku rregullohet kandidatura për anëtarin e Këshillit nga radhët e gjyqtarëve. Me fjalë të tjera, neni përcakton se nevojitet që kandidatët të paraqesin edhe të dhëna për përvojën e punës gjyqësore dhe notat e performancës të dhëna nga Këshilli, të cilat për nga natyra janë të dhëna dhe dokumente që Këshilli duhet t'i posedojë për secilin prej gjyqtarëve. Kështu që, Këshilli e ka mundësinë e zbatimit të ndryshëm të këtyre dispozitave, përkatësisht mungesa e këtyre të dhënave të interpretohet me alternime se kandidatura nuk i plotëson kushtet, ose se e njëjta është e pranueshme duke qenë se Këshilli tashmë i posedon të dhënat e nevojshme. Nga ana tjetër, duke i pasur parasysh afatet e shkurtra për paraqitjen e kandidaturave, në praktikë, tashmë është vënë re një situatë kur kandidati nuk i ka paraqitur të dhënat që duhet të sigurohen nga AGJPP, pasi ajo nuk ia ka dërguar në kohë kandidatit. Rreziqet e përcaktuara në këtë mënyrë, pasuar me mungesën e dispozitave që do të ishin një lloj mekanizmi garancie për kandidatët, e imponojnë nevojën e ndryshimit të këtij neni ndërkaj të dhënat e specifikuar Këshilli t'i sigurojë ex-officio, dhe në vend të kësaj kandidatët të paraqesin program të specifikuar pune, ose një letër motivimi për paraqitjen e kandidaturës të cilat më pas do t'u prezantohen gjyqtarëve të cilët duhet të votojnë për zgjedhjen e anëtarit.

Dispozitat e nenit 15 të ligjit përcaktojnë se anëtari i Komisionit për përgatitjen e listave të kandidatëve nuk mund të jetë edhe anëtar i Komisionit për zbatimin e zgjedhjeve të anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjyqtarëve dhe anasjelltas. Së këtejmi, kompetencat e komisioneve të përmendura nuk janë të përcaktuara taksativisht, duke lënë hapësirë për interpretim të lirë dhe zbatim të ndryshëm, që është një rrezik i mundshëm për korrupsion.

Në nenin 24 të këtij ligji përcaktohet se cili fletëvotim është i pavlefshëm, që është disi e pazakontë dhe në kundërshtim me përkufizimin nga ajo që parashikohet në Kodin Zgjedhor, ku është përcaktuar se çfarë mund të konsiderohet si vullnet i shprehur qartë për votën e dhënë. Prandaj, është e nevojshme të riprecizohet dispozita në fjalë për sa i përket asaj që konsiderohet fletëvotim i vlefshëm, që e pasqyron në mënyrë të qartë vullnetin e gjyqtarit i cili voton.

Nenet 29 dhe 30 të ligjit i referohen bërjes së deklaratës solemne të kandidatëve të zgjedhur dhe konstituimit të Këshillit, megjithatë, asnjë nga këto nene ose dispozitat e tjera të ligjit nuk e përcaktojnë në mënyrë të qartë se kur fillon mandati i anëtarëve të Këshillit. Në këtë drejtim, nuk është e qartë nëse deklarata ka karakter konstitutiv apo deklarativ, prandaj është e nevojshme të rishikohen këto dispozita dhe të përcaktohet saktësisht se kur konsiderohet se fillon mandati i anëtarëve të zgjedhur. Në korrelacion me LPKKI, kjo çështje është substanciale për t'u adresuar, pasi që nga momenti i zgjedhjes llogariten afatet për paraqitjen e deklaratave për gjendjen pronësore dhe interesat, kështu që në drejtim të shmangies së interpretimit subjektiv të dispozitave, nevojitet të njëjtat të rishikohen.

Neni 31 i këtij ligji e rregullon pushimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit, kështu që në paragrafin (1) alinenë 4 specifikohet se baza për pushimin e mandatit është nëse gjyqtari dënohet për vepër penale me dënim të pakushtëzuar me burgim prej së paku gjashtë muaj, gjë që e bën atë të padenjë për ushtrimin e funksionit anëtar i Këshillit, që është një përkufizim i paqartë se cila vepër mund të konsiderohet se e bën të padenjë, dhe që nuk ndikon mbi reputacionin. Gjithashtu nuk parashikohet se baza për pushimin e mandatit është nëse nuk përjashtohen në situatën e ekzistimit të konfliktit të interesave, që është baza për shkarkimin e gjyqtarit, prandaj është e nevojshme të ketë standarde të barabarta ose më të rrepta për anëtarët e Këshillit. Në paragrafin (2) të këtij neni parashikohet se mandati pushon kur Këshilli, përkatësisht Kuvendi në seancë do ta miratojë dorëheqjen. Por parashtrohet pyetja a ka mundësi që

dorëheqja të mos miratohet dhe çfarë nëse Këshilli ose Kuvendi nuk e miratojnë dorëheqjen. Për të zvogëluar rrezikun e përcaktuar rregullator, është e nevojshme të riformulohet kjo dispozitë në drejtimin që dorëheqja konstatohet dhe nuk miratohet, si dhe të parashikohen afate brenda të cilave Këshilli ose Kuvendi janë të detyruar ta bëjnë këtë, në mënyrë që të mos ketë shpërdorim me zvarritjen e padrejtë të procesit.

Neni 32 i ligjit parashikon që një anëtar i Këshillit mund të largohet nga ushtrimi i funksionit nëse për të njëjtin është nxjerrë një aktakuzë për një vepër që është bazë për pushimin e mandatit, nëse është konfirmuar me aktgjykim të formës së prerë. Në këtë drejtim, nuk kufizohet se sa mund të zgjasë vendimmarrja, kështu që duke e pasur parasysh kohëzgjatjen e gjatë të procedurave penale, kjo dispozitë mund të çojë në një situatë ku anëtari i Këshillit një pjesë të madhe të mandatit, apo madje edhe gjatë mandatit të plotë të jetë i larguar nga funksioni. Ky mund të jetë një problem i veçantë nëse ka më shumë anëtarë që janë larguar, me ç'rast ekziston rreziku i bllokimit të plotë të punës së Këshillit. Në të njëjtën kohë, dispozita e këtij neni nuk është e harmonizuar terminologjikisht me LPP-në, sepse në përputhje me ndryshimet në Kodin Penal të vitit 2023, veprat penale të nenit 353 nuk ndiqen më me akt, por me propozim, që do të thotë se akuza për shpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit nuk do të mund të konsiderohet si bazë për largimin.

Neni 39 i këtij ligji e rregullon transparencën e seancave të Këshillit, por nuk është mjaft e qartë për sa i përket situatave të sakta kur Këshilli ka të drejtë të përjashtojë publikun nga seancat, gjë që lë hapësirë për zbatim të jo të barabartë dhe abuzim të dispozitës për reduktimin e transparencës së veprimit të Këshillit.

Në dispozitat e nenit 62 në lidhje me kërkesën për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit, është e nevojshme të përcaktohet se kush mund të paraqesë një kërkesë të tillë, duke qenë se dispozita nuk është specifikuar në këtë drejtim. Gjithashtu parashikohet që me kërkesën parashtruesi duhet të paraqesë adresën dhe vendbanimin e gjyqtarit, të cilat të dhëna për palët në procedurat është vështirë për t'u marrë.

Në nenin 63 të ligjit rregullohet krijimi i Komisionit të Relatorëve, i cili krijohet nga Këshilli pas marrjes së kërkesës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës. Paragrafi (1) i këtij neni përcakton se me marrjen e kërkesës në fjalë, Këshilli i anëtarëve me të drejtë vote me short do të krijojë Komisionin e Relatorëve i përbërë nga tre anëtarë, dy prej të cilëve do të jenë nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga gjyqtarët, ndërsa njëri nga radhët e anëtarëve i zgjedhur nga Kuvendi, me ç'rast Kryetari i Komisionit do të zgjidhet me short nga radhët e anëtarëve të Komisionit. Në këtë dispozitë nuk është e qartë se për cilët anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi bëhet fjalë. Përveç kësaj, dispozitat e paragrafit (3) të këtij neni përcaktojnë se kur Këshilli përcakton përgjegjësinë e gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës që i përket komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Komisionin nga paragrafi (1) të këtij neni, një anëtar doemos duhet të jetë pjesëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë. Në këtë dispozitë, është e paqartë se si zgjidhet anëtari që është pjesëtar i komuniteteve pakicë. Prandaj, është e nevojshme të riprecizohen dispozitat e theksuara.

Nga pikëpamja e teknikës ligjore legjislative koherente, termi “adresa e shtëpisë” përsëri haset në dispozitat e nenit 65 të ligjit. Është e nevojshme harmonizimi i termave me dispozitat e nenit 62, ku përdoret termi adresa e shtëpisë dhe vendbanimi.

Me nenin 73 paragrafi (7) në lidhje me përsëritjen e procedurës për përgjegjësinë e gjyqtarit për shkak të aktgjykimit të GJEDNJ-së, ligjvënësi ka parashikuar nëse kërkesa për përsëritjen e procedurës nuk është e plotë, nuk është parashtruar në kohën e duhur ose nuk është e lejuar, Komisioni do t'i propozojë

Këshillit ta hedhë poshtë. Kjo dispozitë është e pazbatueshme, pasi nuk janë parashikuar kushtet në të cilat kërkesa konsiderohet e plotë/jo e plotë ose (jo) e lejuar.

Në nenin 78 të ligjit parashikohet se Këshilli e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit i cili i përmban të dhënat dhe informacionet për punën e gjyqtarit dhe punën e kryetarit të gjykatës, në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, në të cilin inkorporohen të dhënat për punën e tyre dhe i cili azhurnohet një herë në muaj. Në këtë rast, mungon dispozita që do të specifikojë se kush e plotëson formularin. Në të njëjtën kohë, udhëzimi për mënyrën e plotësimit të formularit, i cili konform këtij ligji duhet të hartohet nga Këshilli, nuk është i aksesshëm si akt i posaçëm. Rrjedhimisht, rezulton se dispozitat e lartpërmendura lënë hapësirë për vendimmarrje diskrecionale, interpretim subjektiv dhe zbatim të ndryshëm.

Dispozitat e nenit 88 parashikojnë se nëse një ish-gjyqtar i një gjykate ndërkombëtare konkurren për gjyqtar, kandidati për gjyqtar merr notë pozitive, kështu që kjo dispozitë nuk e merr parasysh mënyrën e përfundimit të mandatit të gjyqtarit në gjykatën ndërkombëtare, përkatësisht ligji i barazon kandidatët edhe me gjyqtarët që janë shkarkuar nga detyra e tyre në gjykatën ndërkombëtare.

Neni 96 i ligjit e rregullon miratimin e vendimit për vlerësimin e punës së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës. Në paragrafin (5) të këtij neni parashikohet se kundër vendimit për refuzimin ose pranimin e kundërshtimit ose vendimit për rivlerësim, gjyqtari ose kryetari i gjykatës ka të drejtë të ankohet brenda tetë ditëve nga data e marrjes së vendimit pranë Këshillit të Ankesave në mënyrën dhe procedurën e rregulluar me këtë ligj. Në dispozitën e lartpërmendur, është e paqartë se cilit Këshill të Ankesave i referohet dispozita kur bëhet fjalë për ankimin e notës së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës.

Neni 98 i ligjit përcakton se Këshilli nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 15 vjet përvojë gjyqësore, sipas notës paraprakisht të përcaktuar të rezultateve të tyre të përgjithshme të punës dhe kontributit në zhvillimin e mendimit profesional dhe teorik dhe sistemit juridik, i propozon Kuvendit dy kandidatë për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Duke vepruar kështu, ligjvënësi përdor një formulim shumë të përgjithshëm, dhe njëherësh nuk janë dhënë parametra ose kriterë objektive përmes të cilave do të vlerësohet përmbushja e kontributit në fjalë, gjë që lë hapësirë për interpretime subjektive dhe shpërdorime, ndërkaq kjo në vetvete është një rrezik i mundshëm për korrupsion.

Neni 99 i ligjit e rregullon miratimin e vendimit për heqjen e imunitetit të gjyqtarit dhe vendimarrjen sipas kërkesës për paraburgim të gjyqtarit, duke përdorur terminologji të paqartë, gjë që e bën të pamundur të shihet se cili është ndryshimi midis heqjes së imunitetit dhe vendimarrjes sipas kërkesës për paraburgim. Gjithashtu nuk është plotësisht e qartë se çfarë do të thotë miratimi i paraburgimit, në aspektin e kompetencave të Këshillit Gjyqësor.

2.3. Rreziqe për shkak të afateve të papërcaktuara

Neni 13 i këtij ligji e rregullon krijimin dhe punën e Komisionit për përgatitjen e listave të kandidatëve, ku rreziqet kryesore të korrupsionit lidhen me mungesën e afateve të përcaktuara për veprimin e Komisionit dhe Këshillit. Kështu, dispozitat në fjalë nuk përmbajnë afate brenda të cilave duhet të formohet Komisioni, nuk janë përcaktuar afate brenda të cilave Komisioni është i detyruar të përgatisë listat e kandidatëve dhe t'i publikojë ato në faqen e internetit, madje nuk janë parashikuar as afatet brenda të cilave Këshilli është i detyruar të vendosë për kundërshtimet e listave të kandidatëve. Gjithashtu, në paragrafin (1) parashikohet që Këshilli nga radhët e tij të formojë një Komision, i cili i përcakton listat e kandidatëve, ndërsa në paragrafin (5) se në seancë Këshilli vendos për kundërshtimet e listave të kandidatëve, kështu që krijohet një situatë kur anëtarët e Këshillit që vendosën për listat e

kandidatëve tani vendosin edhe për kundërshtimet, gjë që është në kolizion me parimin e dyshkallësisë dhe me rregullat e procedurës së drejtë.

Neni 23, i cili i referohet procesverbalit të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve, përcakton se pas mbylljes së vendvotimit, Këshilli Zgjedhor është i detyruar më së voni deri në ora 18:00 të përpilojë procesverbalin e rrjedhës dhe rezultatit të votimit dhe ta njoftojë Komisionin Zgjedhor. Nga ana tjetër, Këshilli është i detyruar ta paraqesë procesverbalin brenda 24 orëve. Në këtë drejtim, nuk është e qartë nëse këto 24 orë fillojnë të rrjedhin nga përfundimi i zgjedhjeve në orën 15:00, apo nga përpilimi i procesverbalit për rrjedhën dhe rezultatin e votimit në orën 18:00.

Neni 46 i këtij ligji, i cili i referohet shpalljes së zgjedhjes së gjyqtarit, duhet të përmbajë afate të përcaktuara saktësisht, pasi i njëjti parashikon që zgjedhja e gjyqtarit të shpallet menjëherë pas vakancës së funksionit të gjyqtarit. Shprehja e përdorur në këtë mënyrë është e përgjithshme dhe mund të jetë objekt i interpretimit subjektiv. Kështu që, ekziston rreziku i taktizimit duke shpallur vende vakante, në mënyrë që të pritët që një kandidat potencial t'i përmbushë kushtet. Me këtë veprim, duke e marrë parasysh paragrafin (6) të këtij neni, ekziston rreziku që vendet vakante thuaja se kurrë të mos shpallen si vende vakante që do të linin mundësi për lëvizjen horizontale të gjyqtarëve brenda shërbimit. Njëherësh, është e nevojshme të përcaktohet se çfarë do të thotë saktësisht vendi “vakant” i gjyqtarit, sepse nëse e marrim parasysh që vendet e gjyqtarëve nuk plotësohen në përputhje me sistematizimin dhe ka mungesë kronike të gjyqtarëve, është e paqartë nëse kjo do të thotë që vendet vakante duhet të shpallen vazhdimisht, derisa numri i gjyqtarëve të plotësohet në përputhje me aktet e sistematizimit.

Neni 58 e rregullon pushimin e funksionit të gjyqtarit për shkak të veprës së kryer penale, ku thuhet se gjykata pa prolongim do t'i paraqesë Këshillit një kopje të aktgjyqimit. Në këtë dispozitë është e nevojshme të parashikohet një afat kohor brenda të cilit gjykata është e detyruar ta paraqesë aktgjykimin në Këshill, si dhe të precizohet se a bëhet fjalë për aktgjykim të shkallës së parë apo për aktgjykim të formës së prerë.

Në nenin 66 të ligjit rregullohet procedura e shqyrtimit të kërkesës për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës, para Komisionit të Relatorëve, ku parashikohen afate për veprimin e Komisionit, i cili e ka për detyrë brenda 7 ditëve nga dita e marrjes së përgjigjes nga gjyqtari të caktojë seancës. Por ligji nuk e rregullon situatën se si do të veprohet nëse nuk paraqitet përgjigje ndaj kërkesës.

Neni 73 parashikon se procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës mund të përsëritet nëse me vendimin e GJEDNJ-së është konstatuar shkelja e një të drejte të njeriut ose lirie themelore, nëse gjyqtari ose kryetari i gjykatës, të cilit i është shkelur e drejta brenda 30 ditëve, por jo më vonë se tre vjet nga vendimi përfundimtar i GJEDNJ-së, të paraqesë kërkesë në Këshill për përsëritjen në procedurë. Për rrjedhojë, ky paragraf ka afate të paqarta për sa i përket asaj se kur konsiderohet se fillon të rrjedhë afati subjektiv prej 30 ditësh, gjë që është veçanërisht problematike nëse merret parasysh diferenca e madhe midis afatit subjektiv dhe atij objektiv.

Në nenin 85 të ligjit përcaktohet se Këshilli çdo vit, me vendim, e përcakton numrin e përafërt të lëndëve që duhet të zgjidhen nga gjyqtari brenda një muaji. Megjithatë, në Ligj nuk ka afate për miratimin e normës së përafërt, kështu që në praktikë nuk është e pazakontë që ajo të miratohet gjatë vitit dhe të zbatohet në mënyrë retroaktive, gjë që paraqet një rrezik të veçantë të korrupsionit.

2.4. Rreziqe për shkak të mungesës së garancive procedurale dhe mekanizmave mbrojtës

Rreziqet që i përmban neni 14 i këtij ligji, i cili e rregullon Komisionin për zbatimin e zgjedhjeve të anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjyqtarëve, lidhen me nenin 6 të Rregullores së Punës së Këshillit Gjyqësor, ku paragrafi 3 përcakton se Komisioni përpilon një plan financiar për mjetet e nevojshme për zbatimin e zgjedhjeve dhe ia dorëzon atë Kryetarit të Këshillit. Gjithashtu, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 6 të Rregullores së Punës, Komisioni Zgjedhor i paraqet Këshillit një raport financiar të detajuar brenda pesë ditëve pas përfundimit të zgjedhjes së anëtarit të Këshillit. Megjithatë, askund në Ligj ose Rregulloren e Punës nuk parashikohet se kush e miraton atë, kush e realizon atë dhe kush e zbaton mbikëqyrjen mbi implementimin e planit financiar. Është gjithashtu e paqartë se cilat pasoja i bart Komisioni nëse nuk përpilon një plan ose raport të tillë, madje nuk ka as dispozita nëse dhe çfarë kompetencash ka Këshilli në lidhje me raportin e tillë.

Dispozitat e nenit 25 të këtij ligji përcaktojnë se anëtar i zgjedhur i Këshillit konsiderohet kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave sipas njësive zgjedhore. Megjithatë, nuk ka mekanizma garancie, kështu që rekomandohet të inkorporohet një prag minimal i daljes ose i numrit të votave që duhet të fitohen për t'u zgjedhur kandidati, në mënyrë që të shmanget një situatë ku zgjidhen anëtarë me një numër të vogël votash, hipotetikusht madje vetëm me votën e tij.

Nenet 26 dhe 27 e parashikojnë mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes dhe të zgjidhet kandidati, në mënyrë përkatëse, kështu që ata të mund të paraqesin kundërshtim brenda pesë orëve pas përfundimit të votimit në Komisionin Zgjedhor për rrjedhën e votimit për anëtar të Këshillit. Megjithatë, këto dispozita nuk janë mjaft të qarta në kuptimin nëse një kundërshtim mund të paraqitet edhe para se të përfundojë votimi. Prandaj, rekomandohet që në dispozitën të theksohet se ata mund të paraqesin kundërshtim më së voni në afat prej një numri të caktuar orësh.

Neni 28 i ligjit parashikon se në të njëjtën seancë të Kuvendit, bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit me propozim të trupit punues kompetent të Kuvendit nga radhët e kandidatëve që janë paraqitur në shpalljen dhe me propozim të Presidentit të vendit. Megjithatë, një dispozitë e tillë është kufizuese dhe nuk e pasqyron në mënyrë adekuate situatën nëse ka një pushim të parakohshëm të mandatit të ndonjërit prej anëtarëve, prandaj është e nevojshme të riprecizohet dispozita.

Në nenin 34 të këtij ligji parashikohen bazat për paraqitjen e kërkesës për procedurë disiplinore ndaj anëtarit të Këshillit, ku thuhet se të njëjtën gjë mund ta bëjë çdo anëtar i Këshillit, ose të paktën 20 gjyqtarë, që është një numër jashtëzakonisht i lartë gjyqtarësh, veçanërisht nëse e kemi parasysh se anëtar i Këshillit mund të zgjidhet me një numër shumë më të ulët votash. Ekzistojnë gjithashtu baza të papërcaktuara sa duhet për përgjegjësinë e anëtarit të Këshillit, të cilat janë përcaktuar në mënyrë mjaft restriktive. Nga ana tjetër, për sa i përket refuzimit të paraqitjes së deklaratës për gjendjen pasurë, ose paraqitjes së një deklarate të pavërtetë si bazë për paraqitjen e kërkesës për procedurë disiplinore për anëtarin e Këshillit, është problematike, sepse ekziston një procedurë jo e rregulluar sa duhet, e cila paraqet rrezik për korrupsion. Me fjalë të tjera, nëse KSHPK-ja e njofton Kryetarin e Këshillit se një anëtar i caktuar i Këshillit nuk ka paraqitur deklaratë për gjendjen pasurore dhe interesat në përputhje me ligjin ose se të dhënat e përfshira në deklaratë janë kryesisht të pavërteta, Kryetari i Këshillit mund të mos veprojë ose të veprojë me vonesë sepse nuk janë parashikuar afate për veprim, ose nuk është parashikuar detyra e ndonjë prej anëtarëve të iniciojë procedurë. Sa i përket paragrafit (2) të këtij neni, njëlloj si edhe tek nenet 74, 76 dhe 77 të LGJ, përmban dy terma që janë të paqarta për sa i përket qëllimit të ligjvënës, nëse merren parasysh kuptimet e termave që janë definuar vetëm në aspektin teorik por jo edhe në aspektin juridik.

Në nenin 35 të ligjit që e rregullon procedurën e vendimmarrjes për ngritjen e procedurës disiplinore, në paragrafin (1) rregullohet dërgesa deri te anëtar i prekur i Këshillit, kështu që nuk përcaktohet

saktësisht nëse e njëjta bëhet në adresën e vendbanimit ose vendqëndrimit të paraqitur, ndërkaq përmban një term të paqartë “adresa e shtëpisë”. Është e paqartë sipas cilave rregulla zhvillohet procedura dhe cilat janë garancitë procedurale që i gëzon anëtari i Këshillit kundër të cilit zhvillohet procedura. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për sa i përket propozimit dhe mbledhjes së provave. Në paragrafin (6) të këtij neni gjithashtu parashikohet se vendimi për shkarkimin e anëtarit të Këshillit duhet të merret me të paktën tetë vota, me ç'rast për shkarkimin duhet të kenë votuar të paktën dy anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi. Vlen të përmendet se në të gjithë tekstin e ligjit, kur flitet për anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi, nuk u referohet të gjithë anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, por bëhet një distinkcion me anëtarët e propozuar nga Presidenti, të cilët në të vërtetë zgjidhen nga Kuvendi. Së këtejmi, nuk është e qartë nëse në këtë rast nënkuptohen dy anëtarë nga të gjithë të zgjedhurit nga Kuvendi, apo ata që propozohen nga Presidenti janë të përjashtuar nga ky numër. Gjithashtu, megjithëse bëhet fjalë për një mekanizëm garancie në mënyrë që gjyqtarët që janë shumicë në Këshill të mos dominojnë në vendimin për shkarkim, megjithatë duhet të kihet parasysh se inkorporimi i një pragu të tillë të dyfishtë mund të jetë rrezik për korrupsion. Njëherësh, në dispozitën e theksuara mungon afati përfundimtar brenda të cilit duhet të përfundojë kjo procedurë.

Në nenin 47 të ligjit përcaktohet se Këshilli e zgjedh gjyqtarin e gjykatës themelore nga lista e kandidatëve e paraqitur nga AGJPP-ja që kanë aplikuar në shpalljen, duke e marrë parasysh vitin e përfundimit të trajnimit dhe suksesin e arritur, si dhe rezultatet e intervistës së zhvilluar nga Këshilli. Në këtë drejtim, nuk është e qartë se cili kriter është më i rëndësishëm - viti i përfundimit apo suksesi? Dispozita përcakton se Këshilli zhvillon intervistë me kandidatët duke i vlerësuar kompetencat e tyre personale dhe sociale, me ç'rast për intervistën kandidatët mund të marrin maksimumi 10% të pikëve totale. Ky është një rrezik jashtëzakonisht i lartë për korrupsion sepse nuk ka kritere të qarta vlerësimi/notimi, ndërkaq kjo sjell një numër mjaft të lartë pikësh që mund ta bëjë diferencën në përzgjedhjen përfundimtare.

Dispozitat e nenit 49 i referohen vendimit për zgjedhjen e gjyqtarit, ku është e paqartë se kur fillon mandati i gjyqtarit, përkatësisht prej kur konsiderohet se është zgjedhur. Gjithashtu, në këtë nen parashikohet se kandidati që nuk është zgjedhur ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Supreme. Kjo dispozitë është mjaft e paqartë, pasi Këshilli për Ankesa i Gjykatës Supreme është përcaktuar në nenin 72 të këtij ligji dhe aty nuk përmendet fare kjo kompetencë e këtij Këshilli, që e sjell këtë nen në kolizion me nenin 72. Gjithashtu nuk ka dispozita të tjera që e rregullojnë këtë të drejtë ankimi apo punën e Këshillit. Së këtejmi, nuk është e qartë nëse bëhet fjalë për Këshillin e njëjtë. Në mënyrë plotësuese, neni 68 i Rregullores së Punës së Gjykatës Supreme flet vetëm për Këshillin për Ankesa kundër vendimeve për shkarkim ose procedurave disiplinore, por jo edhe për Këshillin sipas Ankesave i cili përmendet këtu.

Dispozitat e neneve 50 dhe 53 të këtij ligji, përfshijnë mekanizma garancie për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve etnike pakicë, sipas të cilave për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatat ku ka një pakicë më të madhe, duhet të ketë shumicë nga numri i anëtarëve që i përkasin komuniteteve pakicë. Kjo dispozitë në praktikë mund të përbëjë rrezik të lartë për korrupsion, pasi mund të bëhet objekt i abuzimeve. Me fjalë të tjera, ekziston rreziku që kandidatët që ishin në krye të listës dhe janë zgjedhur nga shumica e anëtarëve të Këshillit të mos e marrin shumicën e votave të komuniteteve pakicë dhe në këtë mënyrë të anashkalohet rankimi i përcaktuar. Ky është një rrezik veçanërisht i lartë korrupsion duke e pasur parasysh mungesën e justifikimeve racionale të votave dhe vendimeve të Këshillit.

Nenet 53 dhe 54 nuk përmbajnë dispozita në lidhje me shkarkimin e gjyqtarit porotë, kështu që është e paqartë nëse gjyqtari porotë ka ndonjë të drejtë në procedurën e shkarkimit.

Neni 55 i këtij ligji e rregullon pushimin e funksionit të gjyqtarit me kërkesë të tij, por nuk ka procedura të mjaftueshme të përcaktuara me afate precize, që mund të jetë rrezik për korrupsion, veçanërisht nëse për kërkesën e gjyqtarit nuk merret vendim në mënyrë që të ndikohet tek gjyqtari të veprojë në një drejtim të caktuar.

Në nenin 64 në lidhje me sigurimin e të dhënave dhe provave që janë me interes për përcaktimin e situatës në lidhje me kërkesën për përcaktimin e përgjegjësisë nga Komisioni i Relatorëve, nuk ka kriteret të qarta se kur provat duhet të paraqiten nga pala, dhe kur Komisioni i siguron sipas detyrës dhe nëse i njëjti mund të refuzojë të sigurojë prova të caktuara. Është gjithashtu e paqartë se çka nëse afati brenda të cilit duhet të paraqiten të dhënat është i paarsyeshëm, ose është tejkaluar. Për më tepër, është e paqartë se çka nëse për shkak të një vonese të tillë cenohen dispozitat e afateve të procedurave të përfshira në Rregulloren e Punës të Këshillit Gjyqësor. Në këtë kuptim, ekziston një konflikt i jashtëm i dispozitave me LPP dhe L Prok Pub.

Neni 72 i këtij ligji e rregullon të drejtën e ankimit ndaj vendimit për masën disiplinore, kështu që rreziqet kryesore në këtë pjesë kanë të bëjnë me dispozitat e papërcaktuara plotësisht. Lidhur me paragrafin (3) të këtij neni, nuk është e qartë nëse Këshilli për Ankesa vendos vetëm për procedurën dhe nëse po, atëherë pse i njëjti nuk mund ta bëjë vlerësimin e vendimit material. Kjo ngre pyetje në lidhje me efikasitetin e procedurës, por edhe me ekzistencën e mjetit efektiv juridik dhe mbrojtjes efektive gjyqësore. Në paragrafin (5) të këtij neni theksohet se Këshilli detyrimisht i respekton udhëzimet e Këshillit për Ankesa nëse konstatohet shkelje e procedurës, por nuk është e qartë se cilat janë garancitë që Këshilli do ta respektojë këtë dispozitë.

Në dispozitën e nenit 103 të ligjit që e rregullon Qendrën e TIK-ut pranë Këshillit, në paragrafin (2) nuk parashikohen rregulla për bazën e replikuar. Njëherësh, në tekstin e ligjit nuk përmendet askund se Këshilli mund ta përdorë këtë bazë për realizimin e detyrave të punës, duke lejuar që ajo bazë të përdoret nga Këshilli pa përcaktuar saktësisht për çfarë dhe në cilat procedura mund të përdoret, paraqet rrezik për korrupsion, pasi që baza përmban të dhëna nga sistemi i informacionit gjyqësor, përkatësisht nga lëndët konkrete. Replikimi i bazës bëhet për shkak të sigurisë, kështu që përdorimi i kësaj baze mund të shkaktojë dëme ose humbjen e të dhënave që është në kundërshtim me qëllimin për të cilin është bërë replikimi.

3. Analiza e dispozitave të Ligjit për Prokurorinë Publike dhe një pjese të akteve nënligjore dhe të përgjithshme që rezultojnë nga Ligji për Prokurorinë Publike

Titulli: Ligji për Prokurorinë Publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 42/2020).

Shqyrtimi i kërkesës: Me LProk.Pub. rregullohet themelimi, kompetenca, organizimi, funksionimi dhe suprimimi i Prokurorisë Publike, bazat dhe procedura e emërimit dhe shkarkimit të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, bazat e pushimit të funksionit Prokuror Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, bazat e zgjedhjes, shkarkimit dhe procedurës disiplinore të prokurorëve publikë, bazat e pushimit të funksionit prokuror publik, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me punën e Prokurorisë Publike, duke i përfshirë edhe të drejtat dhe detyrimet e prokurorëve publikë dhe mënyrën e evaluimit dhe vlerësimit të punës së tyre. Prokuroria Publike si autoritet i vetëm dhe i pavarur shtetëror që i ndjek kryerësit e veprave penale dhe veprave të tjera të dënueshme të përcaktuara me ligj, kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj, është autoriteti kryesor në luftën kundër krimit kurse qëllimi kryesor dhe parësor i saj është realizimi i suksesshëm i drejtësisë penale duke e mbrojtur interesin publik dhe të drejtat dhe liritë e qytetarëve.

Materialet e shqyrtuara/ konsultuara:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. LPKKI ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr.12/2019
1. L Prok. Pub. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/2020)
2. Rregullorja për Vlerësimin e Punës së Prokurorëve Publikë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 314/2020)
3. Rregullorja për plotësimin e Rregullores për Vlerësimin e Punës së Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.188/2024)
4. Rregullorja për Përcaktimin e Mënyrës së Mbikëqyrjes mbi Punën dhe Veprimin e Prokurorëve Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.6/2021)
5. Rregullorja për Formën dhe Përmbajtjen e Formularit dhe Procedurës për Lëshimin dhe Heqjen e Legjitimacionit të Prokurorëve Publikë dhe Anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.6/2021)
6. Rregullorja për Formën dhe Përmbajtjen e Formularit dhe Procedurës për Lëshimin dhe Heqjen e Legjitimacionit të Prokurorëve Publikë dhe Anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.114/2021)
7. Rregullorja për Mënyrën e Zbatimit të Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Prokurorit Publik për Shkelje të Kryer Disiplinore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.114/2021)
8. Rregullorja për Informacione të Klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.190/2021)
9. Rregullorja për Punën e Brendshme të Prokurorëve Publikë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 190/2021)
10. Rregullorja për Mënyrën e Ndarjes së Bursës për Prokurorët Publikë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 217/2021)
11. Rregullorja për Propozimin, Shkëmbimin dhe Referimin/Transferimin e Prokurorit Publik në Institucione, Agjenci, Autoritete ose Zyra të Bashkimit Evropian ose në Organizata, Institucione, Autoritete, Misione ose Projekte të Tjera Ndërkombëtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 217/2021).
12. Rregullorja për Pamjen dhe Mënyrën e Veshjes së Togës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.250/2021)
13. Rregullorja për Mënyrën e Shpërndarjes së Lëndëve në Prokuroritë Publike Përmes Sistemit për Shpërndarje Elektronike të Lëndëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.31/2022)
14. Rregullorja për Pranimin dhe Pasjen në Dispozicion të Dhuratave dhe Evidencën e Dhuratave të Pranuar të Prokurorëve Publikë në Ngjarjet Protokollare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.189/2023)
15. Rregullorja për Propozimin dhe Transferimin e Prokurorit Publik për Ndërlidhje të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Eurojustice ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.188/2024)
16. Kodi i Etikës për Prokurorët Publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.114/2021)
17. Kodi Penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014, 196/2015, 226/2015, 97/2017 dhe

- 248/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 36/2023 dhe 188/2023)
18. Ligji për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Materien Penale (*) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.77/2021)
19. LPP ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2010, 100/2012, 142/2016 dhe 198/2018)

KONKLUZION

Pas analizës së LProk. Pub., akteve nënligjore dhe akteve të përgjithshme që rezultojnë prej tij, u identifikuan mangësi që mund të prodhojnë rreziqe për korrupsion. Mangësitë mund të kategorizohen në kategoritë si vijon:

- 3.1. Rreziqe në lidhje me rregullimin më të detajuar të procedurave të caktuara që ndërlihen me përdorimin e autorizimeve diskrecionale
- 3.2. Rreziqe nga aspekti i procedurave të rregulluara në mënyrë të pamjaftueshme ose procedurave jo në rregull
- 3.3. Rreziqe në lidhje me përdorimin e termave pamjaftueshëm të qartë dhe pamjaftueshëm të përcaktuar
- 3.4. Rreziqe në lidhje me mënyrën e përcaktimit të afateve
- 3.5. Rreziqe duke përcaktuar kritere precize dhe objektive për situata të caktuara
- 3.6. Rreziqe për shkak të ekzistencës së konfliktit të jashtëm me ligjet e tjera

Vërejtjet fillestare të L Prokur. Pub. janë identifikuar në nenin 1, ku nuk përfshihen në mënyrë taksative të gjitha çështjet që i rregullon ky ligj, veçanërisht çështjen e të drejtave dhe detyrimeve të prokurorëve publikë, si dhe procedurën dhe kriteret për vlerësimin/notimin e punës së prokurorëve. Kjo lë hapësirë që këto çështje të rregullohen me ligje dhe akte nënligjore të tjera, me ç'rast mund të ndikohet drejtpërdrejt mbi pavarësinë e prokurorëve publikë ndërkaq ky është një faktor rreziku fillestar dhe themelor për korrupsion.

Duke e marrë parasysh organikën hierarkike të Prokurorisë Publike, iu kushtua vëmendje e veçantë dispozitave që ofrojnë një mundësi për të anashkaluar kompetencën lëndore dhe territoriale të Prokurorisë Publike, si dhe dispozitave që krijojnë një mundësi ligjore dhe mekanizma për sugjerime në punën e prokurorëve publikë. Së këtejmi, fillimisht si problematike imponohet ekzistenca e subordinimit si parim i punës në Prokurori, e rregulluar në nenin 3 të ligjit. Lidhur me këtë nen, ekziston një konflikt i brendshëm i paragrafit (1) dhe angazhimi për parimin e subordinimit me paragrafin (3) dhe pavarësia dhe autonomia e prokurorëve publikë. Atëherë, subordinimi si parim i hierarkisë së shprehur kundër së cilës nuk lejohen mjete juridike që e implikon varësinë e prokurorëve publikë nga opinionet dhe rekomandimet e shkallëve më të larta hierarkike, është në kundërshtim me pavarësinë e prokurorëve publikë, veçanërisht në një situatë kur prokurorëve publikë që nuk pajtohen me opinionin dhe rekomandimet e eprorëve hierarkik nuk janë parashikuar mekanizma ligjorë për përjashtimin nga veprimi.

Vëmendje e veçantë u është kushtuar edhe kriterëve dhe procedurës së notimit të performancës së prokurorëve publikë, në kuadër të cilave dispozita ligjore u identifikuan paqartësitë më të mëdha dhe nevoja për sqarime shtesë sa i përket përdorimit të termave dhe procedurave.

3.1. Rreziqe në lidhje me rregullimin më të detajuar të procedurave të caktuara që ndërlihen me përdorimin e autorizimeve diskrecionale

Neni 14 i këtij ligji lë hapësirë për vendim diskrecional të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pjesën e dhënies së pëlqimit për orarin e prokurorëve në seksionin e specializuar të policisë të PTHP NKOK. Në këtë kontekst, problematike është kërkesa për pëlqim e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për sistematizimin e prokurorëve në këtë seksion. Në kushtet kur prokurorët për punën e tyre kryesisht përgjigjen para shefit të PTHP NKOK, i cili është përgjegjës për vlerësimin/notimin e punës së tyre edhe në kushtet kur ligjvënësi ka parashikuar autonomi më të madhe të kësaj prokurorie publike, nuk është e qartë intenca për të marrë pëlqim nga Prokurori Publik Shtetëror për sistematizimin e prokurorëve në këtë seksion. Nëse merret parasysh se nuk janë përcaktuar kritere shtesë kur Prokurori Shtetëror mund të refuzojë ta japë pëlqimin dhe si do të vepronet nëse Prokurori Shtetëror nuk e jep pëlqimin, është e qartë se kjo dispozitë përmban autorizime të larta diskrecionale që bartin rrezikun e zbatimit të pabarabartë të ligjeve dhe trajtimit subjektiv, pa përcaktimin e mekanizmave parandalues.

Neni 23 paragrafi (5) i Ligjit përcakton që Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të prokurorit publik të Prokurorisë Publike, mund të autorizojë një prokuror publik në një Prokurori tjetër publike për të ndërmarrë veprime të caktuara me qëllim të kryerjes më të shpejtë dhe më efikase të veprimeve. Ky autorizim është i vendosur gjerësisht dhe në thelb është autorizim diskrecional, përmes të cilit në mënyrë legale mund të anashkalohen dispozitat për kompetencën lëndore dhe territoriale të Prokurorisë Publike. Prandaj, kjo çështje është me rrezik të lartë dhe duhet të përcaktohen garanci dhe rregulla shtesë për një veprim të tillë, si dhe e drejta për mjete juridike kundër vendimeve të prokurorit në një kolegji eventualisht të zgjeruar të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose në KPP dhe ngjashëm.

Në përputhje me dispozitat e nenit 26, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka autorizim diskrecional për transferimin e përkohshëm të prokurorëve publikë nga një Prokurori Publike në tjetrën. Për transferimin e përkohshëm të prokurorit publik, nuk parashikohen mekanizma parandalues në drejtim të parandalimit të konflikti të kësaj dispozite me kompetencë të Këshillit për të zgjedhur prokurorë publikë në Prokurori të caktuara publike, nuk ka kritere sipas të cilave vendoset për transferimin e përkohshëm dhe ekziston rreziku që kjo dispozitë të përdoret si një formë e mobingut ndaj prokurorëve të caktuar. Përveç kësaj, kjo dispozitë nuk garanton që prokurori publik do të transferohet në një Prokurori Publike të së njëjtës shkallë, kështu që ekziston rreziku i transferimit të prokurorit të lartë publik në një Prokurori Themelore Publike, pa pasur kritere dhe garanci shtesë (për shembull: pëlqim nga prokurori i lartë publik, etj.).

Me nenin 29 i është dhënë e drejta diskrecionale Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut të ndërmarrë ndjekje penale dhe ushtrimin e punëve të caktuara për të cilat është kompetent prokurori i lartë publik ose prokurori themelor publik apo t'i autorizojë të zhvillojnë procedurë për lëndë të caktuara ose të kryejnë punë të caktuara në kompetencë të një prokurori tjetër publik. Në këtë nen mungojnë mekanizma parandalues, përkatësisht nuk janë parashikuar kritere dhe procedura të veçanta për realizimin e këtij dispozicioni të Prokurorit Publik Shtetëror. Në paragrafin (3) të këtij neni, kontestuese është situata çka nëse mbikëqyrja konstaton se afatet janë përmbushur, ndërsa mbikëqyrja dëshmon se është vepruar në mënyrë joprofesionale kurse edhe shefi i PTHP NKOKP ka qenë në dijeni për këtë dhe ka qenë pjesë e veprimit të tillë. Sipas kësaj, nevojiten mekanizma shtesë parandalues për të mundësuar që lënda të merret dhe të vazhdojë para një prokurori tjetër publik në situata të kështilla. Prokurorët e lartë publikë, nga aspekti hierarkik, kanë kompetenca tjera dhe nuk kanë përgjegjësi të përgjithshme si Prokuror Publik Shtetëror për efikasitetin e hetimeve dhe procedurave të ndjekjes penale. Mundësia për të ndërmarrë ndjekje sipas paragrafit (4) të këtij neni dhe me këtë edhe veprime në shkallë të parë ose të rishpërndajnë lëndë pa procedurë (ndërkaq këtu nuk ka mekanizëm parandalues të llojit nëse ndaj prokurorit publik i cili e ndërmerr ndjekjen është hapur procedurë disiplinore, etj.),

është rrezik i lartë për korrupsion sepse e anashkalon kompetencën e caktuar me ligj dhe ndikon drejtpërdrejt në epilogun e procedurës. Me paragrafin (5) të të njëjtit nen nuk është përfshirë parimi i efektivitetit, kur për arsye të kontinuitetit dhe efikasitetit të veprimit, do të duhet t'i caktohet një lëndë prokurorit të njëjtë i cili ka vepruar ndaj lëndës. Sipas ligjit, kjo është e mundur vetëm sipas nenit 23 paragrafi (5), me kërkesë të shefit të Prokurorisë Publike. Nëse shefi nuk paraqet kërkesë të tillë, Prokurori Publik Shtetëror nuk ka mekanizma për të parandaluar joefikasitetin dhe zvarritjen e procedurave, kështu që kjo pamundësi bart rreziqe të veçanta të korrupsionit. Përveç kësaj, nuk parashikohet se në cilën procedurë do të konstatohet puna joprofesionale dhe e pandërgjegjshme e prokurorit publik, përkatësisht a është në procedurën e mbikëqyrjes apo jo, kështu që është kontestuese se kush dhe kur do ta konstatojë këtë, si dhe nëse dhe cilat mekanizma parandalues do të ishin të zbatueshëm – e drejta e mjetit juridik dhe ngjashëm.

Në nenin 33 të Ligjit, dispozita e paragrafit (5) parashikon autorizim diskrecional për prokurorin publik në drejtim të pëlqimit për zhvillimin e procedurës disiplinore ndërkaq pëlqimi i kërkuar në këtë paragraf përbën rrezik për korrupsion, veçanërisht pasi nuk ka kriteret kur prokurori publik duhet ose mund të japë pëlqim, dhe kur ai duhet ose mund të refuzojë zhvillimin e procedurës disiplinore. Për më tepër, procedurat disiplinore nuk e përjashtojnë përgjegjësinë penale kurse një person mund të jetë përgjegjës si në aspektin disiplinor ashtu edhe në atë penal për të njëjtën ngjarje, sepse përgjegjësia penale vetvetiu nuk ka implikime në ç'do rast mbi marrëdhënien e punës së kryerësve.

Në përputhje me nenin 34 Prokuroria Publike kujdeset për ligjshmërinë e masave dhe veprimeve të ndërmarra në procedurën parahetimore dhe bën mbikëqyrje mbi respektimin e të drejtave të njeriut nga personat e autorizuar zyrtarë të nenit 33 paragrafi (2) të këtij ligji. Në mungesë të dispozitave precize në lidhje me kohën, mënyrën dhe vendin e mbikëqyrjes, kjo dispozitë e mundëson kompetencën diskrecionale të prokurorit publik për të kryer mbikëqyrje. Duke e pasur parasysh se nuk ka dispozita precize për mbikëqyrje as në aktet nënligjore, lihet hapësirë që prokurori publik të mundet ta përdorë të drejtën e mbikëqyrjes si një formë presioni dhe ndikimi mbi punën e nëpunësve të caktuar policorë.

Sa u përket dispozitave të procedurës për vlerësimin/notimin e prokurorëve publikë, me dispozitën e nenit 50 është konstatuar se mënyra e pikëzimit dhe shuma e pikëve sipas kriterëve të caktuara në përputhje me nenin 46 paragrafi (1) të këtij ligji do të përcaktohen me Rregulloren e miratuar nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo dispozitë mundëson dispozicionin e gjerë të Prokurorit Publik Shtetëror pa garanci të parashikuara shtesë dhe procedurë të përcaktuar për krijimin e pikëzimit. Krahësuar me mënyrën e vlerësimit/notimit të gjyqtarëve, pikëzimi përcaktohet me LGJ, me ç'rast kufizohet dispozicioni i pikëzimit. Së këtejmi, vlerësohet se e njëjta qasje do të ishte adekuate edhe për vlerësimin/notimin e prokurorëve publikë. Me nenin 56, ligjvënësi e ka rregulluar miratimin e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme me shkrim, që është një dispozicion i gjerë që lë hapësirë për korrupsion, aq më shumë që nuk është përcaktuar procedurë për miratimin e këtyre udhëzimeve (për shembull: sigurimi i të dhënave dhe informacioneve për çështjen e rregulluar me udhëzimin, për shembull praktika e pabarabartë, etj.).

Dispozita e nenit 71 paragrafi (2) të Ligjit përcakton që prokurori publik mund të mbajë mësim në institucionet e arsimit të lartë në fushën prokuroriale dhe të marrë pjesë në projekte shkencore dhe profesionale në atë fushë sipas pëlqimit paraprakisht të dhënë nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas pëlqimit paraprakisht të dhënë nga KPP. Kjo dispozitë e mundëson vendimin diskrecional të Prokurorit Publik Shtetëror për t'i dhënë pëlqimin prokurorit publik për të marrë pjesë në projekte shkencore. Përveç kësaj, mungojnë kriteret se në cilat raste Prokurori Publik Shtetëror mund të refuzojë të japë pëlqimin, në mënyrë që të shmanget zbatimi i pabarabartë i dispozitës.

3.2. Rreziqe nga aspekti i procedurave të rregulluara në mënyrë të pamjaftueshme ose procedurave të parregullta

Në nenin 8 paragrafin (2) është rregulluar çështja e qasjes në informacione për gjendjen me krimin dhe çështje të tjera me rëndësi të përgjithshme të Prokurorisë Publike. Këto çështje nuk janë rregulluar me asnjë ligj tjetër, edhe pse në tekstin e ligjit theksohet se këto informacione duhet të sigurohen në përputhje me ligjin. Duke qenë se ligjet procedurale, përkatësisht LPP e rregullon çështjen e konfidencialitetit të procedurave parahetimore dhe hetimore të lëndëve konkrete, mbetet e paqartë se cilës dispozite ligjore i referohet dispozita në fjalë.

Në nenin 19 të Ligjit nuk ka procedura të përcaktuara sa duhet për disa çështje në lidhje me kompetencën e Kolegjit Profesional. Kështu, nuk është rregulluar se kush e miraton planin dhe metodën e kontrollit të punës së prokurorive publike, të cilat janë elemente përbërëse, etj. Me fjalë të tjera, kjo çështje nuk është rregulluar askund, ndërsa përmendet në ligj, kështu që lë hapësirë për një interpretim të gjerë subjektiv dhe zbatim të ndryshëm. Kolegji rregullohet vetëm me këtë ligj dhe është diskutabile se cilat çështje të tjera do të ishin objekt shqyrtimi përveç atyre të përmendura në paragrafin (2) të këtij neni. Në këtë mënyrë, lihet hapësirë me aktet nënligjore të zgjerohet kompetenca e kolegjit, i cili është një nga mekanizmat për zbatimin e parimit të hierarkisë dhe është me rrezik të lartë sepse lejon inkorporimin e mekanizmit ligjor për të ndikuar mbi vendimet e prokurorëve publikë.

Njëherësh, edhe në paragrafin (2) të këtij neni, me të cilin rregullohet që kolegji zgjedh anëtar të komisionit për përcaktimin e përgjegjësisë, ekziston rreziku rregullator sepse mungojnë dispozita me të cilat rregullohet procedura. Kështu, është e paqartë se kush e bën propozimin për anëtarin e Komisionit për përcaktimin e përgjegjësisë, me cilën shumicë merret vendimi, sa anëtarë të kolegjit duhet të jenë të pranishëm për të shqyrtuar çështjen, kush mund të jetë anëtar i këtij komisioni, etj.

Me nenin 20 rregullohen çështjet të cilat mund të diskutohen në një Kolegj të zgjeruar, por ato janë të vendosura gjerësisht, së këtejmi rezulton se kolegji i zgjeruar mund të mbahet për çdo gjë, duke i përfshirë edhe rastet konkrete, gjë që paraqet rrezik për korrupsion.

Neni 22 rregullon se propozimet, opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet e Kolegjit do të konsiderohen të miratuara, nëse pranohen nga shumica e prokurorëve publikë në atë prokurori publike dhe nga prokurori publik i asaj prokurorie publike. Në këtë dispozitë, ekziston një procedurë e papërcaktuar sa duhet për sa më poshtë: së pari, natyra e opinionëve është e paqartë, përkatësisht nëse ato janë të një natyre të detyrueshme ose jo, gjë që çon në mosrespektimin e tyre, dhe nuk ka as mekanizma parandalues siç është veçimi i opinionit të prokurorëve publikë nëse ata nuk pajtohen me propozimin, në drejtim të respektimit të pavarësisë dhe autonomisë së tyre në përputhje me nenin 3 paragrafin (3) të këtij ligji, si dhe përjashtimin e prokurorëve publikë nga veprimi ndaj lëndëve për të cilat me Kolegjin kanë opinion të ndryshëm.

Neni 24 përcakton se Prokuroria Publike themelohet dhe suprimohet me ligj. Një rrezik i veçantë rregullator është se gjatë sistematizimit të prokurorit publik në rast të suprimimit të prokurorisë publike, ligjvënësi nuk jep garanci kur mund të sistematizohet në një shkallë më të ulët (plotësimi i vendeve në prokurori të shkallës së njëjtë dhe ngjashëm) dhe në cilat raste do të veprohej kështu. Autorizimi diskrecional është i vendosur gjerësisht, pa kritere objektive dhe të matshme që mund të çojnë në abuzime dhe zbatim të pabarabartë në praktikë. Paragrafi (4) i këtij neni përcakton se në rast të suprimimit të prokurorisë publike, urdhrat për angazhimin e hetuesve në atë prokurori pushojnë së qeni të vlefshëm ndërsa hetuesit kthehen në institucionin nga i cili janë transferuar. Kjo dispozitë nuk i përfshin hetuesit e punësuar në atë prokurori publike që suprimohet. Kthimi automatik i hetuesve pa

vlerësimin e nevojës së angazhimit të tyre në qendra të tjera hetimore të hapësirë dhe rrezik për korrupsion, me ç'rast mbetet e hapur çështja se cili prokuror publik do t'i revokojë urdhrat për angazhimin e hetuesve në qendrën hetimore të prokurorisë së suprimuar. Paragrafi (5) i këtij neni përcakton që mjetet financiare, detyrimet e mara, kontratat dhe kërkesat monetare dhe e gjithë pasuria e paluajtshme dhe e luajtshme e prokurorisë publike e cila suprimohet, do t'i kalojnë Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Dispozita në mënyrë përkatëse duhet t'i referohet prokurorisë publike, e cila, në bazë të ligjit, pushon së ekzistuari.

Në dispozitat e nenit 25 të Ligjit nuk janë listuar në mënyrë taksative kompetencat e shefave të prokurorive publike, ndërkaq e njëjta gjë vlen edhe për Rregulloren për Punën e Brendshme të Prokurorive Publike, e cila të hapësirë për interpretim të gjerë dhe abuzime, kurse për shkak të mungesës së bazës ligjore, zvogëlohet edhe hapësira për përcaktimin e përgjegjësisë së tyre. Në këtë kuptim, është e paqartë nëse shefi i Prokurorisë Publike mund të trajtojë lëndë apo jo dhe sipas çfarë kriteresh udhëhiqet kur e merr këtë vendim, si dhe si i shpërndan lëndët në punë nëse vendos të trajtojë lëndë. Për më tepër, neni në fjalë nuk parashikon një afat të saktë brenda të cilit duhet të miratohet orari vjetor i punës. Në kuadër të rreziqeve të konstatuara në dispozitat e theksuara, mungojnë mekanizma shtesë garancie për zgjedhjen e zëvendësve, si për shembull një person që nuk ka qenë i dënuar me masë disiplinore apo një person që ka përvojë minimale në prokurorinë ku zgjidhet si zëvendës, etj. Sa i përket dispozitës nga paragrafi (3) të këtij neni, gjatë përcaktimit të ushtruesit të detyrës, nuk parashikohen kriteret sipas të cilave Këshilli i Prokurorëve Publikë do të udhëhiqet nëse më shumë prokurorë i plotësojnë kushtet, kështu që lihet hapësirë për favorizimin e prokurorëve të caktuar publikë. E njëjta vërejtje ka të bëjë edhe për përcaktimin e ushtruesit të detyrës Prokuror Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, meqë edhe në këtë rast nuk janë parashikuar mekanizma parandalues shtesë siç është vlerësimi pozitiv ose përvoja e caktuar e punës në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, madje nuk janë përcaktuar as kriteret të cilat Këshilli duhet t'i marrë parasysh kur emëron një ushtrues detyre. Në këtë drejtim, nuk është parashikuar afati brenda të cilit KPP merr vendim dhe nuk ka mekanizma parandalues që do të mundësojnë funksionim pa pengesa të Prokurorisë Publike në rastin kur Këshilli nuk do të marrë vendim (për shembull: nëse Këshilli nuk cakton ushtrues detyre, anëtarin më i vjetër i Këshillit do të marrë përsipër punën, etj.).

Neni 26 i Ligjit e rregullon transferimin e përkohshëm të prokurorëve publikë për shkak të rritjes së vëllimit të punës ose për shkak të uljes së numrit të lëndëve të pazgjidhura. Në thelb, ligjvënësi nuk bën dallim për transferimin e përkohshëm me pëlqimin dhe pa pëlqimin e prokurorit publik që transferohet, siç është rasti në LGJ, dhe në të njëjtën kohë nuk e bën dallimin e procedurës së transferimit me ose pa pëlqimin, dhe së këtejmi nuk është e qartë se cili është dallimi gjatë veprimit për dy rastet individuale dhe nëse prokurori publik jep pëlqim mund të transferohet pa kufizime. Një paqartësi e tillë e krijon rrezikun e zbatimit të pabarabartë të ligjit. Në këtë seksion, mungojnë edhe mekanizmat parandalues për sa i përket faktit se prokurori publik i cili ka refuzuar të japë pëlqimin dhe është transferua pa pëlqimin e tij, nuk mundet mosdhënia e pëlqimit të merret më pas si aspekt negativ gjatë vlerësimit të punës / ngritjes në detyrë.

Neni 28 e rregullon mbikëqyrjen mbi ushtrimin e funksionit prokurorial. Ky nen nuk parashikon mekanizma parandalues të llojit të rregullimit ligjor të aspekteve të mbikëqyrjes (mbikëqyrje e rregullt - sa shpesh, e jashtëzakonshme - në cilat situata), përkatësisht në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni, mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes përcaktohet me rregulloret e miratuara nga KPP, ku Prokurori Publik Shtetëror është anëtar. Duke i marrë parasysh kompetencat e zbatimit mbikëqyrës, ky rregullim i mbikëqyrjes paraqet rrezik për korrupsion. Paragrafi (3) i këtij neni përcakton se mbikëqyrja në punën administrative mbi Prokurorinë Publike kryhet nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo dispozitë është plotësisht e paqartë, përkatësisht nuk është e qartë nëse Prokurori Publik i

Republikës së Maqedonisë së Veriut është kompetent për mbikëqyrjen mbi punën administrative të të gjitha prokurorive publike apo vetëm mbi Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 31 i Ligjit i përcakton kompetencat e prokurorit publik në ushtrimin e funksionit të ndjekjes të kryerësve të veprave penale dhe kundërvajtjeve. Nuk parashikohet se cilat janë kompetencat dhe përgjegjësitë e prokurorit publik të cilit i janë besuar si detyra menaxheriale - shefat e prokurorive publike/seksioneve. Në të njëjtën kohë, në disa nga alinetë e këtij neni, nuk specifikohet se në cilat raste veprohet kështu, megjithëse theksohet “në përputhje me ligjin”, kështu që është i nevojshëm harmonizimi i duhur. Dispozita e përgjithshme “kryen punë të tjera në përputhje me ligjin” është një rrezik korrupsioni sepse nuk i caktohet asnjë kufizim këtyre kompetencave: nëse prokurori publik në parim mund të dalë nga kompetencat procedurale duke iu referuar kësaj dispozite dhe nëse po, në cilat situata (në praktikë ka fenomene të tilla, kështu që do ishte e pëlqyeshme ato të adresohen në ligj, dhe të mos lihet hapësirë për veprime subjektive).

Neni 33 i ligjit e rregullon atë se për çka është kompetent të veprojë Seksioni i Specializuar për Ndjekjen e Veprave Penale të Kryera nga Persona me Kompetenca Policore dhe nga Pjesëtarët e Policisë së Burgjeve. Për harmonizimin me paragrafin (1) të të njëjtit nen, në alinenë 2 duhet të përcaktohet se cilëve persona u referohet kompetenca: këtu njëllon mendohet për personat me kompetenca policore dhe pjesëtarët e policisë së burgjeve. Përndryshe, një paqartësi e tillë lë hapësirë për interpretim subjektiv dhe paraqesin rrezik për korrupsion. Nga ana tjetër, alineja 2 e paragrafit (1) të këtij neni duhet të përfshijë çdo abuzim të kryer gjatë kohës që personi me kompetenca policore dhe pjesëtari i policisë së burgjeve është në marrëdhënie pune, me qëllim shmangien e praktikës së hapjes së pushimit mjekësor ose marrjes së pushimit vjetor me qëllim shmangien e veprimeve nga prokuroria publike. Kështu, dispozita në fjalë duhet të rishikohet plotësisht për të shmangur trajtimin e pabarabartë dhe për të ruajtur kuptimin e kompetencës së veçantë. Në paragrafin (3) të këtij neni përcaktohet se Prokurori Publik i Seksionit të Specializuar për Ndjekjen e Veprave Penale të Kryera nga Personat me Autorizime Policore dhe Pjesëtarët e Policisë së Burgjeve, jashtë rasteve të parashikuara në paragrafin (1) të këtij neni, sipas detyrës zyrtare inicon procedurë për vlerësimin e arsyeshmërisë së përdorimit të armës së zjarrit, si dhe përdorimin e forcës ose mjeteve të detyrimit që për pasojë ka vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor nga personat e paragrafit (2) të këtij neni. Në dispozitë nuk ka mekanizma parandalues për përmbushjen e saj. Me fjalë të tjera, është e paqartë se si prokurori publik do të vihet në dijeni për këto rrethana, kur ligjvënësi nuk e ka parashikuar detyrimin e të gjitha organeve kompetente ku këta persona janë të punësuar ta njoftojnë prokurorin publik për të gjitha situatat në të cilat këta persona kanë qenë të involvuar, ndërkaq është shfaqur pasojë e tillë. Kjo mungesë e mekanizmit parandalues paraqet rrezik për korrupsion. Përveç kësaj, askund nuk është e rregulluar struktura organizative e Seksionit të Specializuar për Ndjekjen e Veprave Penale të Kryera nga Personat me Autorizime Policore dhe Pjesëtarët e Policisë së Burgjeve, kështu që dispozita nga paragrafi (4) sipas së cilës për rastet e paragrafit (3) të këtij neni, Prokurori Publik e informon udhëheqësin e Seksionit të Specializuar, është diskutabile për sa i përket asaj çka nëse vetëm një prokuror është anëtar i seksionit dhe kush do të raportojë për rrethanat e tilla. Prandaj, është e nevojshme të riprecizohet ky nen me një mekanizëm parandalues që do ta definonte strukturën e seksionit, nga pikëpamja se a duhet të ketë të paktën 2-3 prokurorë dhe të rregullohet mënyra e përcaktimit të numrit të prokurorëve publikë në këtë seksion, etj.

Me nenin 83 përcaktohet se profesionalizmi dhe cilësia në vendimet, mjetet juridike dhe dokumentet e tjera nënkupton zbatimin e drejtë të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare në përputhje me Kushtetutën, praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe akteve të tjera normative, qasje korrekte ndaj miratimit dhe përpilimit të vendimeve të Prokurorisë Publike, avokimi i tyre, aftësia dhe dhuntia e oratorisë dhe aftësia e argumentimit dhe arsyetimit juridik në procedurën para gjykatave kompetente, mos komentimi i

lëndëve në publik dhe ruajtjen si sekret të asaj që prokurori publik e mëson gjatë ushtrimit të funksionit. Duke vepruar kështu, mos komentimi i lëndëve në publik nuk është harmonizuar me detyrimin për funksionimin transparent të prokurorëve publikë të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji. Përveç kësaj, ka mungesë të kriterëve dhe një shkallë sipas së cilës do të vlerësohet pragu i përmbushjes së këtij kriteri (për shembull: përqindja e lëndëve në të cilat ky kriter është përmbushur, etj.).

Konform nenit 40 paragrafit (1), puna e ndërgjegjshme nënkupton punën në përputhje me ligjet dhe respektimin e udhëzimeve të detyrueshme të përgjithshme me shkrim, si dhe respektimin e afateve. Kjo dispozitë është e paqartë, kurse mbetet e paqartë në lidhje me përcaktimin e punës në përputhje me ligjet, përkatësisht nëse pragu i pranueshmërisë është që prokurori publik të mos i jetë nënshtruar ndëshkimit disiplinor ose penal. Përveç kësaj, nuk parashikohet se kush, në çfarë mënyre dhe në çfarë procedure duhet të përcaktojë mosrespektimin e udhëzimeve të detyrueshme, dhe nuk përcaktohet saktësisht se cilat afate kërkohen të respektohen (procedurale, instruktive në udhëzimet, etj.). Rregullimi i pamjaftueshëm i kësaj çështjeje lë hapësirë për interpretime të ndryshme dhe zbatim subjektiv të dispozitës.

Me nenin 41 përcaktohet se reputacioni dhe etika të denja për funksionin, nënkupton dinjitet dhe autoritet në mjedisin ku punon dhe jeton prokurori publik dhe respektim të Kodit të Etikës së Prokurorëve Publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ndërkohë, nuk është e qartë se si vlerësohet respektimi i Kodit të Etikës, përkatësisht nëse nuk ka procedura para Këshillit Etik, kjo vlerësohet me automatizëm, nëse në procedurën e vlerësimit kryhen kontrole shtesë, etj. Dispozita nuk e përcakton procedurën e vlerësimit të përmbushjes së këtij kriteri.

Me nenin 42 përcaktohet se bashkëpunimi dhe sjellja ndaj palëve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë nënkupton sjellje profesionale, korrekte dhe dinjitoze ndaj pjesëmarrësve në procedurë, në marrëdhëniet në prokurorinë publike dhe marrëdhëniet me të gjitha autoritetet dhe organizatat e tjera me të cilat, në përputhje me ligjet, prokurori publik është i autorizuar të komunikojë dhe bashkëpunojë dhe të mbështesë përsosjen profesionale dhe avancimin profesional të kolegëve. Dispozita nuk e cakton mënyrën e përcaktimit të këtij kriteri dhe mënyrën e vlerësimit të kësaj sjelljeje të prokurorëve publikë (për shembull: a zbatohen sondazhe, etj.). Përveç kësaj, ka një paqartësi në lidhje me atë se si prokurori publik duhet të mbështesë përsosjen profesionale të kolegëve. Formulimet e tilla të përgjithshme përmbajnë rrezikun e interpretimit të ndryshëm dhe trajtimit të pabarabartë.

Neni 44 i Ligjit e përcakton se aftësi organizative do të thotë të kesh aftësi për të menaxhuar Prokurorinë Publike ose seksionet e prokurorisë publike dhe krijimin e marrëdhënieve për kryerjen e suksesshme dhe efikase të punës së përgjithshme në prokurorinë publike. Sa i përket aftësive për të menaxhuar Prokurorinë Publike ose seksionet në prokurorinë publike, mungojnë parametra me të cilët vlerësohet kjo aftësi e prokurorit publik, përkatësisht nëse vlerësohet përmes rritjes së përqindjes së suksesit, reduktimit të numrit të lëndëve të prapambetura, etj.

Në përputhje me nenin 45 notimi/vlerësimi i punës së prokurorëve publikë bëhet përmes këqyrjes së drejtpërdrejtë të procedimit të lëndëve, raporteve mujore, përmes bisedës të drejtpërdrejtë me prokurorin publik i cili notohej, shqyrtimit të parashtrësave, ankesave apo lëvdatave për punën e tij që regjistrohen në dosjen profesionale të çdo prokurori. Kjo dispozitë nuk i përfshin të gjitha veprimet që janë të nevojshme për vlerësimin e të gjitha kriterëve. Për shembull, marrëdhënia me kolegët nuk mund të përcaktohet përmes ndonjë prej mënyrave të listuara, kështu që është evidente se nuk është e mundur me mënyrat e parashikuara të vlerësohen të gjithë parametrat përkatës për ndërtimin e vlerësimit të prokurorit publik.

Në dispozitën e nenit 46 paragrafin (3) të Ligjit përcaktohet se qëllimi i vlerësimit është identifikimi i problemeve që i ka prokurori publik në ushtrimin e funksionit të tij, shqyrtimi i mundësive për tejkalimin e tyre, si dhe përmbushja e kriterëve për avancimin e tyre. Për më tepër, ekziston një paqartësi në dispozitën në fjalë lidhur me faktin nëse përcaktimi i qëllimit të vlerësimit do të thotë se procedura e vlerësimit nuk mund të jetë bazë për procedurat disiplinore.

Në nenin 47 të këtij ligji specifikohen të dhënat që përcaktohen me këqyrjen e drejtpërdrejtë në punën me lëndë të prokurorëve publikë. Në dispozitën e këtij neni mungojnë të dhënat për numrin e lëndëve të zgjidhura jashtë afateve ligjore, ndërsa në lidhje me alinenë 4 nuk parashikohen kriterë madje nuk përcaktohet as mënyra e përcaktimit të cilësisë së veprimit të prokurorit publik.

Në përputhje me nenin 48, aftësia organizative e prokurorëve publikë në prokuroritë publike, përkatësisht e udhëheqësve të seksioneve në prokuroritë publike, si dhe aftësia e tyre për ndërtimin e reputacionit dhe autoritetit të Prokurorisë Publike dhe aftësia për të krijuar dhe kultivuar marrëdhënie korrekte dhe të shëndetshme, përcaktohen përmes këqyrjes në regjistrat me karakter administrativ, përmes bisedës së drejtpërdrejt me prokurorin publik, përkatësisht me udhëheqësin e seksionit, këqyrjes së raporteve nga kontrollet e kryera dhe përmes mbikëqyrjeve mbi punën e Prokurorisë Publike të cilën ai e udhëheq, si dhe mbi raportet vjetore për efikasitetin gjatë ushtrimit të funksionit prokurorial. Sa i përket transparencës dhe pjesëmarrjes, dispozita në fjalë nuk i përfshin të gjitha mënyrat e nevojshme për të përcaktuar plotësisht vlerësimin e aftësisë organizative të prokurorëve publikë, përkatësisht e njëjta gjë mund të bëhet përmes sondazheve me punonjësit, këqyrjes në raportet e publikuara të organizatave mbi efektivitetin e prokurorëve publikë, etj.

Lidhur me procedurën e rivlerësimit të prokurorëve publikë, dispozitat e nenit 51 të ligjit përcaktojnë që një kopje e vendimit për vlerësimin e punës së prokurorit publik i dërgohet KPP-së, prokurorit publik të cilit i referohet vlerësimi dhe Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Së këtejmi, nuk është përcaktuar vendi se ku dërgohet vlerësimi i prokurorit publik, madje nuk është rregulluar as ajo se çfarë konsiderohet dërgim i rregullt.

Neni 53 e rregullon procedurën në të cilën KPP merr vendim për kundërshtimin me shkrim të paraqitur nga një prokuror publik i cili është i pakënaqur me notën që e ka marrë. Për më tepër, nuk është rregulluar çështja se çfarë nëse Këshilli nuk merr vendim për kundërshtimin, përkatësisht mungon mekanizmi parandalues që do të lejonte shmangien e një situate të tillë. Njëherësh, mungojnë garanci shtesë në pjesën e rregullave të veprimit të Këshillit të llojit “sipas kriterëve dhe procedurës së përcaktuara me këtë ligj” që lë hapësirë për abuzime.

Neni 54 e rregullon detyrimin e çdo prokurorie publike për të përpiluar një raport vjetor për punën e tij. Dispozitat e këtij neni nuk parashikojnë pasoja në rast të mosparaqitjes ose mos përpilimit të raportit madje dispozitat nuk e përcaktojnë se prej ku merren të dhënat për raportin.

Konform nenit 55 paragrafit (1), Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut Raportin Vjetor për punën e të gjitha prokurorive publike sipas nenit 54 paragrafit (4) të këtij ligji, dhe gjendjen e kriminalitetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut e paraqet në Kuvend. Kjo dispozitë nuk specifikon se çfarë ndodh pas marrjes së raportit në Kuvend, përkatësisht nëse Kuvendi detyrimisht duhet ta shqyrtojë apo jo, cilat vendime mund t'i marrë Kuvendi në lidhje me Raportin, cilat janë pasojat e atyre vendimeve, etj.

Neni 56 i Ligjit i rregullon udhëzimet e veçanta të përgjithshme me shkrim. Paragrafi (4) e ndalon miratimin e udhëzimit në kundërshtim me këtë nen, me ç'rast nuk rregullohet se çfarë nëse megjithatë një udhëzim i tillë miratohet. Veç tjerash, mungon një mekanizëm parandalues udhëzimet në

kundërshtim me këtë ndalim prokurorët publikë nuk e kanë për detyrë t'i zbatojnë apo se ata mund të iniciojnë procedurë para KPP-së për të vlerësuar nëse udhëzimi e cenon pavarësinë e prokurorëve publikë në aspektin e veprimit/trajtimit të një lënde konkrete.

Në përputhje me nenin 57, me qëllim të ushtrimit pa ndërprerje të funksionit, Prokuroria Publike organizon kujdestari për prokurorët publikë. Së këtejmi, nuk ka kurrfarë kriteresh për orarin dhe kohëzgjatjen e kujdestarive, ndërkaq nuk ka as dispozita për periudhën kohore të orarit, ku paraqitet i njëjti. Me dispozitat e këtij neni, ekziston mundësia që të njëjtët prokurorë të jenë vazhdimisht kujdestarë, gjë që paraqet rrezik për korrupsion.

Dispozitat e nenit 62 të këtij ligji i rregullojnë kushtet e veçanta për zgjedhjen e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokurorit Publik në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokurorit të Lartë Publik në Prokurorinë e Lartë Publike, Prokurorit Publik në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Prokurorit Themelor Publik në PTHP NKOK, Prokurorit Themelor Publik të Prokurorisë Themelore Publike dhe Prokurorit Publik në Prokurorinë Themelore Publike përveç kushteve të përcaktuara në nenin 61 të këtij ligji. Atëherë, fushëveprimi i dispozitave të specifikuara nuk është i barabartë për të gjithë, përkatësisht e përjashton kategorinë e prokurorëve publikë të cilëve marrëdhënia e punës u është pezulluar për sa i përket mundësive për ngritjen e tyre në detyrë. Për më tepër, nevojitet të plotësohen dispozitat në mënyrë që do ta përcaktojë të drejtën e zgjedhjes së prokurorit publik në një prokurori më të lartë publike dhe në rast se prokurori ka qenë anëtar i Këshillit të Prokurorëve Publikë ose nëse është transferuar të punojë në një organizatë tjetër, përkatësisht marrëdhënia e punës i është pezulluar. Në rast të pranimit të rekomandimit të dhënë, është e nevojshme që ligjvënësi të parashikojë nëse në raste të tilla do të ketë përjashtim nga kushtet për notë/ vlerësim pozitiv dhe në cilat raste do të vlejë përjashtimi.

Lidhur me kushtet prokurori publik të ketë notë pozitive në 4 vitet e fundit, të përcaktuar në nenin 61 paragrafin (1) alineja 2, 3 dhe 4, ekziston konflikt i brendshëm me nenin 36 paragrafin (3) të këtij ligji, i cili parashikon që për zgjedhjen në një prokurori më të lartë publike, kryhet një vlerësim/notim i jashtëzakonshëm, i cili nuk zbatohet vetëm me përjashtim, nëse prokurori publik është vlerësuar/notuar pozitivisht.

Në nenin 63⁴ paragrafin (3), është e paqartë nëse opinionin e KPP-së është i karakterit këshillues apo detyrues. Megjithatë, nuk është rregulluar se si do të veprohet nëse Këshilli nuk e jep opinionin ose nëse jep një opinion negativ për disa nga kandidatët. Veç tjerash, në nenin e specifikuar mungojnë dispozita lidhur me atë nëse mund të hedhë poshtë një kandidaturë për shkak të dokumentacionit jo të plotë dhe a duhet Këshilli ta vlerësojë këtë. Është diskutabile se çfarë opinionin do të japë Këshilli nëse kandidati është gjyqtar ose aktualisht nuk është prokuror publik, kështu që nuk është e qartë kur e jep opinionin cilat kritere duhet t'i marrë parasysh Këshilli dhe çfarë duhet të vlerësojë. Opinionin e Këshillit është kundërpeshë adekuate ndaj pushtetit ekzekutiv gjatë zgjedhjes së Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, por procedura për dhënien e opinionit të tillë duhet të rregullohet në mënyrë të detajuar.

⁴Neni 63

(1) Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për një periudhë prej gjashtë vjetësh me të drejtë riemërimi.

(2) Prokurorët publikë i zgjedh Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut pa kufizime të kohëzgjatjes së mandatit sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar me ligj.

(3) Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut jep opinion për propozimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për emërimin dhe shkarkimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në nenin 64⁵ të LPP-së ekziston një paqartësi, përkatësisht nuk është e qartë nëse për kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet Këshilli i Prokurorëve Publikë miraton aktvendim të veçantë për hedhjen poshtë të aplikacionit. Përveç kësaj, nuk është parashikuar një mekanizëm mbrojtës - ankimi, kontesti administrativ, etj. Nga ana tjetër, kandidati nuk e ka të drejtën e kundërshtimit të opinionit negativ, ndërkaq ky është kushti që Qeveria ta propozojë kandidatin për Prokuror Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mungojnë edhe kriteret që duhet t'i vlerësojë Këshilli, kështu që është lënë hapësirë e gjerë për abuzime gjatë zbatimit të procedurës të cilën e rregullon ky nen. Lidhur me paragrafin (6) kur Këshilli nuk do të japë mendim pozitiv për asnjë kandidat dhe kur procedura do të përsëritet, nuk parashikohet asnjë mekanizëm që do të parandalonte përsëritjen e pafund të procedurës në një situatë kur Këshilli jep vazhdimisht mendime negative për kandidatët.

Në nenin 65 të Ligjit rregullohet procedura e zgjedhjes së prokurorëve të lartë publikë të prokurorive të larta publike dhe prokurorëve themelorë publikë të prokurorive themelore publike të zgjedhura nga KPP-ja për një periudhë katërvjeçare, nga radhët e prokurorëve publikë të zgjedhur me të drejtë rizgjedhjeje. Dispozitat e paragrafit (3) përcaktojnë se procedura fillon tre muaj para skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur. Së këtejmi, nuk parashikohen mekanizma parandalues që do të garantojnë përmbushjen e kësaj dispozite ligjore. Në paragrafin (4) përcaktohet se KPP-ja me vendim e përcakton numrin e prokurorëve publikë në prokuroritë publike dhe e zbaton procedurën e zgjedhjes dhe shkarkimit të prokurorëve publikë. Veç tjerash, nuk ka kriteret nga të cilat Këshilli do të udhëhiqet gjatë përcaktimit të numrit të prokurorëve nëpër prokuroritë, madje nuk është përcaktuar as metodologjia e veçantë për caktimin e këtij numri. E njëjta gjë vlen edhe për paragrafin (5) sa i përket numrit të prokurorëve në PTHP NKOK, përkatësisht mungojnë kriteret dhe procedura në të cilat përcaktohet numri i prokurorëve, në kuptimin e sigurimit të treguesve statistikorë dhe ngjashëm. Në paragrafin (6) është përcaktuar se gjatë zgjedhjes së prokurorit publik, nuk guxon të bëhet diskriminim në lidhje me: racën, ngjyrën e lëkurës, kombësinë, origjinën etnike, fenë ose besimin, aftësinë e kufizuar fizike, seksin, identitetin gjinor, orientimin seksual dhe bindjen politik. Në këtë dispozitë, ligjvënësi nuk ka parashikuar mekanizma parandalues, përkatësisht nuk ka parashikuar se çfarë në rast të konstatimit të diskriminimit gjatë zgjedhjes.

Dispozitat e nenit 66 e rregullojnë procedurën e zgjedhjes së prokurorit themelor publik në PTHP NKOK. Në këtë nen mungojnë mekanizmat parandalues: nuk është përcaktuar procedura që do të mundësojë fillimisht seleksionimin administrativ të kandidatëve që i plotësojnë kushtet sipas ligjit, me të drejtë ankimi, dhe pas përfundimit të kësaj procedure të vazhdohet me procedurën e zgjedhjes. Mungon edhe procedura se si përcaktohet se cili kandidat zgjidhet në rast se dy kandidatë kanë numër

⁵Neni 64

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e shpall emërimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe së paku në dy gazeta ditore, njëra prej të cilave njëra botohet në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, më së voni dy muaj para skadimit të mandatit ose menjëherë pas zbrazjes së vendit. Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i detyruar ta njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për skadimin e mandatit, më së voni në afat prej tre muajsh para skadimit të mandatit.

(2) Afati i paraqitjes së aplikacioneve është 15 ditë nga data e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(3) Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e dërgon opinionin e justifikuar pozitiv ose negativ me shkrim për të gjithë kandidatët e paraqitur në shpalljen të cilët i plotësojnë kushtet në përputhje me ligjin.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut propozim për emërimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga kandidatët e paraqitur për të cilët Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka dhënë opinion pozitiv. Për kandidatin e propozuar nga Qeveria për Prokuror Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, propozimit i bashkëngjitet edhe opinionin i Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Nëse Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për arsye të justifikuara brenda afatit të përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, nuk paraqet opinion në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, afati i përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni do të shtyhet për 15 ditë të tjera. Nëse Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk paraqet opinion brenda këtij afati, vlerësohet se opinion është pozitiv.

(6) Nëse Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk jep opinion pozitiv për asnjë nga kandidatët e paraqitur, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk mund të përcaktojë propozim për emërimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do t'i propozojë Kuvendit ta përsërisë shpalljen nga paragrafi (1) të këtij neni.

të njëjtë votash. Gjithashtu, mungojnë edhe kriteret në bazë të të cilave Këshilli i Prokurorëve Publikë përpilon listën e kandidatëve që i plotësojnë kushtet.

Neni 69 i këtij ligji e parashikon detyrimin dhe mënyrën e dhënies së deklaratës solemne të prokurorit publik përpara fillimit të funksionit si prokuror publik. Në dispozitat e tij, është veçanërisht e rëndësishme të rregullohet çështja se kur fillon mandati i prokurorit publik, përkatësisht nga cili moment konsiderohet i zgjedhur në detyrë: pas dhënies së deklaratës solemne ose pas marrjes së njoftimit për zgjedhjen e tij nga KPP-ja. Në të kundërt, dispozita mund të interpretohet dhe zbatohet në mënyra të ndryshme, veçanërisht nga pikëpamja e respektimit të afateve për përmbushjen e detyrimit të prokurorit si person i zgjedhur të paraqesë deklaratë për gjendjen pasurore dhe interesat, të përcaktuar me LPKKI.

Neni 74 e përcakton se lartësia e pagës dhe kompensimeve të tjera të prokurorit publik rregullohen me ligj dhe ajo nuk mund të reduktohet, përveç rasteve të përcaktuara me ligj. Lidhur me çështjen e pagave të prokurorëve publikë, ajo duhet të rregullohet me ligj të miratuar me shumicën e njëjtën me të cilën është përcaktuar standardi për pandryshueshmërinë e pagave të prokurorëve publikë, me qëllim të sigurimit të një sigurie më të madhe ligjore gjatë ushtrimit të funksionit prokurorial.

Neni 75 e përcakton të drejtën e kompensimit të shpenzimeve të prokurorit publik, i cili, sipas nevojës së shërbimit, transferohet përkohësisht që funksionin e prokurorit publik ta ushtrojë jashtë vendbanimit ose është zgjedhur apo sistematizuar në një prokurori tjetër. Është më se e nevojshme të inkorporohen parametra dhe kriteret për përcaktimin e këtyre kompensimeve, në mënyrë që rregullimi të mos i lihet vendimmarrjes diskrecionale të prokurorit publik, por ai të ketë mundësi ta rregullojë vetëm procedurën e pagesës dhe lartësisë të një kategorie të veçantë kompensimesh.

Me nenin 76 paragrafin (1), ligjvënësi ka parashikuar se prokurori publik që nuk ka banesë të tij në selinë e prokurorisë publike ka të drejtë të përdorë banesë adekuate zyrtare. Përveç kësaj, nuk është paraparë procedura, madje nuk është përcaktuar se kush dhe në çfarë mënyre vendos për të drejtën e prokurorit publik të përdorë banesë zyrtare.

Mundësia që Këshilli të paraqesë iniciativë për shkarkimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut e përcaktuar në paragrafin (3) të nenit 88⁶ është në kundërshtim me paragrafin (1) të të njëjtit nen sepse atje Këshilli jep opinion mbi propozimin e Qeverisë për shkarkim, kështu që ekziston kumulim i funksioneve tek organi/autoriteti që e propozon iniciativën dhe më pas jep opinion, që përbën rrezik për korrupsion. Në paragrafin (6) është i paqartë përcaktimi i ligjvënësit Prokurori

⁶ “Neni 88

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas opinionit paraprak të Këshillit të Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut propozim për shkarkimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut shkarkohet nga funksioni Prokuror Publik para skadimit të mandatit:

- për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore sipas nenit 91, nga alineja 1 deri në alinenë 6 të këtij ligji nëse shkelja është kryer me dashje ose nga pakujdesia e dukshme me fajin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pa arsye të justifikuar dhe nëse shkelja ka shkaktuar pasoja të rënda ose

- nëse është anëtar i një partie politike.

(3) Iniciativë për shkarkimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të paraqesë Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të cilën do t'i theksojnë arsyet, rrethanat dhe faktet nga të cilat është udhëhequr për paraqitjen e iniciativës.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të paraqesë propozim për shkarkimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Këshillin e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili e ka për detyrë, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së propozimit, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut të paraqesë opinion të arsyetuar pozitiv ose negativ me shkrim.

(5) Në seancën e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku shqyrtohet propozimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkarkimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk merr pjesë.

(6) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka të drejtë të shprehet me shkrim për propozimin e paragrafit (1) të këtij neni.

(7) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut propozimit për shkarkim ia bashkëngjit opinionin e paragrafit (4) të këtij neni, dhe detyrimisht i paraqet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(8) Nëse Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për arsye të justifikuar brenda afatit të përcaktuar, nuk paraqet opinion në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, afati i përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni do të shtyhet për 15 ditë të tjera. Nëse Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk paraqet opinion edhe brenda këtij afati, vlerësohet se nuk e mbështet propozimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(9) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka të drejtë të marrë pjesë në seancën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të prononcohet për propozimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkarkimin e tij.”

Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut të mos marrë pjesë në mënyrë aktive në procedurën, gjë që e vë atë në një pozitë të pabarabartë me prokurorët e tjerë publikë për të cilët kërkohet shkarkimi, të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë aktive në procedurën.

Nenet 91 dhe 92 përcaktojnë shkelje të rënda dhe të lehta disiplinore të prokurorëve publikë. Së këtejmi, ligjvënësi nuk përcaktoi se shkelja e Kodit të Etikës është shkelje disiplinore të cilën nuk e ka parashikuar as si të rëndë dhe as si të lehtë. Për rrjedhojë, në dispozitat e këtij ligji mungojnë sanksione nëse prokurori publik e cenon përkatësisht vepron në kundërshtim me Kodin e Etikës.

Neni 93 përcakton procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë së prokurorëve publikë për shkelje disiplinore të kryer. Ligji është i paqartë në pjesën e paraqitjes së propozimit për procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë nga prokurori i lartë publik, përkatësisht mungon sqarimi se ai mund të parashtrijë propozim vetëm për prokurorët e lartë publikë të rajonit të tij edhe për prokurorët themelore publikë të rajonit të tij. Nga këto dispozita rezulton se Prokurori i Lartë Publik brenda një rajoni mund të paraqesë propozim për Prokurorin Themelor Publik në një rajon tjetër, i cili nuk është në kompetencë të Prokurorit të Lartë Publik. Për më tepër, paragrafi (2) i këtij neni nuk përcakton se sa anëtarë duhet të jenë të pranishëm që Komisioni të punojë për zbatimin e procedurës, ndërkaq nevojiten edhe garanci shtesë. Për shembull, prokurorët publikë anëtarë të komisionit duhet të përjashtohen edhe nëse ka konflikt të interesave për çfarëdo arsye, siç janë procedurat paraprake, raporte farefisnore dhe raporte të ngjashme, etj. Madje edhe nëse zbatohet në praktikë, megjithatë nevojiten garanci ligjore që veprimi i tillë të vendoset si standard. Për më tepër, ky nen nuk përmban dispozita sipas të cilave do të zhvillohet procedura: nëse dhe si do të veprohet me propozimin për prova, nëse dhe kur mund të mos pranohet të prezantohen provat, etj.

Neni 94 paragrafi (5) e përcakton të drejtën e prokurorit publik kundër të cilit është zbatuar procedurë disiplinore të iniciojë kontest përpara një gjykate kompetente kundër vendimit të KPP-së me të cilin është shqiptuar masa e shkarkimit nga funksioni. Së këtejmi, ligjvënësi nuk e ka rregulluar pasojën nga zhvillimi i kontestit, përkatësisht nëse me iniciimin e kontestit shtyhet ekzekutimi i vendimit apo jo, njëherësh nuk është përcaktuar saktësisht se kush është gjykata kompetente për iniciimin e kontestit kundër vendimit në fjalë.

Neni 95 i ligjit parashikon masa disiplinore për shkelje disiplinore të lehtë dhe të rëndë. Përveç kësaj, nuk janë përcaktuar kritere në cilat raste cila masë do të shqiptohet, madje nuk ka as dispozitë që e rregullon se sa herë mund të shqiptohet masë për shkelje të lehtë disiplinore, përkatësisht mbas sa masash të shqiptuara për shkelje të lehta disiplinore, çdo shkelje e radhës do të konsiderohet e rëndë.

Në parim, dispozita e nenit 96 deri në nenin 99 duhet t'i referohen shërbimit prokurorial dhe është e nevojshme të përcaktohen të gjitha kategoritë e personave të përfshirë në shërbimin. Këtu, në veçanti, duhet të rregullohet trajtimi i hetuesve të cilët janë përfshirë me Ligjin ndërkaq ka zëra se ka dy kategori të hetuesve, por nuk ka rregullim të plotë të tyre.

Çështja e financimit, është rregulluar me nenin 101⁷, është veçanërisht problematike nga pikëpamja e korrupsionit, kështu që edhe pse mos akordimi i mjeteve të kërkuara minimale është një përjashtim,

⁷ Neni 101

(1) Bazuar në politikën fiskale dhe kategoritë kryesore të të ardhurave dhe shpenzimeve të vlerësuara, lartësia e mjeteve të punës të Prokurorisë Publike është së paku 0.4% nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin aktual, me kusht që kjo të mos e cenojë ndarjen e drejtë të mjeteve buxhetore dhe të mos ndikojë në mjetet e planifikuara për të gjitha zërat e shpenzimeve buxhetore.

(2) Lartësia e mjeteve për punën e Prokurorisë Publike të nenit 100 të këtij ligji do të përcaktohet në bazë të një propozimi të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili do t'i dërgohet Ministrisë së Financave. Mjetet e këtij paragrafi përcaktohen në bazë të politikës fiskale dhe kategorive kryesore të të ardhurave dhe shpenzimeve të vlerësuara dhe qarkores buxhetore të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin e ardhshëm buxhetor dhe kriteret e brendshme dhe metodologjinë të përcaktuara nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

fitohet përshtypja se në praktikë gjithmonë është rregull dhe për zbatimin e tij nuk janë parashikuar kurrfarë mekanizmesh parandalues. Nuk janë parashikuar as mekanizma parandalues për zbatimin e harmonizimit të buxhetit. Nga ana tjetër ekziston një procedurë pamjaftueshëm e rregulluar, përkatësisht nuk janë parashikuar afate kur përcaktohen kriteret e brendshme dhe metodologjia, me cilin akt dhe çfarë duhet të përmbajnë ato, si dhe a do të dërgohen në Ministrinë e Financave, etj.

Nuk është e qartë në nenin 102⁸ a mundet Prokurori Publik Shtetëror të mos pajtohet me propozimin e PTHP NKOK dhe çfarë nëse në Buxhet inkorporon një vlerë më të ulët. Përveç kësaj, nuk është në rregull çka nëse ai nuk pajtohet të kërkojnë mjete shtesë për punën e PTHP NKOK, ndërkaq kjo është e domosdoshme. Këto dispozita, me procedura jo të plota dhe mungesë të mekanizmave parandalues që do të garantojnë zbatimin e mundësisë ligjore, përbëjnë rrezik për korrupsion. Dispozita që i përcakton pagat e PTHP NKOK gjithashtu paraqet rrezik për korrupsion sepse nuk korrespondojnë me natyrën e punëve dhe praktikën globale dhe rajonale.

Neni 103 i Ligjit përcakton se pagat dhe kompensimet e pagave të prokurorëve publikë rregullohen me ligj, si dhe se hetuesi në një qendër hetimore ka të drejtën e shtesës së pagave sipas paragrafit (1) të këtij neni. Nga pikëpamja e ruajtjes së teknikës ligjore legjislative koherente dhe harmonizimit të saj me fushëveprimin e ligjit, është e nevojshme të rishikohet statusi dhe të drejtat e hetuesve me një ligj të veçantë.

Në përputhje me nenin 104, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut bën shpërndarjen e mjeteve nëpër prokuroritë, në nivel vjetor dhe mujor, në bazë të standardeve dhe kriterëve. Së këtejmi, nuk janë përcaktuar standarde dhe kriterë për shpërndarjen e mjeteve dhe përveç kësaj nuk ka garanci se Prokuroria Publike është e pavarur në disponimin e mjeteve, kundrejt faktit se gjithmonë kërkohet pëlqim nga Ministria e Financave, gjë që e pamundëson shpenzimin e plotë dhe efikas të mjeteve.

Në nenin 106⁹ mungon procedura e mënyrës dhe afateve të përcaktuara për paraqitjen e propozimit në Qeveri, pastaj se si vepron Qeveria ndaj propozimit, në cilin rast mund ta pranojë atë, dhe në cilin rast mund ta refuzojë, etj.

3.3. Rreziqe në lidhje me përdorimin e termave pamjaftueshëm të qartë dhe pamjaftueshëm të përcaktuar

(3) Propozimi për sigurimin e mjeteve të punës nga neni 100 të këtij ligji e përmban vlerësimin e punëve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të cilat i kryen Prokuroria Publike, numrin e nevojshëm të prokurorëve publikë dhe zyrtarëve të prokurorisë publike, si dhe tregues të tjerë që janë të rëndësishëm për përcaktimin e propozimit të shumës së mjeteve të nevojshme për punën e Prokurorisë Publike.

(4) Para se të dërgohet propozimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministri i Financave doemos duhet ta harmonizojë pjesën e mjeteve për financimin e Prokurorisë Publike me Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nëse nuk arrihet marrëveshje, Ministria e Financave i paraqet raport Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut ia dërgon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut opinion për raportin e Ministrisë së Financave.

(5) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut përfaqëson dhe prezanton pjesën e mjeteve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për financimin e Prokurorisë Publike, në seancën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut kur miratohet propozim Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe para trupave punues edhe në seancën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut kur miratohet Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut."

⁸ Neni 102

(1) Lartësia e mjeteve për punën e Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit përcaktohet në bazë të propozimit të Prokurorit Publik të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, të cilin ia dërgon Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë, me propozim të Prokurorit Themelor Publik të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, mund të paraqesë kërkesa shtesë për financimin e aktiviteteve të shtuara në punë.

(3) Paga e Prokurorit Themelor Publik të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit është 5% më e ulët se paga e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Paga e prokurorëve publikë në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit përcaktohet në lartësinë e pagës së prokurorit publik të Prokurorisë së Lartë Publike."

⁹Neni 106

(1) Kushtet hapësinore, mjetet materiale, pajisjet dhe kushtet e tjera për punën e prokurorëve publike i siguron Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miraton Program me një shumë të caktuar mjeteve për ndërtimin, rikonstruimin, mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjen e prokurorëve publike si dhe e përcakton dedikimin e tyre më për së afërmi.

(3) Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut kujdeset për realizimin e Programit nga paragrafi (2) të këtij neni."

Dispozitat e nenit 10 të Ligjit përdorin emërtim identik kur i referohen njësisë nga aspekti hierarkik më të lartë organizativ të Prokurorisë Publike – Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe vetë institucionit – Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut si tërësi, kështu që për të shmangur paqartësitë dhe konfliktin e dispozitave, është i nevojshëm harmonizimi terminologjik i tekstit të ligjit.

Për më tepër, organizimi fiks i Prokurorisë Publike, pa lënë hapësirë për krijimin e prokurorive të tjera të specializuara publike (për shembull: për krimet e luftës ose për veprat për të cilat është parashikuar juridiksioni universal) është rrezik për korrupsion sepse nuk lejon fleksibilitet në strukturën hierarkike. Për shembull, në Serbi ka prokurori të rregullta dhe speciale, dhe pastaj përcaktohet se cilat prokurori në ç'mënyrë organizohen në frymën e ligjit.

Neni 14 i Ligjit përcakton se në shtet themelohet PTHP NKOK. Në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se në PTHP NKOK krijohet një Seksion i Specializuar për Ndjekjen e Veprave Penale të Kryera nga Persona me Kompetenca Policore dhe Pjesëtarë të Policisë së Burgjeve. Seksioni i Specializuar ka shërbim profesional dhe hetues të prokurorisë publike nga Qendra Hetimore në përputhje me këtë ligj. Prokurorët publikë dhe udhëheqësin e Seksionit të Specializuar i sistematizon Prokurori Publik i PTHP NKOK, nga radhët e prokurorëve publikë të asaj prokurorie, sipas pëlqimit paraprak të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Megjithatë ligji e përdor terminologjinë “nga qendra hetimore në përputhje me këtë ligj”, prapëseprapë ekziston një konflikt i jashtëm me LPP-në, sepse qendrat hetimore janë të parashikuara në LPP-në dhe jo në këtë ligj. Prandaj, është e nevojshme të harmonizohen zgjidhjet ligjore.

Në përputhje me nenin 15, në prokurorinë publike me vëllim të madh të lëndëve të përafërta, për arsye të efikasitetit dhe specializimit më të mirë në punën e prokurorisë publike, mund të krijohen seksione si njësi të brendshme organizative, me ç'rast me punën e seksionit udhëheq një prokuror publik i përcaktuar sipas orarit vjetor të punës së prokurorisë publike në bazë të specializimit dhe ekspertizës më të ngushtë. Termi “lëndë të përafërta” është një term i përgjithshëm që lë hapësirë për interpretim subjektiv. Nga ana tjetër, nevojitet të parashikohen kritere si pikë referimi për krijimin e njësisë të brendshme organizative. Edhe termi “specializim më i ngushtë” është një term i përgjithshëm ku nuk përcaktohen kritere se si do të vlerësohet ky term, ndërkohë që mungon edhe një mekanizëm parandalues për të siguruar që specializimi vlerësohet (për shembull: e drejta e kundërshtimit të orarit).

Në nenin 17 të këtij ligji rregullohet kolegji profesional, ku terminologjia duhet të harmonizohet me terminologjinë juridike ligjore, kështu që për qartësi më të madhe, shefat e prokurorive duhet kështu të përcaktohen në tekstin e të gjithë ligjit.

Neni 20 paragrafi (1) parasheh që Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nevojës mund të mbajë kolegjin në përbërje të zgjeruar me prokurorët e lartë publikë, Prokurorin Themelor Publik të PTHP NKOK dhe me prokurorin themelor publik të Prokurorisë Themelore Publike, për çështje që kanë të bëjnë me ushtrimin e funksionit prokurorial dhe çështje të tjera në kompetencë të prokurorisë publike. Në këtë dispozitë, përdoret një gjuhë e paqartë, përkatësisht termi “sipas nevojës” është i përgjithshëm dhe i padefinuar. Përveç kësaj, nuk janë përcaktuar kriteret dhe nuk është e qartë se si vlerësohet nevoja për ta thirrur kolegjin në përbërje të zgjeruar.

Me nenin 24 paragrafin (3) përcaktohet se Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i sistematizojë punonjësit e prokurorisë publike e cila suprimohet në prokuroritë e tjera publike në vende përkatëse të punës, me të njëjtin status të marrëdhënies së punës. Termi “vende përkatëse të punës” kur bëhet fjalë për punonjësit gjithashtu nuk është përcaktuar, kështu që është e paqartë nëse

mendohet vetëm në ruajtjen e nivelit – bashkëpunëtor profesional apo edhe në të ardhurat nga vendi i punës, gjë që lë hapësirë për interpretim subjektiv dhe ekziston rreziku i zbatimit të ndryshëm të dispozitës.

Në lidhje me kriteret e notimit/vlerësimit të prokurorëve publikë, me nenin 39 përcaktohet se azhurniteti dhe efikasiteti në punë nënkupton veprimin dhe vendimmarrjen brenda afateve të përcaktuara me ligj ndaj kallëzimeve penale, zbatimin efektiv të procedurës paraprake, përfaqësimin e akuzës, pjesëmarrjen në seancat para gjykatës dhe respektimin e afateve ligjore për paraqitjen e mjeteve të rregullta juridike. Për më tepër, efikasiteti nuk është përcaktuar dhe është një term i përgjithshëm që mund të bëhet objekt i interpretimit subjektiv. Nga kjo dispozitë nuk është e qartë se a do të konsiderohet si punë efikase nëse është brenda afatit ndërkaq nuk ka rezultate apo do të konsiderohet si punë efikase nëse afati është më i gjatë ndërkaq ka rezultate. Prandaj, është e nevojshme të riprecizohet dispozita në mënyrë që të minimizohet dykuptimësia.

Në përputhje me nenin 41, reputacioni dhe etika të denja për funksionin prokuror publik, nënkupton dinjitet dhe autoritet në mjedisin ku punon dhe jeton prokurori publik dhe respektim të Kodit të Etikës së prokurorëve publikë. Termi “dinjitet dhe autoritet në mjedisin ” është një kriter i përgjithshëm dhe i pamatshëm për të cilin nuk jepen parametra shtesë vlerësimi.

Dispozitat e nenit 62 të këtij ligji i rregullojnë kushtet e veçanta për zgjedhjen e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokurorit Publik në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokurorit të Lartë Publik në Prokurorinë e Lartë Publike , Prokurorit Publik në PTH NKOK, Prokurorit Themelor Publik në PTHP NKOK, Prokurorit Themelor Publik të Prokurorisë Themelore Publike dhe Prokurorit Publik në Prokurorinë Themelore Publike përveç kushteve të përcaktuara në nenin 61 të këtij ligji. Në kushtet e veçanta, parashikohet përvojë pune pa ndërprerje si prokuror publik prej të paktën një numri të caktuar vitesh. Është e nevojshme të riprecizohet dispozita në drejtim të përcaktimit të asaj se çfarë konsiderohet me përvojë pune pa ndërprerje, veçanërisht në drejtim të pezullimit të përvojes së punës si rezultat i anëtarësimit të prokurorit publik në KPP.

Neni 79 paragrafi (1) i Ligjit përcakton të drejtat e veçanta të prokurorit publik, ku pika 3 përcakton të drejtën për të pasur mbrojtje të veçantë për personin, familjen dhe pronën, me kërkesë të prokurorit publik epror në polici në vendin e banimit, sa herë që ka arsye serioze për sigurinë e tij. Në këtë dispozitë, është e nevojshme të rregullohet termi “prokuror publik epror”, pasi është e paqartë nëse ligjvënësi mendon për shefin e prokurorisë publike, prokurorin më të lartë apo ndoshta për udhëheqësin e seksionit. Paragrafi (3) i këtij neni përcakton se për të drejtat e veçanta të paragrafin (1) alineve 2 dhe 4 të këtij neni, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton akte normative më të përafërta. Edhe në këtë dispozitë, përdoret një term i përgjithshëm “akte normative më të përafërta”, i cili nuk është përkatës nga pikëpamja e terminologjisë juridike legislative.

Në përputhje me nenin 80, prokurorët publikë mund të themelojnë shoqatë me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes së interesave të tyre dhe avancimit të statusit profesional. Pa dyshim se e drejta e asociimit si një nga të drejtat kushtetuese duhet t’u njihet edhe prokurorëve publikë. Megjithatë, duke e pasur parasysh specifikën e këtij lloji të asociimit, e cila në vetvete bart përqendrim të madh të pushtetit në një vend, duhet të përcaktohen mekanizma shtesë parandalues që do të garantojnë se një shoqatë e tillë nuk do të shërbejë për qëllime të tjera dhe nuk do ta tejkalojë nevojën substanciale për asociim. Në këtë drejtim, kryesisht mungojnë mekanizmat me të cilët do të rregullohej financimi dhe funksionimi financiar i këtyre shoqatave, si një nga pikat që janë veçanërisht të rrezikshme për sa i përket korrupsionit. Nga aspekti i financimit të shoqatës duhet të përcaktohen situata kur disa forma të caktuara

të financimit do të ishin të pranueshme, si dhe situata kur detyrimisht do të refuzohen forma të financimit që e bartin rrezikun potencial të korrupsionit.

Neni 84 i Ligjit e rregullon ndalimin e prokurorit publik në ushtrimin e funksionit të tij dhe bashkëshortit/es të tij dhe anëtarëve të tjerë të familjes, familjarëve dhe personave të tjerë që jetojnë në bashkësi me prokurorin publik të pranojnë dhuratat, premtim për dhuratë ose të përdorin favore dhe lehtësime të tjera, me përjashtim të dhuratave protokollare në përputhje me ligjin. Është e nevojshme të përcaktohen termat "favore të tjera" dhe "lehtësime", ndërsa rreziqe nga korrupsioni dhe paqartësi ka edhe në Rregulloren për Marrjen e Dhuratave. Për shembull, për të sqaruar nenin 5 të Rregullores, duhet të precizohet nëse kjo dispozitë i referohet vlerës totale të dhuratave të marra ose vlerës individuale të secilës dhuratë. Në lidhje me nenin 6, nuk përcaktohet vlera që mundet si dhuratë protokollare ta dhurojë prokurori publik. Së fundmi, neni 7 paragrafi 3 i Rregullores është në konflikt të jashtëm me LPKKI dhe duhet të plotësohet në kuptimin se të dhënat nga Regjistri i Dhuratave Protokollare i dërgohen edhe KSHPK-së, në përputhje me detyrimin që e kanë të gjitha organet/autoritetet shtetërore sipas nenit 58 të LPKKI.

Dispozitat e neneve 88 dhe 89 e rregullojnë procedurën e shkarkimit të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe procedurën e shkarkimit të prokurorit publik. Në alinenë 1 të paragrafit (2), një nga arsyet e shkarkimit është nëse Prokurori Publik Shtetëror, përkatësisht prokurori publik, ka kryer shkelje të rëndë disiplinore në përputhje me nenin 91 të këtij ligji, me ç'rast shkelja është kryer me dashje ose neglizhencë/pakujdesi të dukshme me fajin e prokurorit publik, pa arsye të justifikueshme ndërsa shkelja ka shkaktuar pasoja të rënda. Në këto dispozita, është e nevojshme të sqarohen termat "me dashje ose neglizhencë të dukshme me fajin e". Së këtejmi, përdoret termi "me dashje", i cili haset në teorinë e së drejtës penale dhe bëhet fjalë për një koncept teorik dhe jo për koncept ligjor që mund të lë hapësirë për interpretime subjektive, veçanërisht që nuk është përcaktuar se çfarë nënkupton ligjvënësi me termin "dashje" në këtë rast. Ligjvënësi e dallon veprimin me paramendim, si atë të drejtpërdrejtë ashtu edhe atë eventuale, por dashja si marrëdhënie subjektive e kryerësit është një koncept më shumë teorik dhe nuk ka përkufizim konkret. Termi i dytë të cilin e përdor ligjvënësi është veçanërisht problematik "neglizhencë e dukshme". Edhe ky term nuk është i qartë sepse nga pikëpamja e neglizhencës, teoria juridike njih dy lloje: neglizhencë të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme. Termi "neglizhencë e dukshme" lë hapësirë për interpretim subjektiv dhe nuk përmban parametra kur konsiderohet se shkelja është kryer nga neglizhencia e dukshme dhe nëse kjo ka të bëjë edhe me neglizhencën e vetëdijshme edhe me atë të pavetëdijshme ose forma të caktuara të veprimit neglizhent do të përjashtohen. Nga pikëpamja e pavarësisë së prokurorëve publikë, është veçanërisht e rëndësishme që gjatë sanksionimit të veprimit neglizhent të ketë kritere të qarta që do të garantojnë se rreziqet e abuzimit janë minimizuar gjatë interpretimit të "neglizhencës së dukshme" dhe në këtë mënyrë të ndikohet mbi pavarësinë e prokurorëve publikë gjatë veprimit/ trajtimit. Në këtë kontekst, duhet vlerësuar edhe rrethana se nuk është përcaktuar në cilat raste do të konsiderohet se kanë ndodhur "pasoja të rënda", kështu që për të shmangur dykuptimësinë dhe interpretimin subjektiv, është e nevojshme të parashikohen kritere me të cilat do të vlerësohet se kanë ndodhur "pasoja të rënda" (për shembull: vepra penale është parashkruar dhe ngjashëm.)

Lidhur me procedurën e shkarkimit të prokurorit publik, në nenin 89 të paragrafit (4) përcaktohet se në rast të formës më të lehtë të shkeljes së bazave të paragrafit (1) alinesë 1 të këtij neni, prokurorit publik mund t'i shqiptohet masë disiplinore. Është e nevojshme dispozita të riprecizohet, të përcaktohet termi "formë më e lehtë e shkeljes" dhe të përcaktohen kriteret për vlerësimin e rëndësisë së shkeljes.

Nenet 91 dhe 92 përcaktojnë se çfarë konsiderohet shkelje më e lehtë dhe çfarë shkelje më e rëndë disiplinore, duke përdorur forma më të rënda dhe më të lehta të termave "forma më serioze të sjelljes

së pahijshme”, “forma më të lehta të sjelljes së pahijshme”, “gabim i madh profesional”, “shkelje e rëndë e rendit dhe qetësisë publike” dhe “shkelje më e lehtë e rendit dhe qetësisë publike”. Kushtet e listuara në këtë mënyrë janë të padefinuara. Për më tepër, është e paqartë se cilat situata do të konsiderohen si forma më serioze, dhe cilat si forma më pak serioze të sjelljes së pahijshme, si dhe në cilat situata do të ketë shkelje më të rëndë, dhe në cilat shkelje më të lehtë të rendit dhe qetësisë publike. Në fakt, edhe ajo se çka do të konsiderohet si sjellje e pahijshme nuk përcaktohet, kështu që ekziston një hapësirë e gjerë për interpretim subjektiv që mund të çojë në zbatim të pabarabartë të Ligjit. Së këtejmi, është e nevojshme të përcaktohen elementet dhe parametrat konkret që do të rrisnin objektivitetin dhe do ta zvogëlonin mundësinë e abuzimeve dhe do të mundësonin që gradimi të bëhej në bazë të kritereve objektive. Termi “gabim i madh profesional” gjithashtu nuk është përcaktuar sa duhet.

3.4. Rreziqe në lidhje me mënyrën e përcaktimit të afateve

Me nenin 26 të Ligjit rregullohet se për shkak të vëllimit të rritur të punëve ose për shkak të zvogëlimit të lëndëve të prapambetura të pazgjidhura, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkohësisht mund të transferojë një prokuror publik në një prokurori tjetër publike më së shumti për një periudhë prej një viti. Në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, prokurori publik që është transferuar në një prokurori tjetër publike ka të drejtën e ankimit të aktvendimit për transferim në KPP, me ç'rast vendimi i Këshillit të Prokurorëve Publikë është përfundimtar. Lidhur me ankimin ndaj vendimit për transferim, ligjvënisi nuk ka parashikuar kurrfarë afatesh, përkatësisht nuk ka parashikuar një afat brenda të cilit mund të paraqitet ankimi, madje nuk ka parashikuar as afat brenda të cilit duhet të vendosë Këshilli. Afatet e paprecizuara paraqesin rrezik rregullator për korrupsion.

Paragrafi (5) i nenit 29¹⁰ nuk parashikon një afat brenda të cilit Prokurori Publik Shtetëror, përkatësisht prokurori i lartë publik, merr vendim me shkrim për të ndërmarrë ndjekje penale.

Me dispozitat e nenit 54 rregullohet detyrimi i çdo prokurorie publike të përpilojë raport vjetor për punën e vet. Dispozitat nuk parashikojnë afate për përpilimin e raportit të punës, madje nuk parashikojnë as afate më së voni deri kur raporti mund të paraqitet në prokurorinë më të lartë publike, përkatësisht në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 55 nuk parashikon afate brenda të cilave Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut paraqet raport vjetor në Kuvend, Qeveri, Gjykatën Supreme dhe Ministrinë e Drejtësisë, për punën e të gjitha prokurorive publike dhe për situatën me krimin në vend, madje nuk e parashikon as afatin brenda të cilit Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut një herë në vit paraqet raport për masat e veçanta hetimore në Kuvend me një përmbajtje të përcaktuar me ligj.

¹⁰ Neni 29

(1) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të ndërmarrë ndjekjen penale dhe kryerjen e punëve të caktuara për të cilat është kompetent prokurori i lartë publik ose prokurori themelor publik apo t'i autorizojë të zhvillojnë procedurë për lëndë të caktuara ose të kryejnë punë të caktuara në kompetencë të një prokurori tjetër publik.

(2) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, pa pëlqimin e Prokurorit Themelor Publik të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, nuk mund të ndërmarrë ndjekje penale ose të kryejë punë të caktuara për të cilat është kompetente Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, ose të autorizojë një prokurori tjetër publike të zhvillojë procedurë për lëndë të caktuara apo të kryejë punë të caktuara në kompetencë të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, përveç nëse gjatë mbikëqyrjes sipas nenit 28 paragrafi (3) të këtij ligji konstatohet se funksioni prokurorial nuk ushtrohet në përputhje me afatet e përcaktuara në Ligjin për Procedurë Penale.

(3) Prokurori i lartë publik mund ta ndërmarrë ndjekjen penale dhe kryerjen e punëve të caktuara për të cilat është kompetent prokurori publik në prokurorinë themelore publike nga juridiksioni i asaj prokurorie të lartë publike ose të autorizojë një prokuror publik në një prokurori publike themelore nga juridiksioni i asaj prokurorie publike të lartë të zhvillojë procedurë për lëndë të caktuara ose të kryejë punë të caktuara në kompetencë të prokurorit tjetër themelor publik nga juridiksioni i asaj prokurorie të lartë publike.

(4) Veprimet nga paragrafi (1) dhe (3) të këtij neni mund të ndërmerren vetëm nëse prokurori publik vepron në mënyrë joprofesionale dhe jokompetente, nuk i ndërmerr veprimet e nevojshme për ngritjen dhe zhvillimin e procedurës penale, për shkak të ushtrimit të paligjshëm, jo në kohën e duhur ose të pakujdesshëm të funksionit të prokurorit publik, si dhe për shkak të kërcënimeve ndaj jetës dhe shëndetit të prokurorit publik dhe familjes së tij.

(5) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht prokurori i lartë publik për veprimet nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, miraton vendim me shkrim i cili përmban arsyetim për veprimet e ndërmarrta.

Neni 64 paragrafi (4) i Ligjit përcakton se Qeveria do t'i paraqesë Kuvendit propozim për emërimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga kandidatët e paraqitur për të cilët KPP-ja ka dhënë opinion pozitiv. Për kandidatin e propozuar nga Qeveria për Prokuror Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, propozimit i bashkëngjitet edhe opinionin e KPP-së. Dispozita në fjalë nuk përcakton se në cilin afat Qeveria do t'i paraqesë Kuvendit propozim për zgjedhjen e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Dispozita e paragrafit (4) të nenit 70¹¹ nuk parashikon një afat kohor brenda të cilit mund të paraqitet padia, madje nuk ka as një referencë për ligjet ekzistuese për sa i përket parashkrimit.

Dispozitat e nenit 88 që e përcaktojnë procedurën e shkarkimit të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk parashikojnë afate për asnjë nga fazat e procedurës. Afatet e paparashikuara ose të papërcaktuara paraqesin rrezik rregullator për korrupsion, në përputhje me Metodologjinë e KAL.

Neni 93, i cili e rregullon procedurën e përcaktimit të përgjegjësisë së prokurorëve publikë për shkelje disiplinore të kryer, nuk parashikon afate nga paragrafi (3) deri në paragrafin (10), me përjashtim të afateve në paragrafin (3), por ato janë shprehur në mënyrë joadekuate – “pa shtyrje” nuk është një garanci e mjaftueshme, ndërsa lidhur me afatin prej 5 ditësh pas njoftimit në të cilin prokurori publik ndaj të cilit paraqitet propozimi për iniciimin e procedurës mund të deklarohet me shkrim për pretendimet e propozimit, është e paqartë se kur fillon i njëjti të rrjedhë, nga dita e marrjes së njoftimit ose nga dita e dërgimit të njoftimit.

Në nenin 94 të ligjit rregullohet marrja e vendimit për shkarkimin e prokurorit publik. Dispozitat në fjalë nuk parashikojnë një afat brenda të cilit KPP-ja duhet ta marrë vendimin e tillë.

3.5. Rreziqe duke përcaktuar kritere precize dhe objektive për situata të caktuara

Në përputhje me nenin 14 paragrafin 2 të Ligjit, në PTHP NKOK krijohet Seksion i Specializuar për Ndjekjen e Veprave Penale të Kryera nga Personat me Autorizime Policore dhe Pjesëtarët e Policisë së Burgjeve. Seksioni i Specializuar ka shërbim profesional dhe hetues prokurorial nga Qendra Hetimore në përputhje me këtë ligj. Prokurorët publikë dhe udhëheqësin e Seksionit të Specializuar i sistematizon Prokurori Publik i PTHP NKOK, nga radhët e prokurorëve publikë të asaj prokurorie, sipas pëlqimit paraprak të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo dispozitë nuk ka kritere për vendimmarrje se cilët prokurorë do të sistematizohen në Seksionin e Specializuar për Abuzimet Policore brenda PTHP NKOK. Aktvendimi ligjor nuk përmban kritere shtesë se cilët prokurorë publikë do të caktoheshin për të punuar në këtë seksion, kështu që për të shmangur abuzimet, është e nevojshme të precizohet dispozita me kritere orientuese me të cilat do të udhëhiqej shefi i PTHP NKOK gjatë përgatitjes së orarit dhe sistematizimit të prokurorëve në këtë seksion.

Në përputhje me nenin 15 paragrafin (1), në prokurorinë publike me vëllim më të madh të lëndëve të përafërta, për efikasitet dhe specializim më të mirë të performancës së prokurorisë publike, mund të formohen seksione si njësi të brendshme organizative. Me punën e seksionit udhëheq prokurori publik, i përcaktuar sipas orarit vjetor të punës së prokurorisë publike mbi bazën e një specializimi të ngushtë

¹¹Neni 70

(1) Prokurori publik nuk mund të paraburgoset dhe as të thirret në përgjegjësi për veprimin e ndërmarrë, opinionin e artikuluar dhe vendimin e marrë, përveç nëse gjatë ushtrimit të funksionit të prokurorit publik kryen veprë penale.

(2) Kundër prokurorit publik nuk mund të zhvillohet procedurë për kompensimin e dëmit ose procedurë tjetër nga pjesëmarrësi në procedurë që është i pakënaqur me vendimin e prokurorit publik.

(3) Për dëmin që prokurori publik gjatë ushtrimit të funksionit do t'ua shkaktojë qytetarëve ose subjekteve juridike me punë të paligjshme, përgjegjëse është Republika e Maqedonisë së Veriut.

(4) Kur dëmi nga paragrafi (3) të këtij neni është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e vetëdijshme, për shkak të së cilës prokurori publik është shkarkuar, Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes padisë, mund të kërkojë nga prokurori publik t'ia kthejë shumën e dëmit të paguar nga paragrafi (3) i këtij neni në lartësinë që do ta përcaktojë gjykata.

dhe profesionalizmit të prokurorit publik i cili caktohet si udhëheqës i seksionit. Sa i përket orarit vjetor të punës, në Rregulloren për Punën e Brendshme nuk ka kritere të detajuara në lidhje me caktimin e udhëheqësve, kështu që për të zbatuar ligjin në mënyrë të barabartë, është e nevojshme të përcaktohen kritere të cilat udhëheqësit duhet t'i përmbushin dhe me të cilat udhëheqësit do të dallojnë nga prokurorët e tjerë publikë.

Me nenin 65 rregullohet procedura, parimet dhe ndalimet për/gjatë zgjedhjes së prokurorëve të lartë publikë të prokurorive të larta publike dhe prokurorëve themelorë publikë të prokurorive themelore publike të cilët i zgjedh KPP-ja për një periudhë katërvjeçare, nga radhët e prokurorëve publikë të zgjedhur me të drejtë rizgjedhjeje. Këto dispozita duhet të plotësohen me kritere për zgjedhjen e prokurorit publik të prokurorisë publike, pavarësisht nëse bëhet fjalë për prokurori themelore, të lartë apo për PTHP NKOK. Qëllimi i rekomandimit të dhënë është të kufizojë mundësinë e abuzimeve, por edhe të sigurojë zbatim të drejtë të sistemit të meritës, konkurrencës dhe profesionalizmit gjatë zgjedhjes së prokurorit publik në prokurorinë themelore, të lartë ose PTHP NKOK.

Neni 81 përcakton se prokurori publik largohet nga ushtrimi i funksionit të prokurorit publik në kohën e paraburgimit të tij, si dhe gjatë kohës së procedurës penale kundër tij ose kur është ngritur procedurë disiplinore. Së këtejmi, vendimin për largimin nga ushtrimi i funksionit të prokurorit publik në rastet në fjalë, e merr Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut ndërkaq ai duhet të përmbajë justifikimin e arsyeve të largimit nga ushtrimi i funksionit të prokurorit publik. Këto dispozita nuk parashikojnë kritere shtesë të cilat Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i vlerësojë gjatë vendimarrjes nëse ndonjë prokuror të caktuar do ta largojë nga ushtrimi i funksionit apo jo, ndërkaq nuk është e përcaktuar se sa kohë prokurori mund të jetë i larguar nga ushtrimi i funksionit, duke qenë se procedura penale mund të zgjasë për një kohë shumë të gjatë.

3.6. Rreziqe për shkak të ekzistimit të konfliktit të jashtëm me ligjet e tjera

Në nenin 27¹² ekziston konflikt i brendshëm me dispozitën e nenit 13 të këtij ligji, sepse ndaj ankimit të vendimeve të PTHP NKOK vepron Prokuroria e Lartë Publike Shkup, kurse përgjegjësinë për punë këta prokurorë e kanë vetëm para Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe para shefit të PTHP NKOK- për shkak të autonomisë së rritur në veprim. Kjo çështje përbën një rrezik të veçantë për korrupsion, veçanërisht pasi disa nga prokurorët në Prokurorinë e Lartë Publike Shkup nuk kanë punuar kurrë dhe nuk kanë përvojë në trajtimin e lëndëve në PTHP NKOK, kështu që ata nuk mund t'i përgjigjen në mënyrë adekuate kompleksitetit dhe senzibilitetit që e bartin këto lëndë. Praktika tregon një numër të madh ankimesh që nuk janë mbështetur nga prokurorët e lartë, ndërsa kemi edhe situata të ankimeve dhe akuzave të revokuara që vë në dukje ndërhyrjen në punën e PTHP NKOK, ndërkaq kjo përbën një rrezik të veçantë për korrupsion. Prandaj, është e nevojshme të inkorporohen mekanizma parandalues, madje në pjesën e pamundësisë së revokimit të ankimeve dhe akuzave, në drejtim të lënies së hapësirës që pretendimet ankimore të PTHP NKOK t'i shqyrtojë Gjykata e Apelit.

¹² Neni 27

(1) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut është përgjegjës për situatën e përgjithshme në lidhje me organizimin dhe ushtrimin e funksioneve prokuroriale ndërsa për punën e tij dhe punën e prokurorisë publike, përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Prokurorët publikë në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për punën e tyre përgjigjen para Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe para Këshillit të Prokurorëve Publikë.

(3) Prokurori i lartë publik për punën e tij përgjigjet para Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit të Prokurorëve Publik, ndërsa prokurorët publik në prokurorinë e lartë publike për punën e tyre përgjigjen para Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokurorit të lartë publik dhe para Këshillit të Prokurorëve Publik.

(4) Prokurori Themelor Publik i Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit për punën e tij përgjigjet para Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe para Këshillit të Prokurorëve Publikë, ndërsa prokurorët publikë në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit për punën e tyre përgjigjen para Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokurorit publik të asaj prokurorie publike dhe para Këshillit të Prokurorëve Publikë.

(5) Prokurori themelor publik për punën e tij përgjigjet para Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokurorit të lartë publik dhe para Këshillit të Prokurorëve Publik, ndërsa prokurorët publik në prokurorinë themelore publike për punën e tyre përgjigjen para Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokurorit të lartë publik dhe para Këshillit të Prokurorëve Publik.

Neni 32 i Ligjit në mënyrë taksative i specifikon veprat penale për të cilat PTHP NKOK është kompetente të veprojë në shkallë të parë. Ndërkohë, kompetencat e PTHP NKOK janë në konflikt të jashtëm me LGJ, prandaj nevojitet të përcaktohet kompetenca sipas objektit të mbrojtjes, në mënyrë që të shmangen mospërputhjet dhe ndryshimet në ligjin material. Nga ana tjetër, në mënyrë që të shmanget konflikti fillestar i kompetencës dhe qartësisë më të madhe, duhet që punët të definohen dhe në cilën fazë çfarë dyshimi ekziston, sepse ekziston një situatë në praktikë kur fillimisht ka indikacione për grup, por PTHP NKOK nuk vepron sepse nuk ka prova ose ka indicie për pastrimin e parave, por nuk i kontrollon derisa prokuroritë themelore publike të paraqesin informacione pas kontrolleve fillestare, gjë që e zvarrit procedurën dhe si e tillë paraqet rrezik për korrupsion. Për më tepër, është e përshtatshme të rregullohet kompetenca e PTHP NKOK kur ka indicie për lloje të veprave të kryera konkrete penale.

Neni 58¹³ është në kolizion me Ligjin për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Materien Penale, si dhe me një pjesë të marrëveshjeve bilaterale për bashkëpunimin ndërkombëtar, sipas të cilave prokuroritë drejtohen drejtpërdrejt për ndihmë juridike ndërkombëtare. Është e nevojshme të njëjtat të rishikohen në mënyrë që të përcaktohet se në kuadër të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të formohet një seksion për koordinimin e lëndëve të ndihmës ndërkombëtare juridike, ndërkaq ky seksion të mos jetë i vetmi organ kompetent për procedurat e ndihmës ndërkombëtare juridike. Është e nevojshme të precizohet kjo dispozitë që të mos jetë në kolizion me Ligjin për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Materien Penale ose vetëm të precizohet se nuk i referohet Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut si pjesë e hierarkisë, por Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut si institucion.

Në nenin 82 paragrafin 3 të këtij ligji, përcaktohet se Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokurori i lartë publik i prokurorisë së lartë publike, Prokurori Themelor Publik i PTHP NKOK dhe prokurori themelor publik i prokurorisë themelore publike, mundet prokurorin publik ose punonjësit e shërbimit profesional të prokurorisë publike t'i lirojë nga detyrimi për ruajtjen informacionit të klasifikuar me shkallë përkatëse të sekretit të përcaktuar në përputhje me Ligjin. Kjo dispozitë është në konflikt të jashtëm me Ligjin për Informacione të Klasifikuar në pjesën e lirit nga detyrimi për ruajtjen e informacionit të klasifikuar, prandaj është i nevojshëm harmonizimi i dy ligjeve.

Dispozitat e nenit 107 parashikojnë instalimin e sistemit të informacionit në prokuroritë publike, si pjesë e qendrës së vetme të informacionit me një bazë të dhënash për autoritetet e sistemit të drejtësisë në vend. Ky nen është në konflikt të jashtëm me LGJ, është plotësisht i paqartë për shkak të dispozitave konfuze dhe të paspecifikuara, prandaj është e nevojshme në detaje të rishikohen dhe harmonizohen me LGJ. Njëherësh, është e nevojshme të rregullohen në detaje detyrimet për mbikëqyrje mbi shpërndarjen e lëndëve dhe përdorimin e sistemit si një mekanizëm mbrojtës kundër abuzimeve.

Neni 110¹⁴ parashikon dispozita të natyrës procedurale, gjë që nuk është përkatëse, ndërkaq është në kolizion me Ligjin për Procedurë Penale dhe njëherësh paraqet rrezik për korrupsion.

¹³ Neni 58

(1) Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Materien Penale, realizon bashkëpunim të drejtpërdrejtë me prokuroritë publike dhe autoritetet e tjera kompetente nga vendet e tjera, veçanërisht në planin e parandalimit dhe ndjekjes të krimit të organizuar dhe formave të tjera të rënda të krimit përmes shkëmbimit të drejtpërdrejtë të të dhënave, bashkëpunimit të drejtpërdrejtë, edukimit, specializimit të kuadrove dhe formave të tjera të bashkëpunimit.

(2) Prokurori Themelor Publik i Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit do të kërkojë ndihmë juridike dhe bashkëpunim ndërkombëtar për çështje brenda kompetencës së tij në mënyrë të pavarur, në përputhje me ligjin dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Mënyrën e propozimit, shkëmbimit dhe referimit/transferimit të prokurorit publik në institucione, agjenci, autoritete ose zyra të Bashkimit Evropian ose në organizata, institucione, organe, misione dhe projekte të tjera ndërkombëtare me Rregulloren e përcakton Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

¹⁴ Neni 110

(1) Prokuroria Publike nuk mund ta mbështesë akuzën në bazë të materialeve të përgjuara në mënyrë të paligjshme.

4. Analiza e dispozitave të Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe një pjese të akteve nënligjore dhe të përgjithshme që rezultojnë nga Ligji për Këshillin e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Titulli: Ligji për Këshillin e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 150/2007 dhe 100/2011 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 42/2020).

Shqyrtimi i kërkesës: Me këtë ligj rregullohet kompetenca, përbërja dhe struktura e KPP-së (në tekstin në vijim: Këshilli), mandati i anëtarëve të tij, bazat dhe procedura e pushimit dhe shkarkimit të anëtarit të Këshillit, si dhe bazat dhe procedura e zgjedhjes, pushimit dhe shkarkimit të prokurorëve publikë dhe çështje të tjera në lidhje me punën e Këshillit. KPP-ja ka si qëllim kryesor sigurimin e pavarësisë dhe autonomisë së Prokurorisë Publike.

Materialet e shqyrtuara/ konsultuara:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. LPKKI ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr.12/2019
3. Rregullorja për Formën dhe Përbajtjen e Formularit dhe Procedurës për Lëshimin dhe Heqjen e Legjitimacionit të Prokurorëve Publikë dhe Anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.6/2021)
4. Rregullorja e Punës së Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 118/2021)
5. LAGJPP ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.129/2023 dhe 53/2024)
6. Kodi Penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014, 196/2015, 226/2015, 97/2017 dhe 248/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 36/2023 dhe 188/2023)
7. Ligji për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Materien Penale (*) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.77/2021)
8. LPP ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2010, 100/2012, 142/2016 dhe 198/2018)

KONKLUZION

(2) Përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni janë lëndët e Prokurorisë Publike për Ndjekjen Penale të Veprave Penale që Lidhen dhe Rezultojnë nga Përbajtja e Paligjshme e Ndjekjes të Komunikimeve të Paraqitura në një Gjykatë Kompetente deri më datë 30 qershor 2017 në përputhje me Ligjin për Prokurorinë Publike për Ndjekjen e Veprave Penale që Lidhen dhe Rezultojnë nga Përbajtja e Paligjshme e Ndjekjes të Komunikimeve.

(3) Materialet dhe transkriptet nga materialet e përgjuara në mënyrë të paligjshme për lëndët e ngritura pas 30 qershorit 2017 mund të përdoren vetëm si indikacione dhe asnjë aktakuzë ose propozim akuzë nuk mund të bazohet në to dhe ato nuk mund të propozohen dhe përdoren si prova në procedurën e aktakuzës ose propozim akuzës së paraqitur.

(4) Materialet nga paragrafi (3) të këtij neni shkatërrohen brenda tre muajve pas përfundimit të procedurave sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike të lëndëve nga paragrafi (3) të këtij neni në përputhje me dispozitat për shkatërrimin e materialeve nga masat e posaçme hetimore të përcaktuara me ligj. Procesverbalet e shkatërrimit i dërgohen Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Të gjitha materialet dhe transkriptet e tjera të materialeve të përgjuara në mënyrë të paligjshme, të cilat nuk janë dorëzuar si prova në gjykata dhe që nuk janë pjesë e lëndëve që janë në fazën hetimore në përputhje me paragrafin(3) të këtij neni, nuk mund të dëgjohen përsëri dhe të përdoren në ndonjë procedurë ndërkaq shkatërrohen brenda tre muajve pas përfundimit të procedurave, sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike, të lëndëve nga paragrafi (2) të këtij neni, në përputhje me dispozitat për shkatërrimin e materialeve të masave të posaçme hetimore të përcaktuara me ligj. Procesverbalet e shkatërrimit i dërgohen Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas analizës së kryer të LKPP, të akteve nënligjore dhe akteve të përgjithshme që rezultojnë prej tij, u identifikuan mangësi që mund të prodhojnë rreziqe për korrupsion. Mangësitë mund të kategorizohen në kategoritë si vijon:

- 4.1. Rreziqe në lidhje me rregullimin më të detajuar të procedurave të caktuara në lidhje me përdorimin e autorizimeve diskrecionale
- 4.2. Rreziqe nga aspekti i procedurave të rregulluara në mënyrë të pamjaftueshme ose procedurave të parregullta
- 4.3. Rreziqe në lidhje me përdorimin e termave pamjaftueshëm të qartë dhe pamjaftueshëm të përcaktuar
- 4.4. Rreziqe në lidhje me mënyrën e përcaktimit të afateve
- 4.5. Rreziqe për shkak të ekzistencës së konfliktit të jashtëm me ligjet e tjera

Vërejtja e përgjithshme ka të bëjë ma atë se në tekstin e ligjit përdoren fjalë përshkruese për të përcaktuar afatet si “menjëherë”, gjë që duhet të shmanget dhe paraqet rrezik për zbatim të pabarabartë të ligjit. Megjithatë, ajo që lë përshtypjen më të madhe është mosharmonizimi i këtij ligji me një numër të madh ligjesh, kështu që ndërhyrja urgjente në tekstin e ligjit është më se e nevojshme.

4.1 Rreziqe në lidhje me rregullimin më të detajuar të procedurave të caktuara në lidhje me përdorimin e autorizimeve diskrecionale

Neni 10-b e përcakton procedurën për përjashtimin e anëtarit të Këshillit në procedurat në të cilat vendoset për prokurorin publik ose kandidatin për prokuror publik me të cilin është në bashkësi martesore ose jashtëmartesore; lidhje familjare e linjës së drejtë në çdo shkallë, dhe linjës anësore deri në shkallën e katërt; lidhje familjare sipas martesës/krushqisë deri në shkallën e dytë dhe marrëdhënia e të birësuarit apo birësuesit ose personit me të cilin jeton në bashkësinë e njëjtë familjare. Në përputhje me paragrafin (3) të nenit në fjalë, anëtari i Këshillit është i detyruar menjëherë ta ndërpresë punën e tij në procedurat në kompetencë të Këshillit në momentin e vënies në dijeni për ekzistimin e arsyeve në paragrafin (1) të këtij neni dhe për këtë duhet ta njoftojë Këshillin. Me paragrafin (5) përcaktohet nëse anëtari i Këshillit nuk vepron në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni, atëherë ndaj tij mund të ngrihet procedurë disiplinore. Në dispozitat në fjalë, zhvillimi i procedurës disiplinore kundër anëtarit të Këshillit që nuk është përjashtuar, lihet në dispozicion, përkatësisht lihet hapësirë për vendimmarrje diskrecionale, edhe pse anëtari e ka shkelur ndalimin për përjashtim, që përbën bazë për shkarkimin nga funksioni. Së këtejmi, në dispozitat ka dykuptimësi dhe paqartësi, përkatësisht nuk është e qartë në cilin rast me siguri do të ngrihet procedurë disiplinore kundër anëtarit të Këshillit.

4.2. Rreziqe nga aspekti i procedurave të rregulluara në mënyrë të pamjaftueshme ose procedurave të parregullta

Në përputhje me nenin 3 paragrafin (3) të këtij ligji, Këshilli me punën e tij e pamundëson çdo lloj të ndikimit në Prokurorinë Publike në kundërshtim me ligjin. Në dispozitën nuk ka kritere dhe garanci shtesë në mënyrë që Këshilli në praktikë të pamundësojë çdo lloj të ndikimit, përkatësisht ekziston një procedurë pamjaftueshëm e rregulluar. Nga aspekti komparativ, në rajonin tonë, përkatësisht në Serbi, anëtari i Këshillit është i ngarkuari me punë për pavarësinë ndërkaq prokurorët publikë i drejtohen atij me shkrim ose me gojë për ndikime të mundshme, pastaj ai merr vendime gjatë gjithë procedurës së parashikuar. Paragrafi (4) i këtij neni përcakton se funksioni anëtar i zgjedhur i Këshillit është i papajtueshëm me anëtarësinë në një parti politike ose me ushtrimin e një funksioni dhe profesioni tjetër publik. Përveç kësaj, papajtueshmëria vetëm me anëtarësimin në një parti politike është një garanci e pamjaftueshme dhe rrezik potencial për korrupsion sepse ekziston mundësia që anëtari i Këshillit të

mos jetë anëtar i një partie politike, por të kryejë aktivitete partiake ose të ketë funksione partiake dhe politike.

Në nenin 8, paragrafin 2, të Ligjit përcaktohet se Kryetari i Këshillit zgjidhet nga anëtarët e Këshillit, nga radhët e prokurorëve publikë të zgjedhur, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me votim të fshehtë. Nëse e marrim para sysh se konform nenit 11 të këtij ligji, anëtarët e Këshillit në ushtrimin e funksionit anëtar i Këshillit kanë të drejta dhe detyrime të barabarta, me analizën e dispozitës së nenit 8 paragrafit (2) hapet dilema nëse me të njëjtën cenohet barazia e garantuar me nenin 11? Në këtë drejtim është edhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese U.nr.233/2020 nga data 07.03.2023, me të cilin është shfuqizuar një pjesë e dispozitës së LKGJ-së në pjesën ku Kryetari i Këshillit mund të ishte vetëm anëtar i zgjedhur nga Kuvendi. Për më tepër, votimi i fshehtë bart rrezik për korrupsion, kështu që nuk është e qartë pse Kryetari i Këshillit do të zgjidhej me votim të fshehtë.

Dispozitat e nenit 10 të këtij ligji përcaktojnë se punët në kompetencë të tij Këshilli i shqyrton dhe për të njëjtat vendos në seancë. Në përputhje me paragrafin (5) të këtij neni, Këshilli vendos me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, përveç nëse me LPP-në nuk parashikohet ndryshe. Dispozita në fjalë nuk ka një procedurë të përcaktuar plotësisht, përkatësisht nuk është e përcaktuar se si Këshilli vendos gjatë zbatimit të votimit, përkatësisht a voton me “pro” apo “kundër”, a mund të votojë me “abstenim”, pastaj votimi a është publik, cila pjesë e votimit është e fshehtë dhe në cilin rast, etj. Kjo është një çështje e rëndësishme që krijon shumë dilema dhe diskutime në praktikë.

Neni 10-a¹⁵ nuk parashikon mekanizma parandalues siç është rasti me LKGJ-në, përkatësisht nuk është parashikuar mundësia, me kërkesë të prokurorit publik, seanca të jetë publike dhe të mos përjashtohet publiku. Është e nevojshme të përcaktohen procedurat kur mund të përjashtohet publiku, gjatë shkarkimit të prokurorit publik, gjatë zbatimit të procedurave disiplinore, gjatë shqyrtimit të parashtrësive, etj. Ndërkohë, nuk është përcaktuar përmbajtja e procesverbalit për votim, të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, përkatësisht nuk është rregulluar nëse duhet ta përmbajë edhe diskutimin që është zhvilluar dhe cili anëtar i Këshillit si ka votuar, a përmban vetëm të dhëna të përmbledhura për rezultatin e përgjithshëm të votimit dhe vërejtjet e përgjithshme nga diskutimi, etj., gjë që lë hapësirë për interpretim subjektiv dhe zbatim të pabarabartë të kësaj dispozite.

Neni 12 përcakton se Këshilli e miraton Rregulloren e Punës me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, me të cilën e rregullohet procedura dhe mënyra e punës së Këshillit dhe çështje të tjera në kompetencë të Këshillit. Dispozita në fjalë vetvetiu është e konfuze, pasi nuk është e qartë se cila procedurë rregullohet me Rregulloren e Punës dhe cilat çështje të tjera, gjë që lë hapësirë për interpretim të pabarabartë dhe abuzime gjatë zbatimit të dispozitës.

Neni 13 i Ligjit e përcakton detyrimin e Këshillit për punën e tij të paraqesë raport vjetor në Kuvend. Neni në fjalë nuk parashikon procedurë para Kuvendit lidhur me raportin vjetor të Këshillit, në kuptimin nëse Kuvendi e miraton ose jo raportin, pastaj çfarë nënkupton vendimi i Kuvendit në lidhje me raportin, nëse i njëjti është bazë për iniciimin e procedurave për përgjegjësinë e anëtarëve të Këshillit të zgjedhur nga Kuvendi, etj. Lidhur me përmbajtjen e raportit, është përcaktuar se i njëjti përmban të dhëna edhe

¹⁵ Neni 10-a

(1) Seancat e Këshillit janë publike.

(2) Publiku mund të përjashtohet vetëm me vendim të Këshillit për shkak të mbrojtjes së reputacionit dhe integritetit të prokurorit publik. Për përjashtimin e publikut nga seancat, Këshilli vendos me dy të tretën e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(3) Në rast se Këshilli ka vendosur për përjashtimin e publikut nga seanca, Kryetari i Këshillit është i detyruar ta informojë publikun për arsyet e përjashtimit të publikut dhe në rast se në të njëjtën seancë merr vendim me votim, votimi për vendimin është publik.

(4) Kur Këshilli vendos për zgjedhjen e prokurorit publik të prokurorisë publike ose për zgjedhjen e prokurorit publik në prokurorinë publike, publiku nuk mund të përjashtohet në asnjë rast.

(5) Këshilli harton Procesverbal për votimin e vendimit të paragrafit (4) të këtij neni dhe e publikon atë në faqen e internetit të Këshillit.

(6) Për punën e seancës së Këshillit mbahet Procesverbal ndërsa seanca regjistrohet audio ose bëhet regjistrimi audio-vizual. Procesverbali i miratuar publikohet në faqen e internetit të Këshillit.

për gjendjen kadrovike në Prokurorinë Publike si dhe për gjendjen materiale - financiare në Prokurorinë Publike, çështje të cilat nuk janë në kompetencë të Këshillit dhe për të cilat Këshilli nuk posedon të dhëna.

Në përputhje me nenin 14, Kryetari i Këshillit, brenda 60 ditëve para skadimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit, është i detyruar të miratojë aktvendim për shpalljen e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga radhët e prokurorëve publikë, të publikojë shpallje për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit nga radhët e prokurorëve publikë, ta njoftojë Kryetarin e Kuvendit dhe të publikojë shpallje për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të cilët i zgjedh Kuvendi. Në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, në rast të pushimit të parakohshëm të mandatit nga neni 7 i këtij ligji, Kryetari i Këshillit do të veprojë në përputhje me sa më sipër brenda 15 ditëve pas pushimit të mandatit të anëtarit të Këshillit. Dispozitat në fjalë nuk parashikojnë mekanizma parandalues se cilat janë pasojat dhe si të tejkalohet mosveprimi ndaj dispozitës së paragrafit (2) dhe publikimi jo në kohë të shpalljes për anëtar të Këshillit.

Neni 16 i Ligjit i përcakton kushtet për anëtarin e Këshillit nga radhët e prokurorëve publikë, të cilat prokurori publik i cili aktualisht e ushtron funksionin e prokurorit publik duhet t'i plotësojë si më poshtë: të ketë të paktën dhjetë vjet përvojë pune si prokuror publik, në dy vitet e fundit të mos i jetë shqiptuar masa disiplinore dhe të ketë notë pozitive në ushtrimin e funksionit të prokurorit publik në përputhje me ligjin. Afati në dy vitet e fundit të mos i është shqiptuar masa disiplinore është shumë i shkurtër dhe duhet të jetë më i gjatë, veçanërisht nëse e marrim parasysh se vlerësimi/notimi i rregullt i prokurorëve publikë bëhet në 4 vjet, prandaj në përputhje me dispozitën në fjalë, nuk do të ketë hapësirë të shihet nëse prokurori të cilit i është shqiptuar masa disiplinore është përmirësuar apo jo.

Në nenin 17 përcaktohet se kandidatët për anëtarë të Këshillit kandidaturën e tyre e paraqesin me shkrim në Këshill ndërsa aplikacionit ia bashkëngjisin vërtetimin e përvojës së punës si prokuror publik, vërtetimin se në dy vitet e fundit nuk i është shqiptuar masa disiplinore, të dhënat biografike për zhvillimin profesional, të dhënat për pjesëmarrjen në edukimin profesional, të lëshuara nga Akademia për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë dhe deklaratën për cilën listë aplikon. Ky nen duhet të plotësohet edhe me dokumentacionin për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe jo vetëm të kushteve të veçanta. Përveç kësaj, mungojnë mekanizma parandalues se çka nëse të dhënat për pjesëmarrjen në trajnime nuk i dërgohen në kohën e duhur prokurorit publik, ndërsa ai i ka kërkuar ato brenda afatit të parashikuar.

Neni 18 e përcakton formimin dhe veprimin e Komisionit tre anëtarësh për përgatitjen e listave të kandidatëve, të cilin Këshilli e formon nga radhët e anëtarëve të tij. Në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni, Komisioni me aktvendim do ta refuzojë kandidaturën e prokurorit publik si anëtar i Këshillit, nëse nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji ose nëse paraqet të dhëna joadekuate dhe të pasakta, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji. Kundër aktvendimit të Komisionit, prokurori publik ka të drejtë të paraqesë padi për iniciimin e kontestit administrativ në gjykatën kompetente brenda 24 orëve nga dita e marrjes së aktvendimit. Në përputhje me paragrafin (6) të këtij neni, gjykata vendos për padinë brenda 48 orëve nga dita e marrjes së saj. Nga dispozita në fjalë e paragrafit (6), nuk është e qartë nëse vendimi i Gjykatës Administrative është përfundimtar, a ka të drejtë ankimi në lidhje me të njëjtin dhe brenda cilave afate do të veprohet në procedurën ankimore. Për më tepër, paragrafi (7) i këtij neni përcakton se Komisioni do t'i publikojë listat e kandidatëve përmes mediave më së voni 21 ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve. Nga ana tjetër, nuk është e qartë se si listat e kandidatëve do të publikoheshin përmes mediave, përkatësisht kjo zgjidhje ligjore është e papërshtatshme dhe nuk mundëson transparencë të mjaftueshme dhe të plotë të procedurës për përcaktimin e listave të kandidatëve.

Dispozitat e nenit 19 përcaktojnë se Këshilli nga përbërja e tij e formon Komisionin për zbatimin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga radhët e prokurorëve publikë, i cili përbëhet nga kryetari, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre, i cili ka për detyrë ta përgatisë materialin zgjedhor, t'i formojë këshillat zgjedhorë dhe t'i zbatojë zgjedhjet. Ligjvënësi nuk e ka përcaktuar procedurën dhe mënyrën e zgjedhjes së kryetarit, anëtarëve dhe zëvendësve të tyre në Komisionin për zgjedhe, përkatësisht nëse e njëjta bëhet përmes shortit, apo sipas një radhitjeje të caktuar, madje nuk është rregulluar as mënyra e përcaktimit të këtij komisioni. Mungojnë edhe dispozitat se kush nuk mund të jetë anëtar i Komisionit apo kryetar i tij.

Neni 20¹⁶ nuk parashikon një mekanizëm parandalues për situatën kur Kryetari i Këshillit nuk do të vendos për korrigjimin e të dhënave. Edhe në këtë nen nuk është e specifikuar nëse vendimi i Gjykatës Administrative nga paragrafi (6) është përfundimtar, a ka të drejtë ankimi dhe brenda cilave afate do të veprohej në procedurën ankimore.

Në përputhje me nenin 27 të këtij ligji, fletëvotimi është i pavlefshëm nëse nuk është plotësuar ose nëse ka numër më të madh të kandidatëve të rrethuar se numri që zgjidhet sipas njësisë zgjedhore. Në këtë mënyrë, ligjvënësi nuk arriti të përcaktojë se çfarë është fletëvotimi i vlefshëm, së këtejmi është e paqartë se në cilin rast fleta e votimit do të konsiderohet e pavlefshme kështu që lë hapësirë për abuzime gjatë zbatimit të kësaj dispozite.

Dispozitat e nenit 28 e përcaktojnë rezultatit e zgjedhjeve. Për më tepër, nevojitet të përcaktohet cenzusi për dalje dhe lloji i shumicës nga numri i përgjithshëm i të regjistruarve ose prej atyre që kanë dalë në mënyrë që të konsiderohet se zgjedhja është kryer.

Nenet 30 dhe 31 të këtij ligji i rregullojnë procedurat për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes dhe të zgjidhet, përkatësisht të drejtën e tyre të kundërshtimit në Komisionin Zgjedhor brenda 5 orëve pas përfundimit të votimit, përkatësisht pas shpalljes së rezultateve, mbi këtë kundërshtim Komisioni duhet të marrë vendim brenda 12 orëve pas marrjes së tij. Në përputhje me paragrafin (3) dhe (4) të këtyre dy neneve, kundër vendimit të Komisionit Zgjedhor mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ para një gjykate kompetente brenda 12 orëve nga marrja e vendimit, për të cilën gjykata vendos brenda 48 orëve nga dita e marrjes së saj. Edhe në këto dispozita ligjvënësi nuk e ka precizuar nëse vendimi i Gjykatës Administrative është përfundimtar, a ka të drejtë ankimi dhe brenda cilave afate që do të veprohej në procedurën e ankimit.

Neni 32¹⁷ paragrafi (1) nuk e përcakton se sa vite përvojë pune duhet të ketë kandidati pasi që ta kalojë provimin e jurisprudencës madje nuk është e qartë edhe se si vlerësohet kriteri “i dalluar”. Përveç kësaj,

¹⁶ Neni 20

(1) Regjistrin zgjedhor të prokurorëve publikë e administron Këshilli, në të cilin janë përfshirë të dhënat për:

- emrin dhe mbiemrin e prokurorit publik,
- numrin e vetëm të amzës,
- prokurorinë publike në të cilën e ushtron funksionin,
- përvojën e përgjithshme të punës si prokuror publik,
- përkatësinë kombëtare,
- numrin e legjitimacionit zyrtar,
- vendi për shënim dhe
- vendi për nënshkrim.

(2) Më së voni pesë ditë pas shpalljes së zgjedhjeve, Këshilli ua dërgon Regjistrin Zgjedhor të Prokurorëve Publikë të gjitha prokurorëve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(3) Regjistri Zgjedhor i Prokurorëve Publikë vendoset për këqyrje në prokurorinë publike dhe është i aksesshëm për çdo prokuror publik i cili brenda tre ditëve ka të drejtë të kërkojë korrigjimin e të dhënave me shkrim.

(4) Kryetari i Këshillit, brenda tre ditëve nga marrja e kërkesës së paragrafit (3) të këtij neni, vendos me aktvendim.

(5) Kundër aktvendimit të paragrafit (4) të këtij neni, prokurori publik ka të drejtë të paraqesë padi për iniciimin e kontestit administrativ në gjykatën kompetente brenda 24 orëve nga dita e marrjes së aktvendimit.

(6) Ndaj padisë së paragrafit (6) të këtij neni, gjykata vendos brenda 48 orëve nga dita e marrjes së saj.

(7) Këshilli, më së voni brenda 20 ditëve nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, e mbyll Regjistrin Zgjedhor të Prokurorëve Publikë.

¹⁷ Neni 32

(1) Për anëtar të Këshillit të cilin e zgjedh Kuvendi mund të zgjidhet personi që i përmbush kushtet s vijojnë:

mungojnë kritere për vlerësimin e padenjësisë të përcaktuar në kushtin e alinesë 3 të paragrafit (1) të këtij neni, përkatësisht nuk është e qartë se kur një person nuk është i denjë dhe nëse vetë shqiptimi i dënimit me burg të pakushtëzuar sipas përkufizimit nuk e bën të padenjë kandidatin për këtë funksion. Avokatët, kur janë në funksione vendimmarrëse në sistemin e drejtësisë, gjithmonë bartin rreziqe për korrupsion si në aspektin e bazës së përjashtimit për shkak të përfshirjes së tyre në lëndë ashtu edhe në aspektin e bazës së ndikimit.

Neni 33 e përcakton deklaratën solemne të cilën anëtarët e zgjedhur të Këshillit dhe anëtarët sipas funksionit, e bëjnë para Kryetarit të Kuvendit. Ndërkohë, nuk është përcaktuar karakteri i deklaratës, përkatësisht nëse e njëjta është konstituive, që do të thotë se që nga ai moment, anëtarët e zgjedhur të Këshillit do të konsiderohen persona të zgjedhur në përputhje me LPKKI, ose deklarata është vetëm e karakterit deklarativ. Duke i marrë parasysh detyrimet e personave të zgjedhur dhe të emëruar të përcaktuara në LPKKI, nevojitet të përcaktohet momenti kur fillon funksioni i anëtarit të Këshillit. Nga ana tjetër, në dispozitat në fjalë nuk është përcaktuar se brenda cilit afat anëtari sipas funksionit e bën deklaratën solemne dhe prej kur konsiderohet se është anëtar i Këshillit, përkatësisht prej momentit kur e zgjedh Kuvendi si anëtar të Këshillit sipas funksionit ose prej momentit të dhënies së betimit para KPP-së.

Paragrafi (1) i nenit 35-b parashikon që një kërkesë e arsyetuar për ngritjen e procedurës për përgjegjësi disiplinore të anëtarit të Këshillit, së bashku me provat mbi të cilat bazohet kërkesa, mund t'i paraqitet Këshillit nga të paktën 20 prokurorë publikë ose të paktën një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, nëse anëtari i Këshillit ndikon mbi pavarësinë e prokurorëve publikë në vendimmarrjen për raste specifike, nëse e neglizhon dhe nuk e ushtron funksionin e tij në punën e Këshillit, nëse refuzon të paraqesë deklaratë për gjendjen pasurore dhe interesat në përputhje me ligjin ose nëse të dhënat e përfshira në deklaratë janë kryesisht të pavërteta ose nëse i shkel rregullat e përjashtimit në situata në të cilat anëtari i Këshillit ka qenë në dijeni ose duhej të ishte në dijeni për ekzistimin e ndonjë prej bazave për përjashtimet e parashikuara me këtë ligj. Për më tepër, pragu prej 20 prokurorëve për ngritjen e procedurës për përgjegjësinë e anëtarit të Këshillit është shumë i lartë dhe duhet të zvogëlohet në mënyrë që të rritet llogaridhënia dhe përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit para konstituentëve të tyre.

Në përputhje me nenin 37, Këshilli zgjedh prokuror publik në Prokurorinë Themelore Publike të rankuar sipas suksesit të arritur në listën e kandidatëve të paraqitur në AGJPP, të cilët janë paraqitur në shpalljen, sipas vitit të përfundimit të trajnimit. Nëse kandidati nuk paraqitet në tre shpallje të njëpasnjëshme për zgjedhjen e prokurorit publik, e humbet prioritetin e përcaktuar nga lista e kandidatëve të AGJPP-së. Në këto dispozita, ligjvënësi nuk ka parashikuar mekanizma parandalues që do ta detyronin Këshillin t'i përmbahet rankimit, kështu që nuk është e pazakontë në praktikë të gjesh anashkalimin e saj pa justifikimin e duhur për veprimin e tillë të Këshillit.

Me nenin 38 të Ligjit përcaktohet zgjedhja e prokurorëve publikë në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në prokuroritë e larta publike, dhe në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit. Në dispozitat e këtij neni nuk është trajtuar

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

- jurist i diplomuar me të paktën 15 vjet përvojë pune në profesionin juridik me provimin e dhënë të jurisprudencës, i cili në ushtrimin e profesionit juridik është dalluar me punën shkencore ose profesionale apo me veprimin e tij publik; dhe

- të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për veprën penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe, autorizimit në ushtrimin e funksionit ose ndonjë veprë tjetër penale me burgim të pakushtëzuar prej së paku gjashtë muaj, që e bën të padenjë ta ushtrojë funksionin anëtar i Këshillit.

(2) Anëtarët e Këshillit të cilët i zgjedh Kuvendi janë nga radhët e profesorëve universitarë të drejtësisë, avokatë, ish-gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarë ndërkombëtarë dhe juristë të tjerë të dalluar, prej të cilëve dy janë pjesëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(3) Seanca e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilën zgjidhen anëtarët nga paragrafi (1) të këtij është urgjente dhe mbahet brenda një afati prej më së shumti 30 ditësh nga dita e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të zgjedhur nga prokurorët publikë.

procedura e zgjedhjes për sa i përket mënyrës së përcaktuar të vlerësimit të kriterëve dhe pikëzimit të tyre, veçanërisht për kandidatët që vijnë jashtë radhëve të prokurorëve publikë.

Në përputhje me nenin 41, kur Këshilli zgjedh prokurorë publikë në PTHP NKOK, prokuror themelor publik ose prokuror publik në Prokurorinë Themelore Publike të themeluar për rajonin e dy ose më shumë gjykatave, të paktën një gjykatë e nga të cilat është e vendosur në rajonin e njësive të vetëqeverisjes lokale në të cilat, përveç gjuhës maqedonase, gjuhë tjetër zyrtare është edhe gjuha të cilën e flasin të paktën 20% e qytetarëve që jetojnë në rajonin e atyre njësive të vetëqeverisjes lokale dhe prokuror të lartë publik ose prokurorë publikë në atë prokurori të vendosur në rajonin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, vendos në përputhje me nenin 39 të këtij ligji, me ç'rast duhet të ketë shumicë votash të anëtarëve të pranishëm që u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në vend. Në nenin në fjalë nuk janë parashikuar mekanizma parandalues që do ta parandalonin abuzimin e kësaj procedure gjatë zgjedhjes së prokurorëve publikë (për shembull: të mos ketë shumicë dhe të mos bëhet zgjedhja ose të shtyhen zgjedhjet vetëm për shkak të kësaj rrethane), sepse praktika ka treguar shembuj të abuzimit të këtij autorizimi.

Neni 42 përcakton se nëse asnjë nga kandidatët e paraqitur për prokuror publik nuk i plotëson kushtet e parashikuara ose nuk është zgjedhur, procedura e zgjedhjes përsëritet menjëherë. Edhe në këtë rast, nuk është parashikuar mekanizëm se si të shmangen situatat kur më shumë kandidatë i plotësojnë kushtet, kurse askush nuk do të zgjidhet për një vend të caktuar (për shembull: nëse e ka notën më të lartë, të mos ketë mundësi të mos zgjidhet).

Lidhur me pushimin e funksionit prokuror publik për shkak të kryerjes së veprës penale, neni 48 përcakton se Këshilli me aktvendim do ta përcaktojë pushimin e funksionit prokuror publik kur prokurori publik është dënuar për kryerjen e veprës penale me dënim me burgim për të paktën gjashtë muaj, ku gjykata e shkallës së parë që e ka marrë vendimin, pa prolongim, do t'i paraqesë Këshillit një kopje të aktgjykimit. Dispozita nuk është e qartë se cili aktgjykim duhet t'i paraqitet Këshillit, ai i shkallës së parë ose ai i formës së prerë. Prandaj, është e nevojshme të riprecizohet dispozita për të mundësuar zbatimin e saj të njëtrajtshëm.

Largimi i përkohshëm nga ushtrimi i funksionit prokuror publik rregullohet me nenin 52 të këtij ligji. Megjithatë, është e nevojshme i njëjti të rishikohet duke përcaktuar dispozita për procedurën e largimit dhe të përcaktohet në kuptimin e asaj nëse ka ngritur procedurë për përcaktimin e pazotësisë së përhershme, Këshilli a mundet ta largojë prokurorin publik dhe nëse nuk mundet, pse nuk mundet, pastaj sa mund të zgjasë largimi, brenda cilit afat Këshilli duhet të vendosë dhe çështje të tjera të rëndësishme për procedurën.

Me Shërbimin Profesional të KPP-së udhëheq Sekretar i Përgjithshëm. Neni 54 përcakton se kandidati për sekretar, përveç kushteve të përgjithshme për themelimin e marrëdhënies së punës në Prokurorinë Publike, duhet të ketë të paktën edhe katër vjet përvojë pune pas dhënies së provimit të jurispruencës. Dispozita në fjalë është e dykuptimtë dhe konfuze, sepse e njëjta nuk është e qartë se cilat kushte të përgjithshme duhet të plotësojë kandidati për Sekretar të Përgjithshëm, kushtet e përgjithshme për pozitën menaxheriale ose jo, përvoja e punës pas provimit të dhënë të jurispruencës a duhet të jetë në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut apo njihet përvoja e punës edhe nga një institucion tjetër, ndërkohë që nuk është e qartë se sa zgjat mandati i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 56 e rregullon të drejtën e pagave dhe kompensimeve të pagave të anëtarëve të Këshillit, si dhe të drejtën e përdorimit të apartamentit adekuat zyrtar nëse anëtar i Këshillit nuk ka apartamentin e tij në

selinë e Këshillit. Për sa i përket rreziqeve rregullatore, në dispozitat në fjalë nuk është përcaktuar procedura për realizimin e të drejtave të anëtarëve të Këshillit, së këtejmi nuk është e qartë se kush vendos për të drejtat e kompensimeve të pagave dhe përdorimin e apartamentit zyrtar, në cilin rast nuk mund të pranohet kërkesa për realizimin e të drejtave të specifikuara, etj.

4.3. Rreziqe në lidhje me përdorimin e termave pamjaftueshëm të qartë dhe pamjaftueshëm të përcaktuar

Neni 9 i përcakton kompetencat e KPP-së, ndër të cilat, në përputhje me paragrafin 17, Këshilli mban një fletë personale për prokurorët publikë. Nga pikëpamja e dykuptimësisë gjuhësore, duhet të përcaktohet termi “fletë personale” dhe të sqarohet nëse bëhet fjalë për dosjen personale të prokurorëve publikë.

Nga aspekti i teknikës ligjore legjislativë koherente, në nenin 14 që e rregullon procedurën e publikimit të shpalljes së zgjedhjes të anëtarit të Këshillit, termi “shpallja e zgjedhjeve” në alinenë (1) të paragrafit (1) të këtij neni, nga aspekti terminologjik duhet të harmonizohet me teknikën e përdorur në alinetë 2 dhe 3 ndërsa dispozita të përcaktohet në kuptimin “të miratojë aktvendim për publikimin e shpalljes së zgjedhjeve”. Me paragrafin (2) të këtij neni, është rregulluar në rast të pushimit të parakohshëm të mandatit nga neni 7 i këtij ligji, Kryetari i Këshillit do të veprojë në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni brenda 15 ditëve pas pushimit të mandatit të anëtarit të Këshillit. Në dispozitën në fjalë është e nevojshme të përcaktohet se çfarë konsiderohet me pushim të parakohshëm të mandatit (për shembull: vendimi i formës së prerë, etj.).

Neni 18 i Ligjit e rregullon formimin dhe veprimin e Komisionit për përgatitjen e listave të kandidatëve. Në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni, Komisioni me aktvendim do ta refuzojë kandidaturën e prokurorit publik për anëtar të Këshillit, nëse nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji ose nëse paraqet të dhëna joadekuate dhe të pasakta, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji. Është e nevojshme të përcaktohet termi “të dhëna joadekuate”, pasi nuk është plotësisht e qartë se a mendohet për të dhëna jo të plota dhe si e tillë terminologjia mund të jetë objekt i interpretimit dhe zbatimit të ndryshëm.

Në nenin 32¹⁸, termat “puna shkencore profesionale dhe veprimi publik” janë shumë të përgjithshëm. Gjithashtu, termi “avokatë të tjerë të dalluar” është i papërcaktuar dhe paraqet një rrezik rregullator për korrupsion, siç konstatoi Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në vitin 2022 gjatë një vlerësimi antikorrupsion të një pjese të dispozitave të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me dispozitën e nenit 35 paragrafi (1) të këtij ligji parashikohet pushimi i mandatit të anëtarit të KPP-së. Në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, nëse pushimi i mandatit është me kërkesë të anëtarit të Këshillit, mandati i pushon kur Këshilli, Kuvendi, përkatësisht Qeveria në seancë do ta miratojë

¹⁸ Neni 32

(1) Për anëtar të Këshillit të cilin e zgjedh Kuvendi mund të zgjidhet personi që i përmbush kushtet s vijojnë:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

- jurist i diplomuar me të paktën 15 vjet përvojë pune në profesionin juridik me provimin e dhënë të jurisprudence, i cili në ushtrimin e profesionit juridik është dalluar me punën shkencore ose profesionale apo me veprimin e tij publik; dhe

- të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për veprën penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe, autorizimit në ushtrimin e funksionit ose ndonjë veprë tjetër penale me burgim të pakushtëzuar prej së paku gjashtë muaj, që e bën të padenjë ta ushtrojë funksionin anëtar i Këshillit.

(2) Anëtarët e Këshillit të cilët i zgjedh Kuvendi janë nga radhët e profesorëve universitarë të drejtësisë, avokatë, ish-gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarë ndërkombëtarë dhe juristë të tjerë të dalluar, prej të cilëve dy janë pjesëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(3) Seanca e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilën zgjidhen anëtarët nga paragrafi (1) të këtij është urgjente dhe mbahet brenda një afati prej më së shumti 30 ditësh nga dita e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të zgjedhur nga prokurorët publikë.

dorëheqjen. Në këtë rast, është joadekuat përdorimi i termit “do ta miratojë dorëheqjen” sepse dorëheqja vetëm konkludohet sepse ajo është parashtruar dhe nuk duhet të miratohet.

Termi “në masë të madhe janë të pavërteta” i alinesë 3 paragrafit (1) të nenit 35-b¹⁹, duhet të braktiset dhe të harmonizohet me LPKKI. Njëherësh, nevojitet të sqarohen termat “me dashje ose neglizhencë e dukshme me fajin” të përcaktuara në alinenë 1 të paragrafit (2) të këtij neni. Së ketejmi, përdoret termi “me dashje”, i cili haset në teorinë e së drejtës penale dhe bëhet fjalë për një koncept teorik dhe jo për koncept ligjor që mund të lë hapësirë për interpretime subjektive, veçanërisht që nuk është përcaktuar se çfarë nënkupton ligjvënësi me termin “dashje” në këtë rast. Ligjvënësi e dallon veprimin me paramendim, si atë të drejtpërdrejtë ashtu edhe atë eventuale, por dashja si marrëdhënie subjektive e kryerësit është një koncept më shumë teorik dhe nuk ka përkufizim konkret. Termi i dytë të cilin e përdor ligjvënësi është veçanërisht problematik “neglizhencë e dukshme”. Edhe ky term nuk është i qartë sepse nga pikëpamja e neglizhencës, teoria juridike njeh dy lloje: neglizhencë e vetëdijshme dhe e pavetëdijshme. Termi “neglizhencë e dukshme” lë hapësirë për interpretim subjektiv dhe nuk përmban parametra kur do të konsiderohet se shkelja është kryer nga neglizhenca e dukshme dhe nëse kjo ka të bëjë edhe me neglizhencën e vetëdijshme edhe me atë të pavetëdijshme ose forma të caktuara të veprimit neglizhent do të përjashtohen. Nga pikëpamja e pavarësisë së prokurorëve publikë, është veçanërisht e rëndësishme që gjatë sanksionimit të veprimit neglizhent të ketë kritere të qarta që do të garantojnë se rreziqet e abuzimit janë minimizuar gjatë interpretimit të “neglizhencës së dukshme” dhe në këtë mënyrë të ndikohet mbi pavarësinë e prokurorëve publikë gjatë veprimit/ trajtimit. Në këtë kontekst, duhet vlerësuar edhe rrethana se nuk është përcaktuar në cilat raste do të konsiderohet se kanë ndodhur “pasoja të rënda”, kështu që për të shmangur dykuptimësinë dhe interpretimin subjektiv, është e nevojshme të parashikohen kritere me të cilat do të vlerësohet se kanë ndodhur “pasoja të rënda” (për shembull: vepra penale është parashkruar dhe ngjashëm.)

Neni 35–d paragrafi (1) i Ligjit përcakton se nëse kërkesa e masës disiplinore për anëtarin e Këshillit paraqitet rregullisht nga parashtruesi i autorizuar, Këshilli ia dërgon kërkesën dhe provat personalisht anëtarit të Këshillit kundër të cilit është paraqitur, përmes arkivit të Këshillit ose me dërgesë të rekomanduar në adresën e shtëpisë. Termi “adresa e shtëpisë” duhet të përcaktohet dhe të sqarohet se a bëhet fjalë për adresën e vendqëndrimit apo vendbanimit.

4.4. Rreziqe në lidhje me mënyrën e përcaktimit të afateve

Neni 13 i Ligjit e përcakton detyrimin e Këshillit për punën e tij të paraqesë raport vjetor në Kuvend. Nga këndvështrimi i rreziqeve rregullatore të përcaktuara me Metodologjinë e KAL, dispozitat në fjalë nuk e parashikojnë afatin për paraqitjen e raportit vjetor në Kuvend madje nuk parashikohet as afati brenda të cilit Këshilli e miraton raportin.

Neni 14 e rregullon procedurën e publikimit të shpalljes për anëtar të Këshillit, në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, në rast të pushimit të parakohshëm të mandatit sipas nenit 7 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit do të miratojë aktvendim për shpalljen e zgjedhjeve për anëtarët e Këshillit, nga

¹⁹ Neni 35-b

(1) Kërkesa e justifikuar për ngritjen e procedurës për përgjegjësi disiplinore të anëtarit të Këshillit, bashkë me provat mbi të cilat bazohet kërkesa, mund t'i paraqitet Këshillit nga të paktën 20 prokurorë publikë ose të paktën një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, nëse anëtar i Këshillit:

- ndikon në pavarësinë e prokurorëve publikë në vendimmarrjen për çështje konkrete,

- e neglizhon dhe nuk e ushtron funksionin e tij në punën e Këshillit,

- nëse refuzon të paraqesë deklaratë për gjendjen pasurore dhe interesave në përputhje me ligjin ose nëse të dhënat e përfshira në deklaratë janë kryesisht të pavërteta, ose

- i ka shkelur rregullat e përjashtimit në situatat kur anëtar i Këshillit ka qenë në dënim ose duhej të ishte në dënim për ekzistimin e ndonjëres prej bazave të përjashtimit të parashikuara me këtë ligj.

(2) Anëtar i Këshillit shkarkohet nga funksioni në përputhje me bazat e parashikuara në paragrafin (1) të këtij neni, nëse shkelja është kryer :

- me dashje ose neglizhencë të dukshme me fajin e prokurorit publik pa arsye të justifikueshme dhe

- ka shkaktuar pasoja të rënda.

radhët e prokurorëve publikë, dhe do ta njoftojë Kryetarin e Kuvendit dhe do të publikojë shpallje për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të cilët i zgjedh Kuvendi, në afat prej 15 ditësh pas pushimit të mandatit për anëtar të Këshillit. Për sa i përket integritetit dhe efektivitetit të procedurave, është diskutabile pse procedura të mos fillojë më herët, kurse afati prej 15 ditësh duhet të jepet si afat maksimal për publikimin e shpalljes së zgjedhjes së anëtarit të Këshillit. Prandaj, do të ishte e përshtatshme të rishikohet dispozita e paragrafit (2) sa i përket “më së voni në afat prej 15 ditësh pas pushimit të mandatit”.

Në përputhje me nenin 20 paragrafin (3) të ligjit, Regjistri Zgjedhor i Prokurorëve Publikë vendoset për këqyrje në Prokurorinë Publike dhe është i aksesshëm për ç'do prokuror publik i cili brenda tre ditëve ka të drejtë të kërkojë korrigjimin e të dhënave me shkrim. Kjo dispozitë nuk e specifikon se kur fillon të llogaritet afati prej tre ditësh, për këtë arsye është e nevojshme të rishikohet.

Për sa i përket rezultatit zgjedhor të procedurës së zgjedhjes së anëtarit të Këshillit, në përputhje me nenin 28 paragrafin (2), nëse është ngritur procedura e mbrojtjes së të drejtës së zgjedhjes, Komisioni Zgjedhor i publikon rezultatet e paragrafit (1) të këtij neni menjëherë pas përfundimit të këtyre procedurave, edhe në këtë rast ligjvënësi e përdor termin “menjëherë”, i cili nuk është një term i përshtatshëm dhe për sa i përket përcaktimit të saktë të afateve, nuk është e qartë se çfarë do të thotë saktësisht. Për sa më sipër, është e nevojshme të përcaktohet një afat i saktë për përmbushjen e këtij detyrimi.

Nenet 30 dhe 31 të këtij ligji i rregullojnë procedurat për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes së kandidatit dhe të drejtën të zgjedhë, përkatësisht të drejtën e tyre të kundërshtimit në Komisionin Zgjedhor brenda 5 orëve pas përfundimit të votimit, përkatësisht pas shpalljes së rezultateve, mbi këtë kundërshtim Komisioni duhet të marrë vendim brenda 12 orëve pas pranimit të tij. Në përputhje me paragrafin (3) dhe (4) të këtyre dy neneve, kundër vendimit të Komisionit Zgjedhor mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ para një gjykate kompetente brenda 12 orëve nga marrja e vendimit, për të cilën gjykata vendos brenda 48 orëve nga dita e pranimit të saj. Është e paqartë nëse kundërshtimet e paraqitura para përfundimit të votimit do të refuzohen si të parakohshme, prandaj është e nevojshme të korrigjohet mënyra e përcaktimit të afatit dhe të përcaktohet një afat prej “më së shumti 5 orë pas përfundimit të zgjedhjeve”.

Në lidhje me shpalljen e zgjedhjes së prokurorit publik, në përputhje me nenin 36 paragrafin (1) të ligjit, Këshilli merr vendim për publikimin e shpalljes për zgjedhjen e prokurorit publik menjëherë pas vakancës së vendit të prokurorit publik ose sipas nevojës së përcaktuar për vendin e prokurorit publik. Edhe në dispozitën në fjalë duhet të përcaktohen afate konkrete për publikimin e vendeve vakante dhe të mos përdoren terma të përgjithshëm si termi “menjëherë”, për ta pamundësuar interpretimin subjektiv dhe aplikimin e ndryshëm.

Termi “menjëherë” përsëri haset në nenin 42 të këtij ligji, i cili e rregullon publikimin e serishëm të zgjedhjes së prokurorit publik. Ai duhet të zëvendësohet me një afat të saktë.

Nenet 44 të këtij ligji përcaktojnë se Këshilli miraton aktvendim për pushimin e funksionit të prokurorit publik kur e kërkon vetë, pa i shqyrtuar në detaje arsyet e kërkesës, përkatësisht Këshilli miraton aktvendim për pushimin e funksionit të prokurorit publik për shkak të humbjes së shtetësisë në bazë të një vendimi të formës së prerë të një organi kompetent. Neni 46 paragrafi (3) e përcakton se Këshilli, mbi bazën e vendimit gjyqësor të formës së prerë, me aktvendim do ta konstatojë pushimin e funksionit të prokurorit publik për shkak të humbjes së përhershme të aftësisë për ushtrimin e funksionit. Në secilën prej këtyre dispozitave, ligjvënësi nuk ka përcaktuar afat brenda të cilit Këshilli vendos për

pushimin e funksionit prokuror publik. Edhe pse në shikim të parë duket si çështje administrative, në të vërtetë, për nevojat e zvogëlimit të rreziqeve rregullatore të korrupsionit, është thelbësore të parashikohet një afat i saktë brenda të cilit Këshilli do të marrë vendim për pushimin e mandatit me kërkesë të vetë, për shkak të humbjes së shtetësisë ose për shkak të humbjes së aftësisë për ushtrimin e funksionit.

4.5. Rreziqe për shkak të ekzistimit të konfliktit të jashtëm me ligjet e tjera

Parimisht, duhet i gjithë teksti i LKPP të harmonizohet me ligjin e ri LAGJPP, si në aspektin e emërimit të akademisë, ashtu edhe në aspektin e disa dispozitave që kanë të bëjnë me kushtet e zgjedhjes së prokurorit publik.

Neni 9 paragrafi 21 përcakton se Këshilli është kompetent për publikimin e shpalljes dhe për ta zbatuar procedurën e zgjedhjes së prokurorit publik për transferimin e përkohshëm në një prokurori tjetër publike. Dispozita në fjalë është në të ashtuquajturin konflikt të jashtëm me LPP-në. Është e paqartë se dispozita ligjore që Këshilli ta publikojë shpalljen dhe të zbatojë zgjedhjen e prokurorit publik për transferim të përkohshëm në një prokurori tjetër publik kur këtë kompetencë sipas LPP e posedon Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Është më se e i nevojshëm harmonizimi i dy ligjeve për të shmangur paparashikueshmërinë dhe zbatimin arbitrar/paralel të dispozitave të dy ligjeve.

Në përputhje me nenin 35 paragrafin (1) alineja 3, anëtarit të Këshillit mandati i pushon me përmbushjen e kushteve për pension pleqërie në përputhje me ligjin, me ç'rast anëtari i Këshillit mund të vazhdojë ta ushtrijë funksionin në përputhje me aktet normative për marrëdhëniet e punës duke paraqitur deklaratë në KPP. Në paragrafin (3) të këtij neni përcaktohet se në këtë rast, pushimin, përkatësisht vazhdimin e funksionit të anëtarit të Këshillit, me aktvendim, e konstaton Këshilli në seancën e parë të radhës. Kjo dispozitë është në kundërshtim me LMP, pasi sipas ligjit, tani më nuk ka mundësi për vazhdimin e marrëdhënies së punës pas moshës 64 vjeç. Së këtejmi, është e nevojshme të bëhen ndërhyrje përkatëse edhe në LKPP.

Përsëri, dispozitat e nenit 35-g²⁰ janë në konflikt të jashtëm me LPP-në dhe me dispozitat për fshehtësinë e procedurave, sepse konform këtij neni, Këshilli ka të drejtë të mbledhë të dhëna, në përputhje me LPP-në, në këto raste nuk mund të adresohen të dhënat që kërkohen, ndërkaq janë objekt të procedurës penale. Veç tjerash është e paqartë se deri në çfarë mase Këshilli mund të mbledhë të dhëna të tilla dhe cilat të dhëna mund t'i mbledhë, prandaj ekziston rreziku që Këshilli të mbledhë të dhëna të cilat për nga natyra janë konfidenciale, përkatësisht, Këshilli mund të zbatojë diçka që i ngjan hetimit penal.

Neni 37 përcakton se kandidati për prokuror publik në Prokurorinë Themelore Publike, i cili nuk do të paraqitet në tre shpallje të njëpasnjëshme për zgjedhjen e prokurorit publik, e humbet prioritetin e përcaktuar nga lista. Këtu LAGJPP ka një konflikt të jashtëm, sepse sipas të njëjtit, këta kandidatë nuk e humbin prioritetin e listës së rankimit, por e humbin statusin e kandidatit dhe kështu nuk mund të aplikojnë më në shpalljet.

Lidhur me zgjedhjen e prokurorëve publikë në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut në prokuroritë e larta publike dhe në PTHP NKOK, neni 38 paragrafi (2) parashikon mundësinë e zgjedhjes së prokurorit publik i cili nuk është nga radhët e prokurorëve publikë. Kjo dispozitë është

²⁰ Neni 35-g

(1) Këshilli mbledh të dhëna dhe prova që janë me interes për përcaktimin e situatës në lidhje me kërkesën.

(2) Nëse të dhënat dhe provat nga paragrafi (1) të këtij neni ndodhen tek një organ shtetëror, organ i njësishë së vetëqeverisjes lokale ose tek një subjekt fizik ose juridik, të cilit i është besuar ushtrimi i autorizimeve publike, ata e kanë për detyrë t'ia dërgojnë Këshillit pa kompensim brenda afatit të përcaktuar në kërkesën nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Së bashku me përgjigjen e kërkesës, anëtari i Këshillit i paraqet të gjitha provat mbi bazën e të cilave e mbështet përgjigjen e tij ndaj kërkesës.

në kundërshtim me LPP-në, pasi sipas të njëjtit, kandidati duhet të ketë notë pozitive, gjë që nga ana tjetër do të thotë se ai duhet të jetë prokuror publik në kohën e aplikimit, prandaj kjo dispozitë automatikisht është e pazbatueshme.

Si autoritet i shkallës së dytë, Këshilli, duke vendosur për ankimet, mund të shfuqizojë, anulojë ose konfirmojë vendimin e Komisionit për përcaktimin e përgjegjësisë së prokurorit publik konform LProk.Pub. Në përputhje me nenin 51 paragrafin (2) të këtij ligji, kur e konfirmon vendimin e Komisionit me të cilin është shqiptuar masa shkarkim nga funksioni prokuror publik, Këshilli miraton një aktvendim të veçantë me të cilin konstatohet pushimi i funksionit. Procedura e parashikuar në këtë mënyrë është e ndryshme nga ajo e parashikuar në Ligjin për Prokurorinë Publike, kështu që ekziston dualizëm dhe rregullim i ndryshëm i së njëjtës procedurë me dy ligje të ndryshme.

Neni 52 paragrafi (1) i këtij ligji përcakton se nëse prokurori publik është larguar nga funksioni, kur ndaj tij është ngritur procedurë penale, procedurë disiplinore ose procedurë për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit prokuror publik, e ka të drejtën e ankimit kundër vendimit për largimin nga funksioni në Këshill brenda tre ditëve nga dita e marrjes së vendimit. Dispozita në fjalë është në kundërshtim me LProk.Pub.-në, me ç'rast terminologjia e paharmonizuar me atë ligj është evidente. Atëherë, ushtrimi joprofesional dhe i pandërgjegjshëm i funksionit nuk janë baza për zhvillimin e procedurës disiplinore dhe përcaktimin e përgjegjësisë sipas LProk.Pub.

5. Analiza e dispozitave të Ligjit për Pagat e Prokurorëve Publikë dhe një pjese të akteve nënligjore dhe të përgjithshme që rezultojnë nga Ligji për Pagat e Prokurorëve Publikë

Titulli: Ligji për Pagat e Prokurorëve Publikë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.153/2009, 67/2010, 97/2010 dhe 231/2015 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 51/2024)

Shqyrtimi i kërkesës: Efektiviteti dhe paanshmëria e prokurorëve publikë janë pjesë përbërëse për ruajtjen e drejtësisë dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Shpërblimi adekuat dhe transparent i prokurorëve publikë nuk është vetëm çështje e drejtësisë, por edhe mbrojtje kritike nga korrupsioni. LPPP e siguron kuadrin ligjor për përcaktimin e kompensimit të këtyre aktorëve kryesorë në sektorin e drejtësisë. Megjithatë, si me çdo rregullim financiar, është thelbësore të vlerësohet nëse ligji përmban fragjilitete që mund t'i rrënojnë objektivat e tij ose të mundësojnë praktika korruptive.

Ky dokument shqyrton nëse legjislacioni siguron struktura të drejta pagash, minimizon autorizimin diskrecional dhe inkorporon mekanizma të mjaftueshëm për përgjegjësi dhe mbikëqyrje. Një vlerësim i tillë është thelbësor për identifikimin dhe luftimin e rreziqeve të mundshme që mund ta cenojnë integritetin e sistemit prokurorial. Theks i veçantë i kushtohet analizës së fushave të tilla si proceset e përcaktimit të pagave, transparenca në vendimmarrje dhe mekanizmat për zbatimin e harmonizimit. Përmes identifikimit të dobësive në këto fusha, ky dokument përpaket propozojë rekomandime të synuara që e përmirësojnë kapacitetin e ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe për të mbështetur funksionin prokurorial të pavarur dhe të paanshëm.

Së fundi, kjo analizë harmonizohet me përpjekjet më të gjera për të promovuar sundimin e ligjit dhe për të forcuar besimin e publikut në institucionet e drejtësisë. Duke adresuar sfidat në LPPP, ky dokument kontribuon në ndërtimin e një sistemi drejtësie që është i drejtë, transparent dhe rezistent ndaj korrupsionit.

Materialet e shqyrtuara/ konsultuara:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. LPKKI ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr.12/2019
3. LPPP. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 153/2009, 67/2010, 97/2010 dhe 231/2015 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 51/2024)²¹
4. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut U.nr.44/2020 U.nr.50/2020("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut "" nr. 139/2020)
5. LB ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2005, 4/2008, 103/2008, 156/2009, 95/2010, 180/2011, 171/2012, 192/2015 dhe 167/2016 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/2021, 87/2022, 203/2022, 272/2024 dhe 3/2025)
6. Ligji për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 283/2023)
7. Ligji për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 254/2024)
8. Kodi i Etikës për Prokurorët Publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.114/2021)
9. Rregullorja për Punën e Brendshme të Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 190/2021)
- 10.Rregullorja për Vlerësimin e Punës së Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 188/2024)
- 11.Rregullorja për Përcaktimin e Mënyrës së Kryerjes së Mbikëqyrjes mbi Punën dhe Veprimin e Prokurorive Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.6/2021)

KONKLuzion

Pas analizës së kryer të LPPP-së, akteve nënligjore dhe akteve të përgjithshme që rezultojnë prej tij, u identifikuan mangësi që mund të prodhojnë rreziqe për korrupsion. Mangësitë mund të kategorizohen në kategoritë si vijon:

- 5.1. Rreziqe për shkak të përkufizimeve të paqarta, të dykuptimta dhe të paspecifikuara
- 5.2. Rreziqe për shkak të politikës së parashikuar për përcaktimin e pagave
- 5.3. Rreziqe për shkak të mosharmonizimit me dispozita të tjera
- 5.4. Rreziqe për shkak të autorizimeve diskrecionale
- 5.5. Rreziqe për shkak të mungesës së procedurave të qarta dhe garancive procedurale

5.1. Rreziqe për shkak të përkufizimeve të paqarta, të dykuptimta dhe të paspecifikuara

Rreziqet në këtë ligj hasen qysh gjatë rregullimit fillestar të lartësisë së pagës së prokurorëve publikë, e cila në përputhje me nenin 4 të Ligjit rregullohet në varësi të: a) llojit të Prokurorisë Publike, b) departamentit dhe llojit të lëndëve ndaj të cilave vepron, c) detyrave të brendshme në Prokurorinë Publike, përvojës së punës, ç) titujve shkencor-profesional dhe specializimit, dhe d) rezultateve të arritura në ushtrimin e funksionit të prokurorit publik.

Megjithatë, parametrat e dhëna në alinenë 5 dhe 6 të këtij neni nuk janë pasqyruar në mënyrë adekuate në tekstin e ligjit si kritere që ndikojnë në mënyrën e përcaktimit dhe përlllogaritjes së pagës. Kështu, nuk ka dispozita që e rregullojnë rritjen e pagës në varësi të titujve profesionalë shkencorë, madje titujt profesionalë shkencorë nuk mund të konsiderohen relevantë për të ndikuar në lartësinë e pagës, a thua vetëm ato që janë të lidhur me funksionin, apo pavarësisht nga fusha e specializimit dhe përsosjes. Nga ana tjetër, nuk është e qartë se si rezultatet e arritura gjatë ushtrimit të funksionit të prokurorëve publikë ndikojnë mbi lartësinë e pagës, kur ligji nuk parashikon bonuse për arritjen e rezultateve të caktuara,

²¹ Ligji për ndryshimin e Ligjit për Pagat e Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 272/2024) nuk është marrë parasysh gjatë zbatimit të analizës për arsyen se hyri në fuqi më datë 27.12.2024.

ndërsa procedurat disiplinore që mund të rezultojnë në uljen e përkohshme të pagës nuk lidhen domosdoshmërisht me rezultatet e arritura gjatë ushtrimit të funksionit. Prandaj, fillimisht është e nevojshme të përcaktohen në ligj alinetë 5 dhe 6 të nenit 4, për të sqaruar se cilët tituj shkencorë-profesionalë mund të ndikojnë në lartësinë e pagës së prokurorëve publikë, si dhe në ç'mënyrë rezultatet e arritura në ushtrimin e funksionit ndikojnë në lartësinë e pagës. Pastaj, është e nevojshme të përfshihen dispozita në pjesën tjetër të ligjit që do të sqaronin më në detaje se si këta faktorë ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së pagës duke i përcaktuar koeficientet ose përqindjet në përputhje me të cilat paga do të harmonizohet.

Për më tepër, lidhur me përcaktimin e lartësisë së pagës, rreziqet për shkak të dispozitave të përcaktuara në mënyrë të paqartë dhe referimit ndaj ligjeve të tjerë me të cilët ka mospërputhje, janë identifikuar në nenet 5 dhe 5-a të këtij ligji. Kështu, neni 5 parashikon se “baza për llogaritjen e pagës së prokurorëve publikë është baza për llogaritjen e pagës për personat e zgjedhur dhe të emëruar të përcaktuar në përputhje me Ligjin për Pagën dhe Kompensime të tjera të Personave të Zgjedhur dhe të Emëruar në Republikën e Maqedonisë.” Menjëherë pas kësaj, neni 5-a e sërish e përcakton bazën e shumës fikse prej 25.726 denarësh. Ky është një rregullim i dyfishtë problematik, sepse ligji në njërin nen i referohet një akti tjetër normativ për përcaktimin e bazës, ndërsa në nenin tjetër e përcakton atë në mënyrë të pavarur në një shumë fikse. Duke e marrë parasysh se mund të ketë ndryshim vetëm në njërin ligj, gjë që në fakt ndodhi kur Gjykata Kushtetuese me Vendimin U.nr.113/2022 të datës 21.03.2023 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.65/2023) shfuqizoi dispozita të Ligjit për Pagat dhe Kompensime të tjera të Personave të Zgjedhur dhe të Emëruar në Republikën e Maqedonisë, të cilat kanë të bëjnë pikërisht me përcaktimin e bazës, ndërsa në rastin konkret ka pasiguri juridike se cilat dispozita do të zbatohen në praktikë. Prandaj, duhet neni 5-a të fshihet dhe të mbetet vetëm dispozita sipas së cilës “baza për llogaritjen e pagës së prokurorëve publikë është baza për llogaritjen e pagës së personave të zgjedhur dhe të emëruar të përcaktuar në përputhje me Ligjin për Pagën dhe Kompensime të tjera të Personave të Zgjedhur dhe të Emëruar”.

Në këtë kuptim, dispozitat e nenit 11 e rregullojnë mënyrën dhe lartësinë e mëditjeve/dietave të paguara për udhëtimet zyrtare jashtë vendit dhe në përputhje me paragrafin (1) pika b) paguhet: a) 50% të mëditjes së përcaktuar nëse paraqitet faturë për akomodim, si dhe në rastin kur akomodimi nuk bie në barrën e Prokurorisë Publike, dhe b) 20% të mëditjes së përcaktuar nëse shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit nuk bien në barrën e Prokurorisë Publike. Një formulim i tillë i paragrafit (1), pikës (b), alinesë 1 dhe 2 krijon rreziqe të zbatimit të ndryshëm dhe praktikës së dyfishtë të ndryshme, sepse nuk është e qartë se cili është saktësisht dallimi midis këtyre dy alineve, prandaj, siç mund të shihet në praktikën e vendosur, zakonisht paguhet një shumë prej 20% të mëditjes së përcaktuar. Ndërkaq, nuk është e qartë nëse prokurori publik është i detyruar të kërkojë kompensimin e shpenzimeve dhe në çfarë mënyre, cili është organi që vendos për kompensimin kurse prokurori i pakënaqur a ka të drejtë ankimi. Nuk është parashikuar dispozitë në lidhje me mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi zbatimin e këtyre procedurave dhe miratimin e këtyre vendimeve, të cilat të kombinuara me autorizimet diskrecionale të përcaktuara paraprakisht të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut përbëjnë rrezik të veçantë për korrupsion dhe konfliktin të interesave. Prandaj, është e nevojshme të rishkruhet neni 11 i këtij ligji për të qenë më i qartë dhe më i kuptueshëm dhe për të shmangur mundësinë e interpretimit dhe zbatimit të tij ndryshe në praktikë. Për më tepër, është e nevojshme të parashikohen rregulla për realizimin e kësaj të drejte, ose të paktën të bëhet një referencë ndaj një akti tjetër që do të parashikonte në detaje mënyrat e realizimit të kësaj të drejte. Së fundi, është e nevojshme të inkorporohen mekanizma për kontroll mbi punën financiare të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me pagesën e shtesave të pagës, si dhe kompensimeve të shpenzimeve për ushtrimin e funksionit prokurorial.

5.2. Rreziqe për shkak të politikës së parashikuar për përcaktimin e pagave

Në nenin 6 të Ligjit janë rregulluar koeficientet për përcaktimin e pagës së prokurorëve, të cilat shumëzohen me bazën për të përfituar shumën mujore të pagës së prokurorëve. Në këtë drejtim, edhe

pse ndoshta nuk bëhet fjalë për rrezik të korrupsionit konform metodologjisë së përdorur, duhet të kihet parasysh se përcaktimi i këtyre koeficienteve ka një ndikim serioz mbi sigurinë financiare, stabilitetin dhe pavarësinë në nivel individual për prokurorët publikë, prandaj, është e nevojshme të kihet parasysh se këto koeficientë duhet t'i nënshtrohen revizionit dhe harmonizimit të vazhdueshëm. Në këtë drejtim, nuk është e qartë se në bazë të cilave parametra dhe kriterë përcaktohen këto koeficiente dhe a janë në korrelacion me pagën mesatare dhe shportën e konsumit, shpenzimet e jetesës dhe ngjashëm. Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme gjatë përcaktimit të shumës së pagës së prokurorëve publikë që e ushtrojnë funksionin e tyre në PPTHP NKOK, me qëllim të arritjes së motivimit dhe rezistencës së mjaftueshme ndaj korrupsionit të prokurorëve publikë në këtë prokurori. Duhet të merret parasysh edhe pasqyra komparative, sipas së cilës koeficientet për përcaktimin e pagës së prokurorëve publikë në PTHP NKOK është më i ulëti në gjithë rajonin, gjë që e vë në pikëpyetje efikasitetin dhe pavarësinë financiare të tyre.

5.3. Rreziqe për shkak të mosharmonizimit me dispozita të tjera

Duke e pasur parasysh rëndësinë e çështjes së pavarësisë së prokurorëve publikë, duhet të përcaktohen kriterë të veçanta në përputhje me të cilat do të përcaktohen dhe harmonizohen koeficientet për llogaritjen e pagave të prokurorëve publikë. Në këtë mënyrë, në vend të përcaktimit të koeficienteve fikse, duhet të përcaktohen rregulla të qarta për përcaktimin e lartësisë së pagës dhe të mundësohet një fleksibilitet dhe drejtësi më e madhe në përcaktimin e lartësisë së pagës së prokurorëve publikë.

Dispozitat e nenit 6-b²² nuk janë harmonizuar me LProk.Pub., sepse në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të tij u suprimua Prokuroria Speciale Publike, prandaj duhet të shlyhet paragrafi (6) i nenit 6-b të Ligjit për Pagat e Prokurorëve Publikë.

Një mospërputhje e tillë mund të vërehet edhe në akte të tjera, por edhe në dispozitat e vetë ligjit sa i përket përdorimit të disa termave të ndryshëm në lidhje me pagën, siç janë: paga bazë, paga bruto, paga neto dhe baza. Së këtejmi, dispozita e paragrafit (3) të këtij neni, e cila parashikon një shumë maksimale të shtesave të pagës në lartësi prej 35% të pagës bazë, nuk është e qartë nëse ka të bëjë me 35% të pagës bruto apo pagës neto. Prandaj, është e nevojshme që ligji ta unifikojë terminologjinë dhe ta përkufizojë termin pagë bazë.

5.4. Rreziqe për shkak të autorizimeve diskrecionale

Përveç të gjitha sa më sipër, në nenin 6-b mund të vërehet diskrecioni relativisht i gjerë i Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut në drejtim të përcaktimit të mënyrës dhe lartësisë së shtesave të pagave të prokurorëve publikë, dhe diskrecioni i Prokurorit Publik të PTHP NKOK në drejtim të përcaktimit të shtesave të prokurorëve publikë në PTHP NKOK. Kjo është veçanërisht problematike nëse e marrim parasysh se nuk ka kriterë të qarta për sa i përket asaj se si përcaktohet ekzistimi i ndonjë prej faktorëve sipas të cilëve paguhen shtesat e pagave, madje as kriterë për llogaritjen se sa këto rrethana duhet të ndikojnë mbi lartësinë e shtesës. Përveç kësaj, nuk ka mekanizma specifike të garancisë të cilët prokurorët mund t'i përdornin nëse nuk janë të kënaqur me mënyrën dhe lartësinë e

²² Neni 6-b

(1) Prokurori publik e ka të drejtën e shtesës në pagës për:

- kushte të veçanta pune,
- ekzistimin e rrezikut të lartë dhe
- konfidencialitetin

(2) Shtesat e pagës sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk e përjashtojnë njëra tjetrën.

(3) Shuma totale e lartësisë së shtesave sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk mund të jetë më e madhe se 35% e pagës bazë të prokurorit publik.

(4) Shtesat sipas paragrafit (1) të këtij neni, shumat dhe mënyra e përcaktimit të tyre për Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë, prokuroritë e larta publike dhe prokuroritë themelore publike rregullohen me akt të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë.

(5) Shtesat nga paragrafi (1) të këtij neni, shumat dhe mënyra e përcaktimit të tyre për PTHP NKOK, rregullohen me akt të prokurorit publik i cili e udhëheq atë prokurori.

(6) Shtesat sipas paragrafit (1) të këtij neni, shumat dhe mënyra e përcaktimit të tyre për Prokurorinë Publike për Ndjekjen e Veprave Penale të Lidhura dhe që Rezultojnë nga Përmbytja e Ndjekjes së Pa-Autorizuar të Komunikimeve rregullohen me akt të prokurorit publik i cili udhëheq me atë prokurori publike.

përcaktimit të shtesave të pagave, prandaj në aspektin e këtij neni ka më shumë rreziqe të korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Ndërkohë, ligji nuk është mjaft i qartë as në drejtimin e asaj nëse kjo e drejtë përcaktohet për çdo rast individual sipas një kërkeje paraprake për përdorimin e kësaj të drejte nga prokurorët publikë, apo nëse bëhet fjalë për një të drejtë për realizimin e së cilës autoriteti kompetent duhet të jetë i kujdesshëm ex-officio, apo nëse kjo e drejtë përcaktohet në mënyrë kumulative për të gjithë prokurorët publikë. Atëherë, duhet të përcaktohen kritere të posaçëm sipas të cilave do të llogaritej dhe përcaktohej ekzistenca e rrethanave për pagesën e shtesave të pagave, mënyra e realizimit të kësaj të drejte, si dhe përcaktimi i lartësisë së këtyre shtesave në varësi të ekzistencës së këtyre rrethanave. Kjo do të kufizonte autorizimin e gjerë diskrecionale për të përcaktuar këtë të drejtë, dhe kështu të ndikonte në pavarësinë financiare të prokurorëve publikë, por gjithashtu do të parandalonte interpretimin eventualisht të ndryshëm të këtyre dispozitave në praktikë.

5.5. Rreziqe për shkak të mungesës së procedurave të qarta dhe garancive procedurale

Në përputhje me nenin 8, prokurori publik, i cili, sipas nevojës së shërbimit, transferohet përkohësisht në një prokurori tjetër publike, ka të drejtën e pagës në lartësinë e pagës së prokurorit publik në atë prokurori publike, nëse kjo është më e favorshme për të. Kështu, ligjvënësi parashikon një lloj garancie në rast të transferimit të përkohshëm në një prokurori tjetër publike, prokurori publik ta ketë të drejtën e pagës që korrespondon me atë Prokurori Publike, nëse kjo është më e favorshme për të. Ndonëse bëhet fjalë për një dispozitë që duhet të mbrojë prokurorët publikë, megjithatë në ligjin nuk ka dispozita të posaçme për mënyrën se si do të zbatohet kjo dispozitë në praktikë. Kështu, nga pikëpamja procedurale, mbetet e paqartë se cila prokurori publike është përgjegjëse për përllogaritjen dhe pagesën e pagës, veçanërisht në rastet kur ajo pagë është më e favorshme për të. Duke qenë se prokurori publik është zgjedhur në një prokurori publike, është e paqartë nëse me transferimin e përkohshëm i pushon marrëdhënia e punës në prokurorinë mëmë dhe krijon marrëdhënie pune në prokurorinë publike ku është transferuar përkohësisht. Në këtë mënyrë, duke e marrë parasysh diskrecionin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut të vendosë për transferim të përkohshëm, i njëjti praktikisht mund të anashkalojë vendimet e KPP-së edhe nga aspekti financiar. Nga ana tjetër, nëse prokurori publik që transferohet përkohësisht mbetet i punësuar në prokurorinë publik mëmë, është e paqartë se mbi çfarë baze ligjore do të llogaritej paga më e lartë. Prandaj, është e nevojshme të rishikohet kjo dispozitë për të sqaruar çështjet e mësipërme, por edhe të inkorporohen mekanizma parandalues, përkatësisht një procedurë e rregullt për realizimin e kësaj të drejte, nga pikëpamja e marrjes së një vendimi formal për realizimin e saj, me të drejtën e parashikuar të mjetit juridik nëse prokurori publik nuk është i kënaqur me vendimin.

Në funksion të nenit 10²³, nuk është përcaktuar procedurë për realizimin e këtyre të drejtave të kompensimeve dhe asistencës financiare, kështu që mbetet e paqartë se si inicohet procedura për

²³ Neni 10

(1) Prokurori publik e ka të drejtën e kompensimit të shpenzimeve që lidhen me ushtrimin e funksionit të prokurorit publik, si më poshtë :

- kompensimin e shpenzimeve të transportit të prokurorit publik që jeton në një komunë kurse punon në një komunë tjetër, në lartësinë e shpenzimeve faktike në transportin publik,
- kompensimin e shpenzimeve për jetë të ndarë nga familja në lartësi të përcaktuar në përputhje me Ligjin për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, si dhe kompensimin e transportit për katër udhëtime kthyes nga vendi ku e ushtron funksionin e tij deri në vendin ku ai jeton, në lartësinë e biletës të autobusit, nëse nuk e përdor kompensimin për jetë të ndarë,
- kompensimin për qiranë e apartamentit për prokurorin publik, i cili ka të drejtë të përdorë apartament zyrtar në përputhje me ligjin, nëse nuk mund ti sigurohet apartament zyrtar. Kompensimi për qiranë e apartamentit nuk i takon nëse prokurorit publik i paguhet kompensimi i shpenzimeve për jetë të ndarë,
- për ditët kur prokurori publik është në udhëtim zyrtar, pushim mjekësor, pushim vjetor dhe mungon në puna mbi çdo bazë, kompensimi për jetë të ndarë nuk paguhet,
- kompensimi për shpenzimet e shpërnguljes të prokurorit publik, i cili e ka të drejtën e përdorimit të apartamentit zyrtar, paguhet në lartësinë e shpenzimeve faktike për transportin e orendive shtëpiake. Kompensimi për shpenzimet e shpërnguljes nuk i takon nëse prokurorit publik i paguhet kompensimi i shpenzimeve për jetë të ndarë,
- në rast të vdekjes së prokurorit publik, familjes së tij takon ndihmë financiare në shumën e përcaktuar në përputhje me Ligjin për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë,
- në rast të vdekjes së anëtarit të familjes së ngushtë të prokurorit publik (prindi, bashkëshorti/ja, fëmijët e lindur brenda ose jashtë martese, thjeshtërit, fëmijët e adoptuar dhe fëmijët që i kanë marrë në përkujdesje), prokurori publik, nëse jeton në bashkësi i takon ndihmë financiare në shumën e përcaktuar në përputhje me Ligjin për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, dhe

realizimin e tyre, kush e merr vendimin, çfarë lloj vendimi mund të merret, përkatësisht a mundet shpenzimet të pranohen vetëm pjesërisht, në cilat kushte dhe në bazë të cilave kritere, pastaj prokurori i pakënaqur a ka të drejtë ta ankimojë vendimin, madje nuk ka as ndonjë tregues se kjo çështje do të zgjidhet me një akt tjetër. Rreziqet shtesë në këtë nen lindin për sa i përket referimit në ligje dhe akte të tjera normative, ndërsa në të njëjtën kohë ligji ofron një strukturë ndryshe të realizimit të ndonjë prej këtyre të drejtave. Rrjedhimisht, ka pasaktësi dhe konfuzion relativisht të lartë, por edhe në vende të caktuara me një rregullim ndryshe dhe të dyfishtë të të drejtës së njëjtë. Prandaj, neni 10 duhet terminologjikisht të rishikohet dhe të shmanget rregullimi i dyfishtë i dispozitave, duke iu referuar në mënyrë të qartë dhe drejtpërdrejt Ligjit për Realizimin e Buxhetit. Është e nevojshme të rregullohen në mënyrë të qartë dhe të saktë procedurat e realizimit të së drejtës së kompensimit të shpenzimeve, nga iniciimi i tyre deri në miratimin e vendimit dhe të drejtën e ankimit.

Në nenin 12 parashikohet edhe pagesa e kompensimit të veçantë për kujdestari, shuma e së cilit përcaktohet me Rregullore nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me pëlqimin paraprak të Ministrit të Financave. Megjithatë, ligji nuk përmban kritere dhe kushte për përcaktimin e shumës së kompensimit për kujdestari. Veç tjerash, mbetet e paqartë pse pikërisht në këtë pjesë Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i lidhur me pëlqimin paraprak të Ministrit të Financave, ndërkohë mungojnë dispozita që do ta rregullonin se si do të zgjidhet situata nëse Ministri i Financave nuk i jep pëlqim Rregullores e cila e përcakton shumën e kompensimit të kujdestarisë.

Në mënyrë të ngjashme, neni 13 e përcakton se prokurorët publikë që i plotësojnë kushtet për pension pleqërie kanë të drejtë për bonus/asistencë financiare në lartësi prej dy pagave mesatare mujore të paguara në tre muajt e fundit. Pra, sërish paraqitet paqartësi se a bëhet fjalë për paga bruto apo neto. Ajo që lë më shumë përshtypje është se nuk ka rregulla se si të realizohet kjo e drejtë dhe përlllogaritja e shumës së asistencës monetare. Duke qenë se këto çështje rregullohen me akte të tjera, do të ishte e mjaftueshme në këtë drejtim nëse ligji do t'i referohej vetëm dispozitave përkatëse të aktit përkatës.

6. Analiza e dispozitave të Ligjit për Pagat e Gjyqtarëve dhe një pjesë të Akteve Nënligjore dhe të Përgjithshme që rezultojnë nga Ligji për Pagat e Gjyqtarëve

Titulli: Ligji për Pagat e Gjyqtarëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.110/2007, 103/2008, 161/2008, 153/2009, 67/2010, 67/2010, 97/2010, 135/2011, 231/2015 dhe 248/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 51/2024)

Shqyrtimi i kërkesës: Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit janë parimet themelore të një shoqërie demokratike ndërsa si komponent kyç për të siguruar një pavarësi të tillë është pikërisht siguria financiare e gjyqtarëve. Ligji për Pagat e Gjyqtarëve luan një rol kyç në vendosjen e standardeve për pavarësinë financiare individuale dhe rezistencën ndaj korrupsionit që duhet ta gëzojnë gjyqtarët në një sistem gjyqësor demokratik. Megjithatë, potenciali për rreziqe korrupsioni brenda këtij kuadri ligjor kërkon një vlerësim të plotë për të siguruar garanci që ai e mbron atë në mënyrë efektive nga ndikimi joadekuat dhe e ruan integritetin e sistemit gjyqësor.

Ky dokument synon të ofrojë një analizë të thelluar të LPGJ-së, duke i vlerësuar dispozitat e tij lidhur me transparencën, llogaridhënien dhe harmonizimin me praktikat më të mira ndërkombëtare. Qëllimi është të identifikohen saktësisht fushat ku ligji mund të dështojë në parandalimin e korrupsionit dhe të propozojë rekomandime aktive për adresimin e këtyre boshllëqeve. Prandaj, vëmendje e veçantë i kushtohet dobësive sistemike siç janë mekanizmat e paqartë të përcaktimit të pagave, autorizimet diskrecionale pa mbikëqyrje, procedurat e përcaktuara në mënyrë të paqartë, mekanizmat e garancisë,

- në rast të pushimit mjekësor për më shumë se gjashtë muaj dhe në rast të pasojave më të rënda nga fatkeqësitë natyrore, në kuptimin e Ligjit për Mbrojtje dhe Shpëtim, prokurorin publik i paguhet ndihmë në shumën e një page mesatare neto mujore të fundit të paguar në prokurorinë publike ku është i punësuar.

afatet dhe mungesa e dispozitave efektive të monitorimit dhe zbatimit. Duke i detektuar këto rreziqe, ky dokument synon të kontribuojë në përpjekjet më të gjera për të forcuar sundimin e ligjit, për të promovuar pavarësinë e gjyqësorit dhe për të nxitur besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Ky KAL, synon të ofrojë edhe zgjidhje praktike që e forcojnë drejtësinë, parashikueshmërinë dhe transparencën e pagave dhe kompensimeve gjyqësore në mënyrë që të pamundësohet përdorimi i tyre për të imponuar ndikime joadekuate mbi gjyqësorin. Së këtejmi, e mbështet qëllimin gjithëpërfshirës për ndërtimin e një sistemi gjyqësor efikas dhe efektiv i cili funksionon i lirë nga korrupsioni dhe ndikimi joadekuat.

Materialet e shqyrtuara/ konsultuara:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. LPKKI ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 12/2019)
3. LPGJ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 110/2007, 103/2008, 161/2008, 153/2009, 67/2010, 67/2010, 97/2010, 135/2011, 231/2015 dhe 248/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 51/2024)²⁴
4. Rregullorja e Punës së Këshillit Gjyqësor Buxhetor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 89/2014)
5. Vendimi për mënyrën e realizimit të të drejtave të gjyqtarëve të përcaktuara në Ligjin për Pagat e Gjyqtarëve (nr. 02-1425/12 dhe nr. 02-547/18)
6. LBGJ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/2003, 37/2006, 103/2008 dhe 145/2010)
7. LB ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2005, 4/2008, 103/2008, 156/2009, 95/2010, 180/2011, 171/2012, 192/2015 dhe 167/2016 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/2021, 87/2022, 203/2022, 272/2024 dhe 3/2025)
8. Ligji për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 283/2023)
9. Ligji për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 254/2024)

KONKLuzion

Pas analizës së LPGJ, akteve nënligjore dhe akteve të përgjithshme që rezultojnë prej tij, u identifikuan mangësi që mund të prodhojnë rreziqe për korrupsion. Mangësitë mund të kategorizohen në kategoritë si vijon:

- 6.1. Rreziqe për shkak të përkufizimeve të paqarta, të dykuptimta dhe të paspecifikuara
- 6.2. Rreziqe për shkak të mungesës së procedurave të qarta dhe garancive procedurale

6.1. Rreziqe për shkak të përkufizimeve të paqarta, të dykuptimta dhe të paspecifikuara

Rreziqet në këtë ligj hasen qysh në rregullimin fillestar të lartësisë së pagës së gjyqtarit, e cila në përputhje me nenin 4 të ligjit rregullohet në varësi të: a) llojit të gjykatës, b) departamentit të specializuar gjyqësor (lloji i lëndëve ndaj të cilave vepron), c) detyrave të brendshme në gjykatë (kryetari i: gjykatës, departamentit, seksionit dhe këshillit), ç) përvojës gjyqësore, d) titujve shkencorë

²⁴ Ligji për ndryshimin e Ligjit për Pagat e Gjyqtarëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 272/2024) nuk është marrë parasysh gjatë zbatimit të analizës për arsyen se hyri në fuqi më datë 27.12.2024.

- profesionalë dhe specializimit, dhe dh) rezultateve të arritura në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Megjithatë, parametrat e dhëna në alinetë 5 dhe 6 të këtij neni nuk janë pasqyruar në mënyrë adekuate në tekstin e ligjit si kriteret që ndikojnë në mënyrën e përcaktimit dhe llogaritjes së pagës. Kështu që, nuk ka dispozita që e rregullojnë rritjen e pagës në varësi të titujve profesionalë shkencorë, madje as cilët tituj profesionalë shkencorë nuk mund të konsiderohen relevantë për të ndikuar në lartësinë e pagës. Nga ana tjetër, nuk është e qartë se si rezultatet e arritura në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit ndikojnë mbi lartësinë e pagës, kur ligji nuk parashikon bonuse për arritjen e rezultateve të caktuara, ndërsa procedurat disiplinore që mund të rezultojnë me ulje të përkohshme të pagës nuk lidhen domosdoshmërisht me rezultatet e arritura në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Për sa më sipër, fillimisht është e nevojshme të përcaktohen në ligj alinetë 5 dhe 6 të nenit 4, në mënyrë që të sqarohet se cilët tituj shkencorë-profesionalë mund të ndikojnë në lartësinë e pagës së gjyqtarit, si dhe në ç'mënyrë rezultatet e arritura në ushtrimin e funksionit ndikojnë në lartësinë e pagës. Ndërkohë, është e nevojshme të përfshihen dispozita në pjesën tjetër të ligjit që do të përcaktojnë në detaje se si këta faktorë ndikojnë në përcaktimin e shumës së pagës.

Për më tepër, lidhur me përcaktimin e lartësisë së pagës, rreziqet për shkak të dispozitave të përcaktuara në mënyrë të paqartë dhe referimit ndaj ligjeve të tjera me të cilat ka mospërputhje, janë identifikuar në nenet 5 dhe 5-a të këtij ligji. Kështu, neni 5 parashikon se “baza për llogaritjen e pagës së gjyqtarëve është baza për llogaritjen e pagës për personat e zgjedhur dhe të emëruar të përcaktuar në përputhje me Ligjin për Pagën dhe Kompensimet e tjera të Personave të Zgjedhur dhe të Emëruar në Republikën e Maqedonisë.”. Menjëherë pas kësaj, neni 5-a e përcakton këtë bazë në një shumë fikse prej 25.726 denarësh. Ky është një rregullim i dyfishtë problematik, sepse ligji në njërin nen i referohet një akti tjetër normativ për përcaktimin e bazës, ndërsa në nenin tjetër e përcakton atë në mënyrë të pavarur në një shumë fikse. Duke e marrë parasysh se mund të ketë ndryshim vetëm në njërin ligj, gjë që në fakt ndodhi kur Gjykata Kushtetuese me Vendimin U.nr.113/2022 të datës 21.03.2023 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.65/2023) shfuqizoi dispozita të Ligjit për Pagat dhe Kompensime të tjera të Personave të Zgjedhur dhe të Emëruar në Republikën e Maqedonisë, të cilat kanë të bëjnë pikërisht me përcaktimin e bazës, shfaqet pasiguri juridike se cilat dispozita do të zbatohen në praktikë. Prandaj, neni 5-a duhet të fshihet dhe të mbetet vetëm dispozita sipas së cilës baza për llogaritjen e pagës së gjyqtarëve është baza e përcaktuar në përputhje me Ligjin për Pagën dhe Kompensime të tjera të Personave të Zgjedhur dhe të Emëruar.

Në nenin 7 përcaktohen koeficientet për përcaktimin e pagës së gjyqtarëve të cilët shumëzohen me bazën, me qëllim përfitimin e shumës mujore të pagës së gjyqtarit. Edhe pse ndoshta nuk bëhet fjalë për rrezik korrupsioni në përputhje me metodologjinë e përdorur, përcaktimi i këtyre koeficienteve ka një ndikim serioz mbi sigurinë financiare, stabilitetin dhe pavarësinë e gjyqtarëve. Në këtë drejtim, nuk është e qartë se në bazë të cilave parametra përcaktohen këto koeficiente dhe sa ato janë në korrelacion me pagën mesatare dhe shportën e konsumit, shpenzimet e jetesës dhe ngjashëm. Duke e pasur parasysh rëndësinë e çështjes së pavarësisë së gjyqtarëve, duhet të përcaktohen kriteret të posaçme në përputhje me të cilat do të përcaktohen dhe harmonizohen vazhdimisht koeficientet. Në vend që të përcaktohen koeficiente fikse, duhet të përcaktohen rregulla të qarta për përcaktimin e lartësisë së pagës për një fleksibilitet dhe drejtësi më e madhe në përcaktimin e lartësisë së pagës së gjyqtarëve.

Neni 7-b²⁵ është i paqartë, i pa harmonizuar me të drejtat dhe procedurat e realizimit të tyre, në kundërshtim me dispozitat e nenit në fjalë, si dhe me boshllëqet ligjore të përmbajtura. Kjo situatë e

²⁵ Neni 7-b

(1) Gjyqtari ka të drejtën e shtesës së pagës për:
- kushte të veçanta pune,
- ekzistimin e rrezikut të lartë dhe

bën këtë nen objekt të interpretimeve të ndryshme dhe zbatimit të pabarabartë në praktikë. Kështu, paragrafi (1) i këtij neni përcakton shprehimisht se gjyqtarët e kanë të drejtën e shtesës në pagë, megjithatë, në përputhje me paragrafin (4), kjo e drejtë mund të realizohet sipas një vendimi të miratuar nga KGJB për mjetet e siguruar financiare, si dhe sipas miratimit të aktvendimit nga kryetari i gjykatës. Kështu, këto dy paragrafë janë në kolizion, sepse nëse gjyqtari ka të drejtën e shtesës në pagë, kjo nuk duhet të varet nga miratimi paraprak i mjeteve për këtë dedikim nga KGJB. Në këtë drejtim, në paragrafët (6) dhe (7) parashikohet se gjyqtarët e kanë të drejtën e kundërshtimit në Këshillin Gjyqësor nëse kryetari nuk merr aktvendim, edhe pse janë siguruar mjetet nga KGJB, ose nëse gjyqtari është i pakënaqur me aktvendimin e miratuar. Megjithatë, askund nuk është parashikuar mundësia të kontestohet vendimi i KGJB, i cili në përputhje me strukturën organizative ligjore mund të marrë një vendim se nuk janë siguruar mjete, ose se janë siguruar mjete për përfitues të caktuar të buxhetit, por jo edhe për të tjerët. Njëherësh, ligji nuk përmban kritere sipas të cilave do të vlerësohej ekzistenca e faktorëve që ndikojnë në pagesën e këtyre shtesave, si dhe mënyra në të cilën përcaktohet shuma e shtesës në korrelacion me shkallën e ekzistimit të disa prej faktorëve. Atëherë, duhet të inkorporohen kritere të posaçëm sipas të cilave do të llogaritej dhe përcaktohej ekzistimi i rrethanave për pagesën e shtesave të pagave, mënyra e realizimit të kësaj të drejte, si dhe përcaktimi i lartësisë së këtyre shtesave në varësi të ekzistimit të këtyre rrethanave. Kjo do ta kufizonte diskrecionin e gjerë për të përcaktuar këtë të drejtë, por do ta pamundësonte edhe interpretimin eventualisht të ndryshëm të këtyre dispozitave në praktikë.

Në përputhje me nenin 11-a të Ligjit, gjyqtari i cili sipas nevojës së shërbimit përkohësisht është transferuar në një gjykatë tjetër, e ka të drejtën e pagës në lartësinë e pagës së gjyqtarit në atë gjykatë, nëse ajo është më e favorshme për të. Me këtë dispozitë ligjvënësi parashikon një lloj garancie sipas së cilës, në rast të transferimit, gjyqtari e ka të drejtën e pagës që korrespondon me gjykatën ku është transferuar nëse është më e favorshme për të. Edhe pse bëhet fjalë për një dispozitë që duhet të mbrojë gjyqtarët, megjithatë mbetet e paqartë se në çfarë mënyre dhe kush do ta bëjë llogaritjen dhe pagesën e pagës në rastet kur gjyqtari merr pagë sikur të ishte zgjedhur në gjykatën ku është transferuar përkohësisht. Bëhet fjalë për një rrezik i cili është akoma më kompleks për sa i përket asaj se cili përfitues i buxhetit është ai që duhet t'i sigurojë mjetet për gjyqtarin, gjë që lë shumë hapësirë për interpretime të ndryshme të dispozitave, si dhe shfaqjen e konfuzionit në lidhje me atë se mbi cilën bazë ligjore do të llogaritej paga më e lartë për gjyqtarin. Prandaj, është e nevojshme të sqarohen çështjet e mësipërme, të rregullohet mënyra dhe kompetenca për llogaritjen e pagës dhe sigurimin e mjeteve në buxhetin e përfituesve buxhetorë, si dhe të futen mekanizma parandalues, siç është rregulluar procedura e zbatimit të kësaj të drejte, në drejtim të marrjes së vendimi zyrtar për përdorimin e të drejtës me të drejtën e parashikuar të mjetit juridik.

- konfidencialitetin.

(2) Shtesat e pagës sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk e përjashtojnë njëra tjetrën.

(3) Shuma totale e lartësisë së shtesave sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk mund të jetë më e madhe se 35% e pagës bazë të gjyqtarit.

(4) Sipas një vendimi të Këshillit Gjyqësor Buxhetor për mjetet e siguruar financiare, kryetari i gjykatës, jo më vonë se mesi i muajit, mund të marrë një aktvendim për pagesën e shtesës përkatësisht shtesave nga paragrafi (1) i këtij neni për gjyqtarin e gjykatës për muajin paraprak. Aktvendimi duhet të përmbajë një arsyetim për përmbushjen e kushteve për përcaktimin e të drejtës së shtesës.

(5) Kriteret në përputhje me të cilat vlerësohet përmbushja e kushteve për përcaktimin e së drejtës së shtesave sipas paragrafit (1) të këtij neni, lartësia e tyre dhe mënyra e përcaktimit për Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, Gjykatën e Lartë Administrative, Gjykatën Administrative, për gjykatat e apelit dhe gjykatat themelore rregullohen me akt të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, sipas pëlqimit paraprak të Ministrisë të Financave.

(6) Kundër aktvendimit të Kryetarit të Gjykatës, nga paragrafi (4) të këtij neni, gjyqtari e ka të drejtën e kundërshtimit në Këshillin Gjyqësor brenda tetë ditëve.

(7) Nëse Këshilli Gjyqësor Buxhetor merr vendim për sigurimin e mjeteve financiare për muajin paraprak, ndërsa Kryetari i Gjykatës nuk e merr aktvendimin nga paragrafi (4) të këtij neni, gjyqtari që vlerëson se i plotëson kushtet për përcaktimin e së drejtës për shtesat e pagës ka të drejtë të paraqesë kundërshtim në Këshillin Gjyqësor deri në fund të muajit në të cilin Kryetari i Gjykatës do të duhej të merrte aktvendim.

6.2. Rreziqe për shkak të mungesës së procedurave të qarta dhe garancive procedurale

Neni 12²⁶ përmban rreziqe të ngjashme që lidhen me mungesën e dispozitave të qarta që e rregullojnë të drejtën e përdorimit të kompensimit për kujdestari. Kështu, në alinenë e fundit të paragrafit (1) të këtij neni parashikohet se kompensimi i kujdestarisë përcaktohet në shumën sipas vendimit të autoritet kompetent, i cili në përputhje me LGJ është Ministri i Drejtësisë. Kjo situatë jo vetëm që i jep diskrecion të madh ministrit gjatë përcaktimit të shumës së kompensimit të kujdestarisë, ndikon edhe në pavarësinë financiare të gjyqësorit, meqë përsëri kemi një situatë ku planifikimi dhe realizimi i buxhetit të gjykatave varet nga pushteti ekzekutiv. Për më tepër, një vërejtje e përgjithshme lidhur me nenin është se nuk rregullohet qartë kur dhe cila nga të drejtat zbatohet në rastin kur ato përjashtojnë njëra tjetrën, përkatësisht nëse i mbetet gjyqtarit të zgjedhë se cilën të drejtë ta zgjedhë, ose ekziston një procedurë dhe mënyrë e veçantë për të përcaktuar se cila e drejtë ka përparësi kur ato e përjashtojnë njëra tjetrën. Në këtë drejtim, ligji nuk rregullon as procedurën e ankimit të vendimeve për sigurimin e mjeteve dhe pagesën e tyre për gjyqtarët. Rreziqet shitesë në këtë nen shfaqen për sa i përket referimit në ligje dhe akte të tjera normative, ndërsa ligji njëkohësisht ofron një strukturë ndryshe për realizimin e ndonjë prej këtyre të drejtave. Rrjedhimisht, ka një pasaktësi dhe konfuzion relativisht të lartë, ndërsa në vende të caktuara një rregullim ndryshe dhe të dyfishtë të të drejtës së njëjtë. Prandaj, në aspektin terminologjik duhet të rishikohet neni dhe të shmanget rregullimi i dyfishtë i dispozitave, duke iu referuar në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë Ligjit për Realizimin e Buxhetit. Ndërkohë, duhet të rregullohen në mënyrë të qartë dhe të saktë procedurat e realizimit të së drejtës së kompensimeve, nga iniciimi i tyre deri në miratimin e vendimit dhe të drejtën e ankimit.

Sipas nenit 13 paragrafi (1) pika (b), kompensimi i mëditjeve për udhëtime zyrtare jashtë vendit përcaktohet me vendimin e KGJB ndërsa shuma e saj paguhet: a) 50% e mëditjes të përcaktuar nëse dorëzohet faturë për akomodim, si dhe në rastin kur akomodimi nuk bie në barrë të gjykatës dhe b) 20% e mëditjes të përcaktuar nëse shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit nuk bien në barrë të gjykatës. Një formulim i tillë i paragrafit (1), pikës (b), alineve 1 dhe 2 krijon rreziqe të zbatimit të ndryshëm dhe praktikës së dyfishtë, sepse nuk është e qartë se cili është saktësisht ndryshimi midis këtyre dy alineve, veçanërisht për shkak të formulimit gjuhësor të alinesë së parë që e vështirëson parashikimin praktik të pagesës së mëditjeve. Nga ana tjetër, nuk parashikohet asnjë procedurë e veçantë për realizimin e kësaj të drejte dhe nuk është e qartë nëse gjyqtari është i detyruar të kërkojë një kompensim të tillë të

²⁶ Neni 12

(1) Gjyqtari e ka të drejtën e kompensimit të shpenzimeve që lidhen me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, si më poshtë:

- kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, ditore dhe shpenzimeve të tjera për udhëtimet zyrtaret brenda dhe jashtë vendit,
- kompensimin e shpenzimeve të transportit të gjyqtarit që jeton në një komunë ndërsa punon në një tjetër, në lartësinë e shpenzimeve faktike të transportit me mjet transporti publik që mundëson mbërritjen dhe largimin në kohë nga puna,
- kompensimin e shpenzimeve për jetë të ndarë nga familja në lartësi të përcaktuar në përputhje me Ligjin për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, si dhe kompensimin e transportit për katër udhëtime kthyes nga vendi ku e ushtron funksionin e tij deri në vendin ku ai jeton, në lartësinë e biletës të autobusit, nëse nuk e përdor kompensimin për jetë të ndarë,
- kompensimin për qiranë e apartamentit për gjyqtarin, i cili e ka të drejtën e përdorimit të apartamentit zyrtar në përputhje me ligjin, nëse nuk mund të sigurohet apartament zyrtar. Shuma e kompensimit të qirasë së apartamentit përcaktohet me vendim të Këshillit Gjyqësor Buxhetor. Kompensimi për qiranë e apartamentit nuk i takon nëse gjyqtarit i paguhet kompensimi i shpenzimeve për jetë të ndarë,
- kompensimi për shpenzimet e shpërnguljes të gjyqtarit, i cili e ka të drejtën e përdorimit të apartamentit zyrtar, paguhet në lartësinë e shpenzimeve faktike për transportin e orendive shtëpiake. Kompensimi për shpenzimet e shpërnguljes nuk i takon nëse gjyqtarit i paguhet kompensimi i shpenzimeve për jetë të ndarë,
- në rast të vdekjes së gjyqtarit, familjes së tij takon ndihmë financiare në shumën e përcaktuar në përputhje me Ligjin për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë,
- në rast të vdekjes së anëtarit të familjes së ngushtë të gjyqtarit (prindi, bashkëshorti/ja, fëmijët e lindur në ose jashtë martese, thjeshtërit, fëmijët e adoptuar dhe fëmijët që i kanë marrë në përkujdesje), gjyqtari, nëse jeton në bashkësi i takon ndihmë financiare në shumën e përcaktuar në përputhje me Ligjin për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, dhe
- në rast të pushimit mjekësor për më shumë se gjashtë muaj dhe në rast të pasojave më të rënda nga fatkeqësitë natyrore, në kuptimin e Ligjit për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjyqtarit i paguhet ndihmë në lartësinë e një page mesatare neto mujore të fundit të paguar në gjykatën ku është i punësuar.
- kompensimi për kujdestari në lartësinë e vendimit të autoritet kompetent.

(2) Gjyqtarit të cilit, në bazë të miratimit zyrtar, i lejohet të përdorë një automjet zyrtar për transport personal deri në dhe nga vendi i punës, nuk i takon kompensimi për transport.

shpenzimeve dhe në cilën mënyre, ose nëse gjykata është e detyruar të kujdeset për mbulimin e këtyre shpenzimeve ex-officio. Pastaj, nuk është e qartë se kush e merr vendimin përfundimtar për llogaritjen dhe pagesën e kompensimit, madje as nëse gjyqtari i pakënaqur ka të drejtë ta ankimojë vendimin. Së këtejmi, duhet të sqarohet neni 13 dhe të shmanget mundësia e interpretimit dhe zbatimit të tij ndryshe në praktikë. Për më tepër, është e nevojshme të parashikohen edhe rregulla për realizimin e kësaj të drejte, ose të paktën të bëhet një referencë ndaj një akti tjetër që do të parashikonte në detaje mënyrat e realizimit të kësaj të drejte.

Rreziqe për shkak të procedurave të rregulluara jo sa duhet vërehen edhe në lidhje me nenin 15, i cili e rregullon të drejtën e bonusit/asistencës monetar pas pensionimit në shumën e dy pagave mesatare mujore të paguara në ekonominë e Republikës në tre muajt e fundit. Kështu që, nuk është e qartë nëse bëhet fjalë për një llogaritje në bazë të pagës së paguar bruto apo neto, ndërkaq nuk ka as rregulla për mënyrën e realizimit të kësaj të drejte dhe llogaritjen e shumës së bonusit/asistencës monetare për pensionim. Duke qenë se këto çështje rregullohen me akte të tjera, do të ishte e mjaftueshme në këtë drejtim nëse ligji do t'i referohej vetëm dispozitave përkatëse të aktit përkatës.

Përfundimisht, neni 17 parashikon se mënyra e realizimit të të drejtave nga neni 11 deri në nenin 15 të këtij ligji përcaktohen nga KGJB, së këtejmi janë detektuar rreziqe në lidhje me vendimin e Këshillit, pasi nuk ka standarde të caktuara që kanë të bëjnë me atë nëse Këshilli e ka për detyrë ta bëjë publik vendimin e tillë, madje nëse i njëjti mund të kontestohet dhe në cilën mënyre. Në këtë kuptim, është e paqartë pse ligji i referohet një vendimi por jo edhe një akti nënligjor të përgjithshëm, kështu që nuk parashikohet as procedura për marrjen e këtij vendimi. Për sa më sipër, duhet të inkorporohen dispozita sipas të cilave do të përcaktohej se për mënyrën e realizimit të të drejtave nga neni 11 deri në nenin 15 të këtij ligji, Këshilli miraton akt nënligjor, dhe jo vendim, me të cilat do të rregullohej në detaje procedura e miratimit të këtij akti nënligjor.

7. Analiza e dispozitave të Ligjit për Buxhetin Gjyqësor një pjese të akteve nënligjore dhe të përgjithshme që rezultojnë nga Ligji për Buxhetin Gjyqësor

Titulli: Ligji për Buxhetin Gjyqësor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 60/2003, 37/2006, 103/2008 dhe 145/2010)

Shqyrtimi i kërkesës: Pavarësia, efikasiteti dhe rezistenca gjyqësore ndaj korrupsionit dhe ndikimeve të tjera janë baza e çdo shoqërie demokratike. Prandaj, sigurimi i garancive dhe kushteve që gjykatat të izolojnë nga ndikimi jo përkatës dhe korrupsioni është thelbësor për respektimin e sundimit të ligjit, promovimin e besimit të publikut ndaj gjyqësorit dhe institucioneve të tjera, si dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Parakusht themelor për këtë është ekzistimi i një sistemi gjyqësor të fuqishëm dhe kolosal, i cili është efikas, i qëndrueshëm dhe i pavarur në punën e tij. Kjo nënkupton pavarësinë e plotë financiare të sistemit gjyqësor, si dhe alokimin e resurseve adekuate për funksionimin e tij pa pengesa. Në këtë kontekst, kuadri ligjor që e rregullon pavarësinë financiare të gjyqësorit, veçanërisht LBGJ, luan një rol kyç. Duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji për rregullimin e pavarësisë financiare të sistemit gjyqësor, si dhe krijimin e mekanizmave për mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës financiare të gjykatave, është e nevojshme që ai të bëhet objekt i vlerësimit dhe monitorimit të vazhdueshëm të implementimit të tij.

Ky KAL synon ta verifikojë harmonizimin e Ligjit me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira, t'i vlerësojë rreziqet e korrupsionit të përfshira në tekstin e ligjit dhe zbatimin praktik të tij, si dhe të propozojë rekomandime për luftimin e rreziqeve të identifikuar. Vëmendje e veçantë i kushtohet kompetencave diskrecionale, mungesës së mekanizmave garantues, mbikëqyrës dhe kontrollues,

dispozitave të paqarta dhe të paharmonizuara që mund të çojnë në praktikë të dyfishtë, pastaj afateve, procedurave dhe pasojave ligjore të papërcaktuara, kompetencave të ndara, si dhe rreziqeve të tjera që imponojnë sfida dhe dobësi praktike që mund ta pengojnë efektivitetin e Ligjit në promovimin e autonomisë financiare dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor.

Ligji për Buxhetin Gjyqësor u miratua në shtator 2003 dhe filloi të zbatohet nga data 01.01.2004. Në periudhën e kaluar kohore, ligji është ndryshuar tri herë:

- në vitin 2006 kur dispozitat u harmonizuan me dispozitat e themelimit të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë dhe integrimin e saj në buxhetin gjyqësor, pastaj
- në vitin 2008 kur u bë ndryshimi i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor Buxhetor dhe njëherësh kryesimi me Këshillit Gjyqësor Buxhetor kaloi nga Gjykata Supreme në Këshillin Gjyqësor, si dhe
- në vitin 2010, kur u bënë ndërhyrje pothuajse në të gjitha nenet e ligjit me qëllim përcaktimin dhe rregullimin shtesë të dispozitave, nga të cilat një ndryshim më i rëndësishëm është inkorporimi i shumës minimale të buxhetit gjyqësor në shumën prej 0.8% të BPV-së.

Siç parashihet me nenin 1 të Ligjit për Buxhetin Gjyqësor, objekt i rregullimit të ligjit është procedura e hartimit, përcaktimit dhe realizimit të buxhetit gjyqësor, si dhe themelimi, kompetencat dhe mënyra e punës së Këshillit Gjyqësor Buxhetor, ndërsa qëllimi i ligjit është siguri i financimit të qëndrueshëm, afatgjatë, të balancuar dhe adekuat të pushtetit gjyqësor, në mënyrë që të sigurohet pavarësia dhe autonomia kushtetuese dhe ligjore e tij.

Materialet e shqyrtuara/ konsultuara:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. LPKKI ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 12/2019)
3. LBGJ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/2003, 37/2006, 103/2008 dhe 145/2010)
4. LKGJ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 102/2019 dhe 51/2023)
2. LB ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2005, 4/2008, 103/2008, 156/2009, 95/2010, 180/2011, 171/2012, 192/2015 dhe 167/2016 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/2021, 87/2022, 203/2022, 272/2024 dhe 3/2025)
3. Ligji për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 283/2023)
4. Ligji për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 254/2024)
5. Rregullorja e Punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 274/2019, 186/2020, 5/2023 dhe 117/2024)
6. Rregullorja e Punës së Këshillit Gjyqësor Buxhetor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 89/2014)

KONKLUZION

Pas analizës së LBGJ, akteve nënligjore dhe akteve të përgjithshme që rezultojnë prej tij, u identifikuan mangësi që mund të prodhojnë rreziqe për korrupsion. Mangësitë mund të kategorizohen në kategoritë si vijon:

- 7.1. Rreziqe për shkak të dispozitave të paqarta, të dykuptimta dhe të paspecifikuara
- 7.2. Rreziqe për shkak të mundësisë së ndikimit nga pushteti ekzekutiv

- 7.3. Rreziqe për shkak të mungesës së procedurave të qarta dhe garancive procedurale
7.4. Rreziqe për shkak të autorizimeve të gjera diskrecionale

7.1. Rreziqe për shkak të dispozitave të paqarta, të dykuptimta dhe të paspecifikuara

Fillimisht, është e rëndësishme të kihet parasysh se rreziqe të caktuara që lidhen me legjislacionin i cili ka të bëjë me pushtetin gjyqësor i referohen pikërisht vetë natyrës dhe strukturës organizative të sistemit të ndarjes së pushtetit, kështu që në një farë mase është e vështirë të inkorporohen garanci dhe pasoja të posaçme që do të siguronin zbatimin konsekuent të kuadrit ligjor. Ajo që vihet re gjatë analizës së dispozitave të LBGJ është se shumica e rreziqeve kanë të bëjnë me dispozita të përcaktuara në mënyrë joadekuate, me terminologji të paharmonizuar dhe me mosharmonizim me dispozitat e tjera ligjore, me afate të përcaktuara dhe të definuara në mënyrë joadekuate, si dhe procedura të rregulluara në mënyrë të pamjaftueshme për planifikimin, hartimin, realizimin dhe kontrollin mbi realizimin e buxhetit gjyqësor.

Kështu, në nenin 3 theksohet se “të ardhurat e buxhetit gjyqësor janë mjetet e përcaktuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, donacionet dhe të ardhurat vetjake (depozitat, qiratë, taksat gjyqësore, etj.) të përfituesve individualë”. Ligji përcakton një kornizë të përgjithshme për përcaktimin e burimeve të financimit të gjyqësorit, megjithatë, duke qenë se pavarësia e gjyqësorit fillon pikërisht me financimin, mungesa e dispozitave që do të përcaktonin se cilat donacione mund të pranohen nga gjykatat, si dhe mungesa e rregullave se nga cilët persona, institucione dhe organizata, gjykatat mund të marrin donacione të tilla, paraqet një rrezik të veçantë për korrupsion. Së këtejmi, është e rëndësishme të kihet parasysh se kufizimi i donacioneve nuk duhet të jetë i karakterit absolut, veçanërisht nëse e marrim parasysh varësinë e gjyqësorit nga donacionet për pajisjet, veçanërisht nga vendet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare. Prandaj, është e nevojshme të përcaktohen dispozitat në lidhje me atë se cilat donacione lejohen, si dhe të inkorporohen rregulla dhe standarde minimale kur gjykatat dhe përfituesit e tjerë të buxhetit gjyqësor duhet t'i refuzojnë donacionet. Këto rregulla dhe standarde mund të rregullohen në mënyrë më të detajuar me Kodin Etik, ose me akte të tjera nënligjore, por paraprakisht të inkorporohen bazat në kuadrin ligjor.

Në nenin 6 të këtij ligji rregullohet themelimi i KGJB-së ku parashikohet se ai i “kryen punët e përcaktuara me këtë ligj, Rregulloren e Punës së Këshillit Gjyqësor Buxhetor dhe me akte të tjera”. Duke vepruar kështu, ligji përdor terminologji jo uniforme, kështu që parashikon se Këshilli i kryen “punët”, që përbën një përkufizim jopreciz, nga i cili nuk është e qartë se a nënkuptohen kompetencat e Këshillit. Kjo theksohet veçanërisht nga fakti se parashikohet që Këshilli t'i kryejë punët, e përcaktuara ndër të tjera edhe me akte të tjera. Prandaj, mbetet e paqartë nga dispozita e formuluar në këtë mënyrë a është e mundur të rregullohen kompetencat e Këshillit me akte të tjera, përfshirë edhe akte nënligjore. Së këtejmi, paragrafi (2) i këtij neni duhet të rregullohet terminologjikisht dhe të riformulohet në kuptimin që “Këshilli Gjyqësor Buxhetor i ushtron kompetencat e parashikuara me ligj, në mënyrë të rregulluar me ligjin dhe me akte të tjera nënligjore”.

7.2. Rreziqe për shkak të mundësisë së ndikimit nga pushteti ekzekutiv

Neni 7 e rregullon përbërjen e KGJB-së, i cili përbëhet nga kryetari dhe 10 anëtarë. Kryetar i KGJB-së është Kryetari i Këshillit Gjyqësor, ndërsa Zëvendëskryetar në mungesë të tij është Kryetari i Gjykatës Supreme. Anëtarë të KGJB-së janë: Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Gjykatës Supreme, Kryetari i Gjykatës Administrative, kryetarët e katër gjykatave të apelit, dy kryetarë të gjykatave themelore sipas renditjes së përcaktuar në LGJ, si dhe Drejtori i AGJPP-së. Në këtë seksion, duke i marrë parasysh rekomandimet e Komisionit të Venecias në lidhje me largimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor që janë nga pushteti ekzekutiv, me analogji mund të vlerësohet se anëtarësimi i Ministrisë së Drejtësisë në KGJB paraqet një rrezik të ngjashëm për pavarësinë e gjyqësorit, në këtë rast nga aspekti financiar. Prandaj, nevojitet të merret në konsideratë ndryshimi i përbërjes së KGJB-së, në drejtim të pavarësisë më të madhe të pushtetit gjyqësor nga pushteti ekzekutiv në drejtim të planifikimit dhe realizimit të buxhetit

të nevojshëm për funksionimin optimal. Ndryshimet e këtilla do të ishin më të lehta për t'u zbatuar sesa ndryshimi i përbërjes së Këshillit Gjyqësor, meqë përbërja e Këshillit Gjyqësor Buxhetor nuk është përcaktuar me Kushtetutë.

Për më tepër, paragrafi (4) i nenit 8 parashikon që Kryetari i KGJB-së e prezanton dhe përfaqëson buxhetin gjyqësor në seancën e Qeverisë në të cilën miratohet propozimi i Buxhetit të Republikës. Kjo dispozitë, gjyqësorin përsëri e vë në pozitë vartëse para pushtetit ekzekutiv. Megjithatë Qeveria është propozuesi i vetëm i Buxhetit të vetëm të Republikës në kuadër të të cilit është përfshirë edhe buxheti i pushtetit gjyqësor, mënyra e rregullimit të krijimit të Buxhetit i jep pushtet më të madh Qeverisë. Fillimisht, terminologjia e përdorur se Kryetari i Këshillit e “përfaqëson” buxhetin e pushtetit gjyqësor, lë përshtypjen se gjyqësori duhet ta bindë Qeverinë që në Buxhetin e Republikës t'i përfshijë mjetet e nevojshme për pushtetin gjyqësor, gjë që lë hapësirë për interpretimin se Qeveria nuk është e detyruar ta pranojë propozimin e KGJB-së. Për më tepër, fakti që ligji e parashikon që përfaqësimi dhe prezantimi i një pjese të mjeteve “Pushteti Gjyqësor” nga Buxheti i Republikës të mbahet në Qeveri në një seancë ku do të marrin pjesë e gjithë përbërja e Qeverisë, ndërkaq vetëm Kryetari i KGJB-së, me sa duket lë hapësirë të madhe për ndikim joadekuat të pushtetit ekzekutiv mbi pushtetin gjyqësor. Për shkak të kësaj, si dhe për shkak të zbatimit praktik të dispozitave, sipas të cilave gjyqësori kurrë nuk e ka marrë buxhetin e kërkuar dhe të parashikuar me ligj, është jashtëzakonisht e rëndësishme të rishikohen këto dispozita. Nëse ndërmerren hapa më seriozë për reformimin e financimit të pushtetit gjyqësor, do të nevojitet që Qeveria dhe KGJB-ja të paraqesin projekt buxhete të veçanta, të cilat Kuvendi pastaj do t'i përmbledhë në një Buxhet të vetëm të Republikës. Duke e pasur parasysh se për një hap të tillë do të ishte e nevojshme të bëhen ndryshime në ligje të tjera materiale, si rekomandim alternativ do të ishte inkorporimi i dispozitave në përputhje me të cilat do të përcaktohej qartë se Qeveria e ka për detyrë propozimin e paraqitur nga KGJB-ja dhe mjetet e propozuara për pushtetin gjyqësor t'i integrojë në projekt Buxhetin e Republikës. Ndërkaq deri në momentin e ndryshimeve të këtilla të legjislacionit, do të ishte një praktikë e mirë nëse takimet e Qeverisë me KGJB-në mbaheshin në një terren neutral me një pjesëmarrje të balancuar të përfaqësuesve të pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor dhe një ekuilibër të përqendrimit të pushtetit.

7.3. Rreziqe për shkak të mungesës së procedurave të qarta dhe garancive procedurale

Në përputhje me nenin 4, paragrafin (1), të këtij ligji, buxheti gjyqësor “përcaktohet në një shumë prej së paku 0.8% të BPV-së, konform kriterëve të përcaktuara nga KGJB-ja, bazuar në politikën fiskale dhe parametrat kryesorë për vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.” Në paragrafin 2 të këtij neni parashikohet se në rast të rishikimit të Buxhetit të Republikës, mjetet e dedikuara për financimin e pushtetit gjyqësor nuk mund të reduktohen, ndërkohë e inkorporon pjesën minimale të buxhetit gjyqësor i cili duhet të shpërndahet për trajnimin e gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të gjykatave. Sa u përket këtyre dispozitave, nuk ka mekanizma që do të sigurojnë zbatimin praktik të tyre, gjë që është veçanërisht e evidente në praktikë, meqë nga inkorporimi i dispozitës për shumën minimale të buxhetit gjyqësor në krahasim me BPV-në, asnjëherë nuk janë siguruar mjete për financimin e pushtetit gjyqësor të njëjta ose më të madha se pragu i parashikuar ligjor, që në vetvete paraqet rrezik për pavarësinë e gjyqësorit dhe efikasitetin sa i përket procedimit/veprimit të gjykatave.

Pastaj, paragrafi (4) i nenit 7 parashikon që përfaqësuesit e Ministrisë së Financave të marrin pjesë në punën e KGJB-së, por pa të drejtë vendimmarrje. Megjithatë, as Ligji dhe as Rregullorja e Punës së KGJB-së nuk përmbajnë dispozita që do ta rregullonin mënyrën dhe vëllimin e pjesëmarrjes, procedurën e pjesëmarrjes, si dhe rastet në të cilat ato janë përfshirë në punën e Këshillit. Në mungesë të dispozitave të tilla, ekziston rrezik serioz i keqpërdorimit të dispozitave, si dhe shfaqjes së një praktike të ndryshme, që do të kishte edhe efekte të ndryshme mbi punën e KGJB-së. Prandaj, është e nevojshme të parashikohen në ligj situatat, përkatësisht çështjet për të cilat përfaqësuesit e Ministrisë së Financave mund të marrin pjesë në punën e Këshillit, pastaj dispozitat që do të rregullonin çështjen se si përfaqësuesit e Ministrisë së Financave marrin pjesë në punën dhe në seancat publike të Këshillit,

a ofrojnë ata mbështetje të caktuar teknike, analitike dhe profesionale për proceset e tjera, pastaj a përfshihen në punë vetëm sipas ftesës paraprake të KGJB-së, apo të njëjtit a kanë detyrime dhe kompetenca të përhershme në aspektin e punës së Këshillit, si dhe dispozita që do të parashikonin përgjegjësi për pasojat e mundshme për shkak të veprimeve joprofesionale ose të pandërgjegjshme kur të njëjtit angazhohen në punën e Këshillit.

Neni 8 i Ligjit e rregullon punën e KGJB-së në seanca, ndërkaq parashikon një pjesë të kompetencave të Kryetarit të Këshillit në drejtim të përfaqësimit dhe prezantimit të buxhetit të pushtetit gjyqësor para Qeverisë dhe Kuvendit. Në këtë aspekt, fillimisht është e rëndësishme të theksohet se këto dispozita nuk përmbajnë rregulla se sa anëtarë duhet të jenë të pranishëm në mënyrë që të zhvillohet një seancë. Kështu, ligji përmban dispozita për shumicën e nevojshme për vendimmarrje, por plotësisht janë anashkaluar dispozitat e shumicës së nevojshme për mbajtjen/zhvillimin e seancave. Kjo është veçanërisht problematike sepse në punën e Këshillit, kjo e pre supozon edhe punën në seanca, mund të përfshihen edhe persona pa të drejtë vendimmarrjeje. Megjithëse dispozita të tilla janë përfshirë në Rregulloren e Punës së KGJB-së, duke e marrë parasysh praktikën e vendosur që këto dispozita të përfshihen në tekstin e ligjit, në këtë mënyrë do të kontribuohet për një siguri më të madhe për sa i përket shumicës së nevojshme për mbajtjen e seancës. Në këtë kontekst, mungojnë edhe dispozitat në lidhje me kompetencat e tjera të Kryetarit dhe anëtarëve të KGJB-së, transparencën e seancave, mënyrën e punës, etj. Përsëri, këto çështje rregullohen me Rregulloren e Punës, por mungesa e dispozitave ligjore brenda të cilave Rregullorja e Punës do t'i rregullonte këto çështje në mënyrë më të detajuar, i lihet liri e madhe KGJB-së në rregullimin e punës së vet. Prandaj, është e nevojshme të inkorporohen dispozita minimale që do t'i referoheshin shumicës së nevojshme për zhvillimin e seancës, dispozita që do ta rregullonin transparencën në punën e Këshillit, në veçanti publikut transparencën e seancave, kompetencat e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit, pjesëmarrjen e personave pa të drejtë vote, si dhe mënyrën e punës të KGJB-së në përgjithësi, si të seancave ashtu edhe jashtë tyre.

Neni 13 e rregullon një pjesë të procedurës për hartimin e buxhetit të pushtetit gjyqësor, kështu që sipas këtij neni, Këshilli “harton një qarkore që i përmban udhëzimet kryesore për hartimin e planeve financiare të përfituesve individualë, të cilën ua adreson përfituesve individualë.” Kjo qarkore e përmban edhe metodologjinë për hartimin e planit financiar të përfituesve, si dhe shpenzimet e përgjithshme indikative. Rreziku kryesor rregullator në këtë drejtim është mungesa e afateve brenda të cilave Këshilli është i detyruar ta paraqesë qarkoren, dhe dispozitave që parashikojnë pasojat dhe zgjidhjen e problemeve që do të shfaqeshin nëse qarkorja nuk do të adresohet brenda afatit të përcaktuar, ose nëse nuk do të adresohet fare. Prandaj, rekomandohet të inkorporohen afate për adresimin e qarkores, si dhe dispozita sipas të cilave mund të tejkalohet problematika eventuale e shfaqur për shkak të mos adresimit ose vonesës në dërgimin e qarkores. Kjo do të përfshinte dispozita që do të parashikonin pasojat dhe përgjegjësi për Këshillin, por edhe dispozita sipas të cilave përfituesit individualë të buxhetit gjyqësor mund të bënin një projeksion të punës financiare dhe planeve financiare. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse përfituesit individualë kanë përgjegjësi për realizimin e këtyre planeve.

Procedura për përgatitjen dhe realizimin e buxhetit rregullohet në mënyrë plotësuese në nenin 14, ku parashikohen të gjitha të dhënat që përfituesit duhet t'i dërgojnë në KGJB si vijon: vlerësimi i shpenzimeve për vitin fiskal, sipas zërave dhe nënzërave të shpenzimeve, një vlerësim të kostove për dy vitet e ardhshme fiskale sipas zërave dhe nënzërave të shpenzimeve, pasqyrë e shpenzimeve të nevojshme për punësimin e nevojshëm për kryerjen e funksioneve të përfituesve, propozime që i përmbajnë detyrimet e ardhshme ose shpenzime shumëvjeçare, duke i përfshirë projektet e investimeve të pasqyruara veç e veç dhe shpenzimet për secilin vit pasues të pasqyruara veç e veç. Megjithatë, dispozita e ligjit nuk është e qartë në lidhje me qëllimet për të cilat Këshilli i përdor këto të dhëna, si dhe a ka pasojat të caktuara për përfituesit individualë nëse ata nuk paraqesin ose paraqesin të dhëna të pasakta. Nga ana tjetër, paragrafi (3) i këtij neni parashikon detyrimin e gjykatave themelore t'i

harmonizojnë këto të dhëna në nivel të rajonit të apelit. Kjo dispozitë është e paqartë në kuptimin se çfarë do të thotë saktësisht ky harmonizim, ndërkohë që nuk ekzistojnë dispozita që përcaktojnë se si harmonizohen këto të dhëna në nivel rajonal. Në këtë kuptim, ligji nuk përmban dispozita që do të rregullonin procedurën sipas së cilës do të zbatohet ky harmonizim, nuk parashikohen autorizime dhe kompetenca të posaçme për subjektet, nuk specifikohet kur dhe si iniciohet procedura e tillë, a caktohet mbledhje, a zbatohet një lloj tjetër i shkëmbimit të të dhënave, kush dhe në ç'mënyrë është përfshirë në këtë proces, kush duhet ta kryejë analizën, verifikimin e të dhënave dhe harmonizimin përfundimtar të tyre, etj. Duke marrë parasysh sa më sipër, në mënyrë që të tejkalohen rreziqet e identifikuara për shkak të procedurës joadekuate për monitorimin përkatës të realizimit të buxhetit dhe planifikimin e mjeteve të nevojshme për punë, duhet të inkorporohen dispozita që do t'i parashikonin rregullat e procedurës, përgjegjësisë dhe kompetencës tek subjektet konkrete që do të duhej t'i përpilojnë harmonizimet e tilla.

Për më tepër, si hapi përfundimtar i planifikimit dhe përpilimit të buxhetit gjyqësor, në nenin 15 paragrafin (2) parashikohet se Kryetari i KGJB-së dhe Ministri i Financave harmonizohen në “pjesën e mjeteve “ Pushtetit Gjyqësor” të Propozim Buxhetit të Republikës me Kryetarin e Këshillit Gjyqësor Buxhetor. Nëse nuk bien dakord, Ministria e Financave përpilon raport dhe ia dërgon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit Gjyqësor Buxhetor, ndërsa Këshilli Gjyqësor Buxhetor i paraqet opinion Qeverisë për raportin e Ministrisë së Financave.” Kjo strukturë organizative i mundëson ndikim të madh pushtetit ekzekutiv mbi pushtetin gjyqësor, veçanërisht nëse merret parasysh se pas implementimit të harmonizimi të tillë, Kryetari i KGJB-së duhet përsëri ta përfaqësojë buxhetin para Qeverisë. Njëherësh, në rastet kur nuk do të jetë e mundur të arrihet ky harmonizim i buxhetit midis gjyqësorit dhe pushtetit ekzekutiv, nuk është e qartë se çfarë ndikimi ka raporti i Ministrisë të Financave mbi buxhetin përfundimtar, kundrejt opinionit të KGJB-së. Veç tjerash, ligji nuk parashikon kurrfarë rregullash për procedurën e harmonizimit të buxhetit, madje as afate brenda të cilave duhet të bëhet harmonizimi i tillë, por as pasojat në rast të mosrespektimit të afateve apo rregullave procedurale për harmonizimin e buxhetit midis pushtetit gjyqësor dhe ekzekutiv. Për këto arsye, imponohet nevoja e specifikimit të gjithë procedurës për harmonizimin e buxhetit dhe koordinimin e pushtetit gjyqësor me pushtetin ekzekutiv në mënyrë që të paraqitet një Propozim Buxhet i vetëm i Republikës, i cili do të përfshinte parashikimin e rregullave procedurale, mënyrën e fillimit të procedurës, afatet brenda të cilave duhet të përfundojë, pasojat për shkak të mosrespektimit të dispozitave, si dhe avancimin e dispozitave për arritjen e barazisë më të madhe të gjyqësorit dhe pushtetit ekzekutiv në planifikimin e Propozim Buxhetit.

Kur bëhet fjalë për kontrollin mbi realizimin e buxhetit dhe planeve financiare, në nenin 17, paragrafin (1) parashikohet se KGJB-ja e monitoron realizimin e planit financiar dhe nëse kontrollet e kryera konstatojnë parregullsi dhe abuzime nga Kryetari i Gjykatës dhe Drejtori i AGJPP-së, në procesin e ekzekutimit të planit financiar, e njofton Gjykatën Supreme, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor, KPP-në, Ministrinë e Financave dhe Entin Shtetëror të Auditimit. Dispozita e tillë është parashikuar si mekanizëm kontrolli mbi shpenzimin e mjeteve financiare nga përfituesit individualë të buxhetit gjyqësor, megjithatë mbetet e paqartë se cilat do të ishin efektet e tij në praktikë. Fillimisht, është e paqartë pse është e nevojshme që Këshilli t'i njoftojë të gjithë faktorët e listuar, por akoma më shumë, nuk ka dispozita që parashikojnë se cilat do të ishin hapat e ndërmarrë të ardhshëm pas këtij njoftimi. Prandaj, dispozita e tillë edhe pse ka për qëllim forcimin e kontrollit mbi përdorimin e mjeteve financiare të pushtetit gjyqësor, nuk ka dispozita mjaftueshëm të qarta ligjore që do të mundësonin zbatimin e saj adekuat në praktikë. Këto dispozita duhet të avancohen ndërkaq mekanizmat e tillë të garancisë duhet të zhvillohen në detaje duke siguruar rregulla për ngritjen e procedurës për përcaktimin e parregullsive dhe abuzimeve, pasojat e saj, mekanizmat e garancisë për parandalimin e abuzimit të mbikëqyrjes së tillë, etj.

Përfundimisht, neni 18 paragrafi (2) i këtij ligji parashikon se “Këshilli Gjyqësor Buxhetor është i detyruar të paraqesë një herë në vit raport mbi realizimin e buxhetit gjyqësor në Ministrinë e Financave, Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.” Përsëri sa u përket

edhe këtyre dispozitave, mund të vërehet së pari se Ligji përsëri në mënyrë subtile e vë në pozitë vartëse Këshillin para pushtetit ekzekutiv duke përcaktuar se është e nevojshme të paraqesë raport për realizimin e buxhetit në Ministrinë e Financave dhe në Qeveri. Por, nga ana tjetër, ligji nuk përcakton nëse dhe çfarë pasojash do të lindin nëse Këshilli nuk i paraqet raport njërit, ose të gjitha subjekteve të cilave konform ligjit është i detyruar t'ua paraqesë. Duke qenë se nuk parashikohet madje as afati brenda të cilit duhet të paraqitet raporti i tillë, sërish ka dyshime për efektivitetin e kësaj dispozite. Sa i përket këtij neni, i njëjti duhet të riformulohet dhe të parashikohet detyrimi për të paraqitur raportin vjetor në Këshillin Gjyqësor, i cili më pas do ta integronte këtë raport për realizimin e buxhetit gjyqësor në raportin e tij vjetor, i cili në fund i nënshtrohet kontrollit dhe miratimit nga Kuvendi. Në këtë drejtim, duhet të kihet parasysh se shumica e anëtarëve të KGJB-së, për punën e tyre përgjigjen para Këshillit Gjyqësor, dhe jo para pushtetit ekzekutiv ose legjislativ, do të ishte më efektive nëse ata paraqesin raport për punën e tyre në kuadër të KGJB-së në Këshillin Gjyqësor.

7.4. Rreziqe për shkak të autorizimeve të gjera diskrecionale

Në nenin 9 të Ligjit parashikohen kompetencat e KGJB-së, kështu që në paragrafin (1) alineja 7 theksohet se Këshilli “bën ridedikimin e dedikimit të mjeteve të përcaktuara në seksionin “Pushteti Gjyqësor” dhe mund të autorizojë Kryetarin e Këshillit Gjyqësor Buxhetor t'i ridedikojë mjetet e përcaktuara në seksionin “Pushteti Gjyqësor” deri në një shumë të caktuar.” Në pjesën e mëtejshme të ligjit, nuk ka dispozita shtesë që do të përcaktonin disa kritere, rregulla, kushte, vëllimin dhe kufizime në drejtim të ridedikimit të mjeteve. Mungesa e dispozitave të tilla, veçanërisht në aspektin e autorizimit të kryetarit në mënyrë të pavarur ta bëjë ridedikimin, pa mekanizma të parashikuara kontrolli nga Këshilli, paraqet rrezik për korrupsion dhe konflikt të kompetencave që mund të rrezikojë seriozisht punën financiare të gjykatave. Së këtijmi, është e nevojshme të inkorporohen disa dispozita në ligj që do të rregullonin në mënyrë më të detajuar në cilat kushte, në ç'mënyre dhe në çfarë vëllimi mund të bëhet ridedikimi i tillë, si dhe të përfshihen kritere dhe kufizime më të rrepta në lidhje me autorizimin e Kryetarit të Këshillit në mënyrë të pavarur ta bëjë ridedikimin e mjeteve.

8. Analiza e dispozitave të Ligjit për Administrimin e Lëvizjes së Lëndëve në Gjykata dhe një pjesë të Akteve Nënligjore dhe të Përgjithshme që Rezultojnë Nga i Njëjti

Titulli: Ligji për Administrimin e Lëvizjes së Lëndëve në Gjykata (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 42/2020)

Shqyrtimi i kërkesës: Një sistem gjyqësor transparent dhe efikas është thelbësor për të ruajtur besimin e publikut dhe për të siguruar qasje në drejtësi. Menaxhimi me lëndët gjyqësore, nga marrja e tyre në gjykatë, deri në zgjidhjen e tyre të plotë, luan një rol kyç në arritjen e këtyre qëllimeve. Duke e njohur rëndësinë e menaxhimit të përgjegjshëm dhe të paanshëm të proceseve gjyqësore, LALLGJ në gjykata shërben si një kornizë kryesore rregullatore për të siguruar një administrim efektiv dhe të barabartë të proceseve gjyqësore.

Duke marrë parasysh dobinë e KAL si një mjet për identifikimin dhe trajtimin e fragjiliteteve që ka gjasa të mundësojnë praktika korruptive, ky dokument fokusohet mbi LALLGJ për ta vlerësuar kapacitetin në drejtim të parandalimit të ndikimit jo përkatës, administrimit dhe jo efikasitetit të proceseve menaxheriale të lëndëve gjyqësore dhe aksesit të vendimeve gjyqësore. Objektivat e ligjit janë: sigurimi i të drejtës së një gjyqtari të zgjedhur në mënyrë të paanshme gjatë shpërndarjes së lëndëve në gjykata, administrimi i lëvizjes së lëndëve në gjykata nëpërmjet përdorimit të një sistemi kompjuterik të automatizuar për administrimin e lëndëve gjyqësore (në tekstin në vijim: sistemi i automatizuar), parandalimi i vonesave në lëvizjen e lëndëve gjyqësore, parandalimi i krijimit të lëndëve të prapambetura e të pazgjidhura gjyqësor edhe respektimi i afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve

procedurale, afateve ligjore për miratimin, hartimin dhe publikimin e vendimeve gjyqësore dhe afateve të përcaktuara me këtë ligj.

Ky vlerësim i kushton një vëmendje të veçantë harmonizimit të ligjit me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira për transparencën gjyqësore, efikasitetin dhe masat anti-korrupsion, si dhe shqyrton sfidat praktike gjatë implementimit të dispozitave ligjore, me theks të veçantë mbi dobësitë sistemike dhe boshllëqet operacionale në lidhje me kompetenca të gjera diskrecionale, procedura të papërcaktuara, mungesë të mekanizmave garantues, afate të papërcaktuara dhe rreziqe të tjera që mund të rrezikojnë efektivitetin e tij praktik.

Objekti kryesor i këtij dokumenti është të kontribuojë në forcimin e përgjegjësisë dhe transparencës gjyqësore, duke u ballafaquar me rreziqet e korrupsionit në administrimin e lëndëve gjyqësore, dhe kështu të kontribuojë edhe në forcimin e sundimit të ligjit dhe promovimin e besimit të publikut ndaj gjyqësorit.

Materialet e shqyrtuara/ konsultuara:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. LPKKI ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr.12/2019)
3. LALLGJ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/2020)
4. Qëndrimi parimor i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për publikimin e vendimeve jo të formës së prerë (Seancë e Përgjithshme datë 21.12.2022)
5. LPP ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2010, 100/2012, 142/2016, 193/2016 dhe 198/2018)
6. LPK ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 75/2005, 110/2008, 83/2009, 116/2010 dhe 124/2015)

KONKLUZION

Pas analizës së LALLGJ, akteve nënligjore dhe akteve të përgjithshme që rezultojnë prej tij, u identifikuan mangësi që mund të prodhojnë rreziqe për korrupsion. Mangësitë e detektuara në Ligjin mund të kategorizohen në kategoritë si vijon:

- 8.1. Rreziqe për shkak të dispozitave të paqarta, të dykuptimta dhe të paspecifikuara
- 8.2. Rreziqe për shkak të afateve të papërcaktuara
- 8.3. Rreziqe për shkak të mungesës së garancive procedurale dhe mekanizmave mbrojtës
- 8.4. Rreziqe për shkak të autorizimeve të gjera diskrecionale

8.1. Rreziqe për shkak të dispozitave të paqarta, të dykuptimta dhe të paspecifikuara

Në nenin 3 të Ligjit parashikohet administrimi i automatizuar i lëndëve, në paragrafin (1) administrimi i lëndëve përcaktohet si “ndërmarrja e veprimeve nga kryetari i gjykatës, administratori gjyqësor, gjyqtarët dhe nëpunësit gjyqësorë, nga dita e marrjes së shkresës në gjykatë deri në ditën e përfundimit të formës së prerë dhe arkivimit përfundimtar të lëndëve.” Megjithatë, dispozita është shumë e përgjithshme dhe abstrakte, kështu që nuk është aspak e qartë se nga çfarë përbëhet administrimi i automatizuar i lëndëve. Në këtë drejtim, përkufizimi i përgjithshëm i termit “ndërmarrje të veprimeve” vetvetiu nuk e plotëson kriterin e përcaktimit të saktë dhe të detajuar të termit, sepse nuk specifikohet nëse nënkupton ndërmarrjen e veprimeve në sistemin kompjuterik të automatizuar për administrimin e lëndëve në gjykata (ACCMIS). Për më tepër, në të njëjtin nen, paragrafin (4) parashikohet se “gjykatat janë të detyruara të veprojnë sipas konkluzioneve të trupit punues për standardizimin e procedurave gjatë përdorimit të sistemit të automatizuar në gjykata brenda afatit të përcaktuar në konkluzionet.” Megjithatë, ajo që është problematike në këtë drejtim është mungesa e dispozitave në lidhje me

rregullimin e përbërjes, kompetencave dhe mënyrës së funksionimit të trupit punues, si dhe afatet e papërcaktuara, autorizimet e gjera diskrecionale të trupit punues dhe mungesa e sanksioneve për mosrespektimin e dispozitave, si dhe mungesa e mekanizmave garantues për parandalimin e abuzimit të mundshëm. Prandaj, duhet të rishikohen dispozitat, veçanërisht në aspektin e përkufizimeve, sepse gjithçka nënkuptohet si administrim me lëndë, si dhe të përfshihen dispozita në lidhje me themelimin, përbërjen, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të trupit punues. Nga ana tjetër, duhet të parashikohen afate për dërgimin dhe trajtimin e konkluzioneve, pasojat e mosrespektimit të dispozitave, si dhe mekanizmat garantues për parandalimin e abuzimit me autorizimet diskrecionale të trupit punues.

Në nenin 4 të këtij ligji rregullohen aktet për administrimin e lëvizjes së lëndëve në gjykata, ku ndër të tjera paragrafi (2) parashikon se “Kryetari i Gjykatës, me propozimin e Trupit Punues për Administrimin e Lëvizjes së Lëndëve në Gjykatë, i miraton procedurat e brendshme dhe planin vjetor për administrimin e lëvizjes së lëndëve në gjykatë.” Megjithatë, dispozitat nuk parashikojnë nëse Kryetari i Gjykatës është i obliguar me propozimin e trupit punues, me fjalë të tjera a mundet të nxjerrë një akt të tillë pa propozimin e trupit punues. Në këtë situatë, mund të paraqitet praktikë e dyfishtë dhe interpretime të ndryshme të dispozitave, që është një rrezik për abuzime, si dhe për shfaqjen e konfliktit të kompetencave. Ndërkohë, teksti ligjor nuk parashikon një afat të caktuar brenda të cilit duhet të dërgohen aktet, por ligji ndërlidhet me miratimin e orarit vjetor të punës së gjyqtarëve dhe punonjësve gjyqësorë, që në mënyrë plotësuese situatën e bën akoma më komplekse sepse dispozita të tilla nuk janë të përfshira as në LGJ, ku përfshihen dispozitat për miratimin e orarit vjetor të punës.

Në nenin 6 të Ligjit parashikohet krijimi i Trupit Punues për Administrimin e Lëvizjes së Lëndëve në Gjykatë, i cili drejtohet nga administratori gjyqësor, anëtarë të të cilit janë kryetarët e departamenteve gjyqësore dhe nëpunësit gjyqësorë nga radhët e nëpunësve udhëheqës gjyqësorë, nëpunësve gjyqësorë ekspertë dhe nëpunësi gjyqësor i ngarkuar me sistemin e automatizuar. Trupi Punues ka për detyrë të bëjë propozime dhe rekomandime deri te Trupi Punues për Standardizimin e Procedurave Gjatë Përdorimit të Sistemit të Automatizuar në Gjykata. Duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij trupi, duhet të theksohet se mungojnë dispozita për një rregullim më të detajuar të përbërjes dhe kriterëve se cilit punonjës duhet dhe mund të jenë anëtarë të Trupit Punues. Së këtijmi, nuk është e qartë nëse të gjithë punonjësit e gjykatës janë anëtarë të Trupit Punues, apo vetëm ata që do të caktohen nga Kryetari i Gjykatës, meqë numri i këtyre punonjësve ndryshon në mënyrë drastike nga një gjykatë në tjetrën. Së këtijmi duhet të rishikohen dispozitat, përkatësisht të parashikohet një procedurë për zgjedhjen/caktimin e anëtarëve të Trupit Punues, e cila duhet të jetë e përcaktuar mirë, si dhe të parashikohen kriterë të posaçme, siç është numri minimal dhe numri maksimal i anëtarëve të këtij Trupi Punues, për të shmangur jo fleksibilitetin dhe jo efikasitetin e këtyre organeve në gjykatat me një numër më të madh punonjësish, si dhe të parashikohet mënyra e formimit dhe funksionimit të këtij Trupi Punues në gjykatat që nuk kanë një numër të mjaftueshëm punonjësish gjyqësorë profesionistë, udhëheqës të departamenteve, administratorë, etj.

Në këtë drejtim, në nenin 14 parashikohet se “mbikëqyrja mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryhet nga Komisioni Mbikëqyrës i themeluar nga Ministri i Drejtësisë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Gjykatat”, megjithatë, nuk është e qartë se a bëhet fjalë për të njëjtin komision që është kompetent ta mbikëqyrë zbatimin e Rregullores së Punës Gjyqësore, Komisioni për Shqyrtimin e Parashtresave dhe Ankesave, apo bëhet fjalë për një komision të posaçëm me kompetenca të posaçme. Në këtë kontekst, nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë se çfarë do të thotë saktësisht mbikëqyrja e tillë dhe me çfarë pasojash mund të rezultojë. Prandaj, duhet që Ligji të përcaktojë qartë se cili komision i Ministrisë së Drejtësisë e kryen këtë mbikëqyrje dhe kështu të rregullohet mënyra dhe frekuenca me të cilën kryhet mbikëqyrja, si dhe të parashikohen pasojat dhe rezultatet e zbatimit të mbikëqyrjes së tillë.

8.2. Rreziqe për shkak të afateve të papërcaktuara

Neni 7 i rregullon në mënyrë më të detajuar kompetencat e Trupit Punues për Administrimin e Lëvizjes së Lëndëve në Gjykatë, siç është hartimi i propozim-planit vjetor për avancimin e efikasitetit të gjykatës,

propozimi i procedurave të brendshme për optimizimin e administrimit të lëndëve, si dhe hartimi i raportit mujor për administrimin e lëndëve në gjykata. Edhe pse ky kuadër ligjor është i mirëpërcaktuar, megjithatë mungesa e afateve për dërgimin e raportit mujor lidhur me administrimin e lëndëve përbën rrezik për korrupsion në disa aspekte, siç është jo efikasiteti i gjykatave, shfaqja e praktikës së dyfishtë, si dhe abuzimi i dispozitës gjatë vlerësimit/notimit të punës së punonjësve që janë anëtarë të këtij Trupi Punues. Për këtë shkak, duhet të rishikohen këto dispozita, veçanërisht duke parashikuar afate brenda të cilave ky Trup Punues është i detyruar t'i paraqesë raportet mujore, si dhe dispozitat që do të kishin të bënin me përgatitjen dhe raportimin e propozimeve të paraqitura, analizave të hartuara dhe monitorimin e zbatimit të tyre përmes rezultateve të matshme.

Në nenin 8 të këtij ligji përcaktohen afatet e ndërmarrjes së veprimeve, kështu që në paragrafin (1) parashikohet se gjyqtari dhe nëpunësi gjyqësor janë të detyruar të ndërmarrin veprime në lidhje me lëvizjen e lëndëve në gjykatë në të njëjtën ditë, dhe më së voni deri në fund të ditës vijuese të punës. Në këtë aspekt, nuk ka kriteret e qarta se kur këto veprime ndërmerren deri në fund të ditës, ndërsa kur deri në fund të ditës vijuese të punës. Kjo është veçanërisht problematike sepse në situata të caktuara një veprim i tillë mund të ndikojë edhe mbi një pjesë të madhe të afateve të tjera që lidhen me fillimin e procedurës gjyqësore, veçanërisht në lëndët kur ka nevojë për vendimmarrje emergjente. Për më tepër, si shtyrje plotësuese e afatit, parashikohet se kur këto veprime nuk mund të ndërmerren brenda afatit të përcaktuar, ato mund të ndërmerren më së voni brenda tre ditëve të punës, gjë që varet nga miratimi paraprak me shkrim nga administratori i gjykatës ose nga personi i autorizuar prej tij. Nuk është e qartë pse ekziston një shtyrje e tillë shtesë e afatit për ndërmarrjen e veprimeve, madje pse kjo varet nga administratori i gjykatës. Në këtë drejtim, nuk është e qartë se cilat do të ishin pasojat nëse administratori nuk e jep pëlqimin, ndërsa veprimi gjithsesi se nuk mund të ndërmerret për shkak të rrethanave objektive. Në Ligjin mungojnë mekanizma parandalues për ta kapërcyer këtë situatë, si dhe mungesë të kriterëve objektive dhe të matshme në përputhje me të cilat do të vlerësohej nëse vonesa në ndërmarrjen e veprimeve është e arsyeshme apo jo. Rreziqet e tilla rriten në mënyrë plotësuese në drejtim të paragrafit (4) të këtij neni, sipas të cilit regjistrimi i lëndëve të pranuar të reja në gjykata pas datës 25 dhjetor të vitit aktual bëhet më së voni brenda pesë ditëve të punës nga viti kalendarik i ardhshëm. Kjo dispozitë lë shumë hapësirë për manipulim në praktikë, sepse mundëson veprim/procedim selektiv ndaj lëndëve për një arsye të zgjedhur të paqartë. Prandaj, duhet të ketë mekanizma dhe kriteret shtesë kur ky përjashtim do të zbatohet në praktikë, siç është për shembull mungesa e një pjese të madhe të punonjësve, ose arsye të tjera objektive dhe të arsyeshme. Nga ana tjetër, mundësia e përjashtimeve të tilla për shkak të një date kalendarike të zgjedhur në mënyrë arbitrare e mundëson anashkalimin e ACMIS-it, që vetvetiu është rrezik për korrupsion për shkak të manipulimit me lëndët.

8.3. Rreziqe për shkak të mungesës së garancive procedurale dhe mekanizmave mbrojtës

Me nenin 9, ligjvënësi e ka parashikuar publikimin e detyrueshëm të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda 7 ditëve nga hyrja e tyre në fuqi, por nuk është parashikuar çka nëse këto vendime nuk publikohen fare, ose nëse publikohen duke i shkelur afatet. Kryetari është i detyruar ta monitorojë respektimin e këtyre dispozitave dhe ka në dispozicion mekanizma për ta përcaktuar përgjegjësinë e punonjësit të ngarkuar për publikimin e vendimeve. Duke e pasur parasysh rëndësinë e komunikimit publik dhe transparent në kohë të duhur të gjykatës me publikun, rekomandohet që pasojat e mosrespektimit të këtyre afateve të parashikohen në vetë Ligjin. Në të njëjtin nen, paragrafi (7) parashikon se “mënyra e publikimit dhe kërkit të vendimeve gjyqësore në faqen e internetit të gjykatës rregullohet me Udhëzimin e Trupit Punues për Standardizimin e Procedurave gjatë Përdorimit të Sistemit të Automatizuar në Gjykata.” Në mungesë të kriterëve të qarta në ligj për sa i përket standardeve minimale për aksesin e vendimeve të publikuara, dispozita e formuluar në këtë mënyrë mund të çojë në zbatimin e ndryshëm në praktikë. Rreziku forcohet në mënyrë plotësuese nga mungesa e dispozitave për përbërjen, kompetencat dhe mënyrën e punës së Trupit Punues për standardizimin e procedurave gjatë përdorimit të sistemit të automatizuar në gjykata, i cili përmes këtyre dispozitave ka

diskrecion të madh në rregullimin e mënyrës së publikimit dhe kërimit të vendimeve. Prandaj, do të ishte e nevojshme të inkorporohen garanci minimale ligjore për disponueshmërinë dhe aksesin e vendimeve gjyqësore që duhet të publikohen, duke inkorporuar pasoja specifike për mosrespektimin e dispozitës, dhe pastaj duke i specifikuar kriteret minimale për publikimin dhe kërkimin e vendimeve gjyqësore.

Përveç vendimeve gjyqësore, ligji në nenin 12 e parashikon edhe publikimin e shpalljeve gjyqësore, si dhe shpalljet e noterëve dhe përmbaruesve në këndin e njoftimeve në faqen e internetit të gjykatës. Për këtë, noterët dhe përmbaruesit paguajnë një kompensim vjetor në shumën e përcaktuar me vendimin e KGJB-së. Megjithatë, ligji nuk është mjaft i qartë nëse noterët dhe përmbaruesit janë të detyruar të përdorin faqet e internetit të gjykatës, madje nuk janë parashikuar as pasoja të caktuara nëse ky detyrim nuk respektohet. Për shkak të kësaj, vihet në pikëpyetje zbatimi praktik i këtyre dispozitave, kurse me këtë shfaqet rreziku për korrupsion për shkak të zbatimit selektiv të dispozitave në praktikë. Është e nevojshme të rishikohet procedura e publikimit të shpalljeve të noterëve dhe përmbaruesve në faqen e internetit të gjykatës, duke i përfshirë dispozitat për komunikim me gjykatën dhe mënyrën e adresimit të shpalljeve, si dhe mbikëqyrjen mbi respektimin e këtij detyrimi për gjykatën, noterët dhe përmbaruesit me pasoja të parashikuara në rast të publikimit jo përkatës të shpalljeve.

8.4. Rreziqe për shkak të autorizimeve të gjëra diskrecionale

Neni 10 i Ligjit e rregullon instalimin, mirëmbajtjen dhe aksesin në bazën e të dhënave të unifikuar të vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe të formës jo të prerë të cilën e administron Qendra e Informacioneve të Gjykatës Supreme. Të gjithë gjyqtarët dhe anëtarët e Këshillit Gjyqësor mund të kenë qasje në këtë bazë, sipas kërkesës paraprakisht të paraqitur pranë Kryetarit të Gjykatës Supreme. Gjithashtu, “qasje kanë edhe persona të tjerë për qëllime shkencore-kërkimore të cilët do të provojnë qëllimin e tyre legjitim të qasjes në bazën e të dhënave të vendimeve gjyqësore, duke paraqitur kërkesë deri te Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut”. Ky nen përmban disa rreziqe të korrupsionit, kështu që, fillimisht, nuk parashikohet asnjë pasojë nëse nuk krijohet një bazë e tillë e vendimeve, ose nëse e njëjta nuk mirëmbahet siç duhet. Përqendrimi i madh i diskrecionit gjatë vendimmarrjes për aksesin në këtë bazë nga Kryetari i Gjykatës Supreme gjithashtu përbën rrezik. Nga aspekti terminologjik, neni përcakton se qasja e gjyqtarëve dhe anëtarëve të Këshillit Gjyqësor në këtë bazë mund të miratohet, por jo se ajo u takon konform funksionit të tyre. Pastaj, neni nuk përmban standarde dhe kriterë sipas të cilave duhet të udhëhiqet Kryetari i Gjykatës Supreme gjatë vendimmarrjes për akses, madje nuk janë parashikuar as mekanizma garancie që mund të përdoren nëse akses i refuzohet. Sipas kësaj, Ligji duhet të parashikojë akses automatik për çdo gjyqtar dhe anëtar të Këshillit Gjyqësor në këtë bazë, pa qenë i varur nga miratimi/pëlqimi paraprak, si dhe të parashikojë raste, standarde dhe kriterë në përputhje me të cilat Kryetari i Gjykatës Supreme do të vendosë a do ta refuzojë apo miratojë aksesin e personave të interesuar për qëllime kërkimore shkencore.